


SKIFTER KËLLIÇI

804-32

K 50



KUJTIMET  
E MËHALLËS  
SË VJETËR

SH-32

K50

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

S

SKIFTER KËLLIÇI

R

KUJTIMET E MËHALLËS  
SË VJETËR

(Novelë)

31-731

~~46485~~

BIBLIOTEKA E SHITËR  
GJURORIS

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## NJË KUJTIM NË KOHË TË VESHTIRA

Unë rrija në dritare.

Nuk ja ndaja sytë portës së vjetër të oborrit të madh të shtëpisë; s'di sepse, po atë ditë, sa herë hapej e mbyllej, më dukej e pikëlluar, më e kërrusur nga ç'ish, gati të rrëzohej. Babai nuk duhej të vonohej, se në mbrëmje, kur lëviznin patrullat gjermane, qe ndaluar qarkullimi nëpër rrugë. Ai që kapej pa lejeqarkullimi, rrezikohej të futej në burg. Ato ditë bënte shumë ftohtë, ndonëse marsi ishte më të dalë. Të dukej se dimri qe penduar, qe kthyer përsëri e na kanoste me acar e ngricë.

Mallkoja me vete marsin dinak që më kish mbërthyer në shtëpi mua dhe vëllanë, që gogësin-te pranë zjarrit bubulak. Ne ishim binjakë, po unë isha pak më i gjatë e dukesha më i madh se ai.

Mërziteshim, se s'kishim kur venim. Atë vit ndiqnim klasën e tretë. Mirëpo shkollat qenë mbyllur, sepse kishte rënë tifoja e morrit. Në fillim u gëzuam, se nuk do të kishim mësim. Po pastaj na mori malli për shkollën. Bridhnim rrugëve të mëhallës sonë sa na hanin këmbët e shqepeshim duke luajtur me top. Topi na kishte hyrë në zemër. Kjo kishte ndodhur papritur e pakujtuar, një natë dimri, katër a pesë vjet të shkuara.

Dhe ja se si.

... Atë natë babai erdhi në shtëpi me një fletore vizatimi në duar. Në faqen e parë pashë një fotografi. Kisha parë plot fotografi, po kurrë një të tillë.

Me duart që më dridheshin rrëmbeva fletoren. Nuk më tërhoqën fare fletët që ishin të mëdha e të forta, të mbuluara me një letër të tejdukshme, si napë e hollë; unë doja të dija ç'ish ajo fotografi, ndaj nisa ta vështroj me kujdes.

Ajo ish një fotografi e çuditshme: një burrë me pantallona të shkurtëra e me doreza, me çorape të gjata deri te kupa e gjurit, me një kasketë në kokë, po kërcente për të kapur në ajër një top të madh e të zi. Nuk po kuptoja asgjë. Mos vallë topi i kish shpëtuar nga duart e ai matej ta kapte apo ja kish hedhur dikush? Sidoqoftë, ai kish kërcyer lart e po hiqte shumë për ta kapur. Topi ishte ca lart mbi një diçka të murme e të gjatë, që herë-herë shëmbëllente si mur, herë-herë si kaçube. Pranë saj shiheshin nja dy shtylla të bardha. Kurse mua më dukej se do të përplasej e do të shembej, duke u vrrarë në atë kaçubë apo mur.

Top aq të madh nuk kisha parë. Po ama, dhe burrë me pantallona të shkurtëra e me çorape aq të gjata nuk më kish zënë syri. Përse ishte veshur ashtu? Po ato doreza, po kasketën pse i kishte?

Zgjova vëllanë dhe e pyeta. Ai u shtriq, fërkoj sytë e nisi të shikojë po aq me kureshtje, sa edhe unë atë fotografi të çuditshme.

Dhamë e morëm, po nuk ja dolëm në krye.

— Vë bast se ai ka kërcyer për ta vjedhur topin! — tha vëllai me pamje triumfonjëse.

— Ç'qyfyre që thua! Përse të kërcente atëherë? Mund të ulej ta kapte e pastaj t'ja mbathte, — ju përgjigja. — Unë them se ai po luan me top.

— Po luan? Qenke fare ti! Ku luajnë burrat me top!...

— Posi, more, luajnë që ç'ke me të.

— Ti flet kuturu! Po ç'lojë qenka atëhere kjo? Unë mbeta e nuk dija ç't'i thosha. Atëhere

pyeta babanë.

— Ç'farë po bën ky burri në këtë fotografi, baba?

— Po luan.

— Me top?

— Me top.

— Po pse, luajnë burrat me top? — u hodh vëllai.

— Luajnë...

Babai sikur s'e kish mendjen aty e mezi fliste.

— E shikon, — i thashë unë, ai po luan me top.

— Po pse, kështu luajnë burrat, të veshur me pantallona të shkurtëra si kalamajtë? — pyeti si me dyshim vëllai.

— Kështu luhet më lehtë, — tha babai.

— Po dorezat përse i ka vënë? Mos ka ftohtë?

— Që të mos i rrëshqasi topi nga duart.

Ne u bëmë dhe më shumë kureshtarë, ndaj nisëm ta pyesim pa radhë.

— Vetëm luan ky?

— Jo, me shokë!

— Po ku i ka shokët?

— Në këtë fotografi nuk duken.

— Po ky muri ç'është këtu?

— Nuk është mur, — qeshi babai. — Ata që shihni ju janë njerëz.

Ne u pamë sy në sy. Asgjë s'po kuptonim.

— Nuk duken mirë se janë larg, — vazhdoi babai. — Ata ulen në shkallë të gurta, për të parë se si luajnë të tjerët në fushë.

— Kaq shumë janë?

— Me mijra...

— Si quhet ky vend?  
— Stadium!  
— Këtu në qytetin tonë luajnë?  
— Jo, ne s'kemi stadium.  
— Po pse?  
— Neve na mungojnë shumë gjëra të tjera e jo më stadiumi! — tha babai pak si i nxehur nga këto pyetje.

Babai na ktheu shpinën, po vëllait nuk ju durua pa pyetur edhe një herë:

— Si quhet kjo lojë, baba?  
— Merre vesh edhe këtë: Futboll quhet!  
— Fut!... fut... boo... boll...  
— Po, po, futboll.  
— Po ç'domethënë kjo fu... fut boll?..  
— Më mbytët me këto pyetje! — e humbi durimin babai. — Lojë që luhet me këmbë...

E kuptuam se nuk duhej të pyesnim më shumë, ndaj u tërhoqëm nën këndin pranë dritares e filluam ta shikonim me kujdes atë burrin me pantallona të shkurtëra, me çorape të gjata e doreza, që mundohej të kapte topin me duar.

Ramë të flinim. Po gjumi s'po më zinte. Gjithnjë e kisha mendjen te ajo loja. Desha t'i flisja vëllait, mirëpo kishte fjetur. Mbylla sytë. Atëhere përpara më doli ai burri me pantallona të shkurtëra, topi i madh, rjeta si ajo e peshkatarëve dhe ajo mizëri njerëzish, që mbushte shkallët e larta e që quhej stadium. Si duket ata vinin aty për të parë atë burrin dhe ata të tjerët, që luanin me topin e madh. Ky sehir duhej të ish i këndshëm, ndrysha nuk do të kish aq njerëz.

Kështu u njohëm me futbollin, me të cilin që atë ditë u lidhën kujtime të bukura.

## II

### OBORRI ME DY PORTA

Më në fund dimri e këputi qafën çalë-çalë.

Pranvera zbriti me drojtje në oborrin tonë. Degët e pemëve të oborrit nuk u ngjanin më kraheve të tharë e të zhveshur. Ato genë mbuluar nga gjethet e gjelbra e dukeshin të qeta.

Ditët e zymta i kishim lënë pas. Atë kohë për pak e lamë shtëpinë tonë. Gjermanët kishin filluar të digjnin mëhallën që ndahej nga jona vetëm me një rrugë. Flitej se do të digjnin dhe tonën.

Nëna nuk po e mbante dot veten dhe qante. Babai lëvizte nëpër hajat dhe e qortonte. Ajo shkante në dhomën tjetër për të mos e parë ne.

Po ne nuk qanim. Jo se s'kishim frikë, po e mbanim veten për të mëdhenj e të mëdhenjtë është turp të qajnë. Kur na shihte ashtu, nëna fshinte lotët dhe e mblidhte veten.

Mirëpo gjermanëve nuk ua mbajti t'i vinin zjarrin mëhallës sonë, se disa partizanë kishin sulmuar një post-blok, e u kishin kallur datën.

Nuk rrinim më në dritare të pezmatuar, po zbrisnim në oborr, luanim me shkopinj e ngrohe-

shim në diell. Kur mërzhiteshim, dilnim e bridhnim me shokët nëpër rrugicat e mëhallës.

Tërë kalamajtë e mëhallës e kishin zili oborrin tonë. Jo sepse ishte më i madh e më i hijshëm se të tjerët, po sepse ai kishte dy porta: një përpara shtëpisë, atë portën e vjetër që, kur futej njeri lëkundej e rënkonte, e një portë tjetër prapa shtëpisë.

Nuk ka asgjë të madhe që një shtëpi të ketë dy porta, po puna ish se këto dy porta lidhnin dy mëhallë.

Kur mërzhiteshim në një mëhallë, kalonim në tjetrën. Këtë s'e bënin dot kalamajtë e tjerë, ndaj shpesh na luteshin t'i merrnim për t'i hedhur në mëhallën tjetër. Ne i lejonim, po edhe krekosehim, mbasi, ç'është e vërteta, i kishim në dorë.

Megjithatë, kohët e fundit nuk kishim vajtur fare nga mëhalla tjetër. Atje vërtet kishte një shesh të vogël, ku mund të luaje, po kalamajtë nuk venin e sheshi dukej i shkretë.

Por do të vinte dita që unë dhe im vëlla të shkoni në mëhallën tjetër.



### III

## LOJA E FUTBOLLIT

Po afronte vera. E doja më shumë se stinët e tjera, prandaj afrimi i saj më gëzonte. Kjo ndodhte sepse në verë mund të ishe më i shkujdesur, nuk kishe frikë se mos ftoheshe siç ndodhte shpesh në dimër.

Tani mund të bridhja edhe zbatthur, dhe pa xhaketë, pa triko, shkurt isha i lirë të vishesha si të doja.

Mirëpo papritur u sëmura. Se si ndodhi nuk e mbaj mend. Ndoshta se kisha futur këmbët në rremën që kalonte poshtë mëhallës, apo se kisha pirë ujë kur isha djersitur, apo kisha ngrënë kumbulla të pa pjekura, po puna është se unë u sëmura. Koka më dhimbte, më merreshin mentë, s'haja dot.

Shkurt, më shtrënguan të shtrohesha në shtrat.

Kjo ishte mynxyrë e vërtetë. Më vinte të haja veten me dhëmbë kur shihja vëllanë që shkante e vinte, ku ja kishte qejfi.

Ditën e tretë u bëra më mirë, po nëna nuk më la të dilja. Ju luta, po ajo s'ma vari fare. Madje më tha se do të më mbyllte brenda me çelës.

Atë ditë bënte shumë nxehtë. Kjo ma shtonte mërzinë. Vëllai ndenji ca pastaj doli, duke më lënë vetëm.

Do të kisha qendruar gjatë ashtu shtrirë, sikur të mos dëgjoja nga jashtë disa zëra të gëzuara kalamajsh.

Ata po luanin. Merrni me mend sa e rëndë ishte për mua të qëndroja shtrirë në shtrat, në kohën kur ata shqepeshin së luajturi.

U ngrita dhe shkova në dritare.

Përsëri zëra, britma...

Mbylla veshët që të mos i dëgjoja ato zëra; mbylla dhe dritaren, po zërat, si për inat, gjenin shteg e futeshin në dhomën ku isha, silleshin rreth meje, më mbështillnin, madje sikur më thoshin: «Po ti, ç'bën këtu, përse nuk ngrihesh? Ehu... qenke sëmure, more djalë i mamasë? Po mirë atëhere, rri aty, se mirë je!...»

Në djall të vini të tëra! Edhe sëmundja ime, dhe këshillat e nënës. Po të qëndroja më gjatë, do të pëlçisja nga inati dhe mërzia.

Dola vjedhurazi, hapa portën dhe ja dhashë vrapit.

Kalamajtë po luanin.

Midis tyre ishte dhe Kreshniku. Ai i kishte mbushur pesëmbëdhjetë vjetët dhe ishte më i madh se ne. Më të vegjël ishim unë dhe im vëlla. Edhe im vëlla po luante. Kur më pa, më bëri shenjë me dorë.

— Po ti?

— U mërzita, s'mund të rrija vetëm.

— Do të të flas nëna!...

Po nuk e mbaroi dot fjalën, sepse dikush e gjuajti topin me forcë e ai fluturoi nga ana tjetër.

Atëhere gjysma e kalamajve, si të kishin një zë, thirrën: «gool».

Loja u ndërpre. Kreshniku largoi kalamandin, që qëndronte midis dy gurëve dhe e kish pësuar kot atë gol, kurse mua ma bëri me shenjë të afrohesha.

— Të pëlqen të luash portjer? — më pyeti.

— Si s'më pëlqen!

— Mirë pra! Eja këtu.

Mua me të vërtetë më pëlqente të luaja portier, ndaj qëndrova midis dy gurëve e vështroja zigzaget e topit nëpër këmbët e shokëve. Mërzitesha, sepse asnjë top nuk po vinte drejt meje, veçse shikoja se si përlesheshin të tjerët. Mbi të gjithë shquhej Kreshniku. Mirëpo atë s'e linin fare të qetë. Sapo i vinte topi në këmbë, e rrethonin si mizat; kjo gjë e zbaviste shumë. Shkulej së qeshuri dhe i përgëzonte kalamajtë se kishin nisur të luatin mirë me top. Kur merrte pjesë ai në lojë, për ne ishte gëzim i madh.

Loja vazhdonte me zjarr. Puna ish që unë të mos haja më gola, se ndryshe do të më qortonin. Kështuqë, për të mos lënë atë djall top lecke të kalonte midis gurëve, u zhgrryeva disa herë në pluhur sa gjatë gjerë, ndërsa këmbët m'u gërvishtën e në disa vënde edhe m'u gjakosën. Mirëpo nuk doja t'ja dija, aq më tepër kur dëgjoja Kreshnikun që më lëvdonte nganjëherë:

— More, po ti paske lindur për portier!

Loja do të kishte vazhduar më gjatë dhe kushedi se kur do të përfundonte. Mirëpo Kreshniku se si u përplas me nja dy kalamaj dhe Mirandin, që nuk i ndahej. Mirandi ishte një çun nja dy vjet më i madh se ne, vërtet ish pak i shkurtër, po vinte ca i shëndoshë e nuk shqitej lehtë.

Bam Kreshniku e bam Mirandi dhe topi shtrydhej si sfungjer, sikur këllthiste nga shqelmat që hante, pa më në fund u dëgjua një plasje e shurdhër dhe ai u mblodh.

— Kaq e pat, — tha Mirandi.

Të tërë u grumbulluan rreth topit. Unë s'po arrija të kuptoja ç'ishte ajo plasje, m'u duk — sikur brenda në top kishin vënë një fishekzjarr. —

Mirandi filloi të shqepë topin. Hoqi mbulesën e sipërme, një copë e vjetër xhakete, dhe ahëre dolën disa leckat të mbledhura me spango, penjra e lesh ngjy-ra-ngjyra. Hoqi edhe ato leckat të bëra lëmsh dhe mua më zunë sytë një copë llastik të mbledhur shuk e kapur nga të dy anët me spango.

— Ku të gjejmë llastik tjetër, — tha Mirandi.  
— Kjo ishte copëza e fundit.

— U pa puna, do të bëni topa pa llastik, — u përgjegj Kreshniku.

Të gjithë qëndronin të pezmatuar, sikur të na ishin mbytur gjemitë.

— Ja, ju të dy e keni fajin! — foli Mirandi, duke hedhur llastikun e plasur. — Një muaj kemi që luajmë e topi asgjë nuk pësoi, kurse sot...

Të gjithë kalamajtë që ndodheshin aty hodhën sytë nga ne. Unë e vëllai u shikuam sy më sy. Ai ish bërë flakë në fytyrë. Me siguri që edhe unë ashtu duhet të isha bërë. Na dukej se me të vërtetë ne ishim fajtorë, ndonëse i kishim rënë, apo s'i kishim rënë nga një herë me këmbë atij topi, që dergjej si një zog me bark të çarë në këmbët tona.

Po na nxori Kreshniku nga halli.

— E ç'ke me ta. Janë çuna të mirë. Një ditë do t'i vinte fundi dhe këtij topi. Nuk është hekur, de...

Ne u çliruar nga ankthi, se fjala e Kreshnikut, qe urdhër për të gjithë ne.

Mbase do të kishim qëndruar aty edhe ca, kur dëgjuam zërin e nënës.

Ajo dukej e shqetësuar. Vetëm atëhere u kujtova se kisha ikur fshehurazi nga shtëpia. Nëna më kishte porositur të qëndroja brenda ngaqë ndruhej se mos nuk isha shëruar edhe.

— Po ç'qenkeni bërë kështu? — tha ajo kur na pa si ishim katandisur.

Kaq u hutuam, sa nuk patëm rast të ndahehim me shokët, po ja mbathëm për në shtëpi.

Krisi shamata. S'do mend se mbi mua ranë gjithë qortimet se vëllai nuk ish i sëmure. Megjithatë, nëna kur pa se edhe ai kish grisur një këpucë, me sa duket atëhere, kur në vënd të godiste topin, kish goditur një gur të futur thellë në tokë, filloi ta qortoje edhe atë.

Vetëm një frikë kishim: që ajo të mos i tregonte babait, se atëhere... Babai nuk i duronte çapkëllëqet dhe me siguri do të na qortonte shumë.

Nëna foli e foli, pastaj, kur na pa kokulur... tha:

— Mirë, mirë. Këtë radhë s'do t'i tregoj gjë babait. Po ama, kurrë mos t'ju shoh të luani atë djall lojë, ku mund të thyeni këmbët...

## NË KËRKIM TË TOPIT

Nëna e mbajti fjalën: nuk i tha babait që ne kishim luajtur, ishim pluhurosur e shqyer. Po, që të na shtrëngonte të mos luanim më, këtë nuk mund ta bënte.

Ne donim të luanim përsëri. Po me se? Top nuk kishim.

Vajtëm disa herë te sheshi që aq shumë na kishte hyrë në zemër, por atë sikur e kishte mbuluar hieja e trishtimit. Kalamajtë se nga kishin humbur: mbase për të gjetur llastik, si të gomave të biçikletave, mbase dhe nuk donin të luanin futboll. Po puna ish se ata nuk po vinin më.

Ju lutëm nënës të na qepte një top. Ajo u vrenjt, tundi kokën, kryqëzoi duart e mërzitur, po për të na e prishur, nuk na e prishi. E dinim që ajo ashtu vepronte në fillim: ngulte këmbë, po pastaj bindej.

Ajo kish qepur e endur shumë gjëra, po kurrë topa prej leckë. Ndaj dhe ai s'doli ashtu siç kishim ëndërruar ne. Në vend të topit të rrumbullaktë doli diçka e stërgjatur, e shtypur që i ngjante më tepër një jastëku të vogël e të fortë.

Ku topi që kish qepur Mirandi e që kish plasur atë ditë tek luanim në sheshin e ku topi që kish qepur nëna.

Provuam të lonim me të në oborrin tonë. Unë e goditja me këmbë: ai fluturonte, binte në tokë, po për t'u ngritur nuk ngrihej, veçse rrokullisej e s'levizte më, si të ish një copë plënc.

Mirandi qeshi kur na e pa atë top.

— Paskeni gjetur dhe ju me se të luani, — na tha. — Po ç'të bësh. Më mirë me këtë se sa pa asgjë.

— Sikur të na bëje një top si ai që pate, — u luta unë.

— S'kemi llastik biçiklete.

— Kërkojmë ne.

— Ku do ta gjeni?

— Kushedi dhe gjejmë.

— Edhe topat me llastik të fryrë s'janë gjë, — rrudhi buzët Mirandi. — Mund të plasim shpejt e të ikën tërë mundi kot. Sikur të gjenim një top llastiku!

Vërtet sikur të gjenim një top llastiku!

Për topa të vërtetë futbולי nuk mendonim, se ata kushtonin shtrenjtë.

Mirandi iku, po neve na mbeti mendja te topi i llastikut.

Shpesh, kur kalonim nga pazari, vinim re se në dyqanin e një tregëtari që shiste lodra, kishte topa llastiku ngjyra-ngjyra. Ata ishin të mëdhenj, të rrumbullaktë e na dukeshin sikur na e bënin me sy: «Hë, pra, ç'prisni, pse nuk na bleni!».

Po me se t'i blenin?

## V TOPI PREJ LËKURE

—Mirandi erdhi një pasdite në shtëpinë tonë. Mirëpo brenda nuk na rrihej. Oborri i rrethuar me pemë, me ato degët që ngriheshin përpjetë, na dukej si burg.

Na rrinte mendja te topi. Kaluam nga dera e pasme e oborrit dhe u hodhëm në mëhallën tjetër. Sheshi i harruar e i lënë shkretë ngjalli trishtim. M'u kujtuan britmat «gool, gool» të kalamajve, qyfyret gjatë lojës, lëvizjet ec e jakë. Mbase vëllai dhe Mirandi për atë mendonin, ndaj nuk e nxirrnin një fjalë nga goja.

Dita po thyhej, po dielli që po perëndonte, na dukej se digjte ende.

Po ecnim të shkujdesur rrëzë murit të lartë të shtëpisë, që shtrihej anës sheshit. Kjo ishte shtëpia e një avokati, që kishte disa muaj që ishte vendosur aty. Ne rrallë e kishim parë avokatin. Ishte një burrë i shkurtër, tullac, që ecte sikur të shkelte mbi vezë. Ishte një e ecur aq e çuditshme, sa na bënte të qeshnim. Shpatullat sikur thyeshin ca prapa, qafa sikur të mos kish mbështetje, zgjatej edhe ajo prapa, ndërsa gjoksi i kërcente përpara po sidomos barku. Tek ecte, të dukej si-



kur u thoshte të tjerëve: «He, më shihni cili jam unë, apo jo?»

Shtëpia e tij ishte shtëpia e të fshehtave. Ne jo që jo, po edhe fqinjët tanë nuk kishin mundur të futeshin në atë shtëpi; as edhe prakun s'e kishin shkelur. S'e merrte vesh njeri se ç'ndodhte atje. S'dëgjohej frymë njeriu. Avokati dilte nga porta e hidhte sytë përreth, sikur të ishte kusar. Edhe kur kthehej, me gjithë pamjen e tij krenare që i jepte barku, ai dukej i mbledhur grusht. Trokiste në derë e vëzhgonte prapë përreth me ca sy të dyshimtë, sikur do t'i sulej njeri e t'i futej në atë shtëpi plot të fshehta. Trokiste dy-tri herë. Atëhere që brenda dëgjohej një zë pastaj një kyç që rrotullohej me zhurmë të madhe. Ne shihnim një grua të shkurtër e të shëndoshë si avokati. Dera mbyllej e shtëpia kridhej në një qetësi të madhe.

Asnjë nuk e dinte se si e harxhonte kohën avokati. Thoshin se kishte një dyqan, ku venin shumë fshatarë për të qarë hallet. Avokati rrinte e dëgjonte me vëmendje, u bënte, siç thoshnin ca, lutje e u zhvaste para. Nuk qendronte shumë në dyqanin e tij, se ku e kalonte pjesën tjetër të kohës, nuk dihej. Puna ish se edhe në shtëpi nuk rrinte shumë. Ky avokat na kishte dhe një djalë. Edhe ai babait i kish ngjarë. S'duhej të ishte më i madh se ne. Po, sa kishim parë akovatin dhe gruan e tij, aq kishim parë dhe djalin e avokatit. E kush merrte vesh se me çfarë merrej ai tërë ditën në atë shtëpi.

Mirëpo, tek rrinim ashtu të nemitur, që brenda murit dëgjuam një zhurmë të mbytur. Ne hapëm veshët.

Po kjo zhurmë ç'ishte?

Së pari na u duk si zhurma që shkakton sapa-

34616 17  
46495  
SHI...  
GUR...  
SHI...  
GUR...

ta, kur i ngulet thellë kërcurit. Po jo, s'ish zhurmë sotate. Zhurma na vinte më e mbytur. Kisha përshlypjen se diç godisnin me forcë. Ndoshta shërbyesja e avokatit po rrihte me shufër ndonjë qylym për ta pastruar nga pluhurat, sepse dëgjonim: «Bam-bum; bum-bum, bam!..»

Mirëpo zhurma po afrohej drejt nesh. Tani dukej sikur po rrihnin tokën. Pas pak kjo zhurmë e çuditshme u dëgjua mbi mur. Dëgjonim më qartë oshëtimën e mbytur: «Bam-bum, bum, bam!» Tani na dukej sikur po rrihnin murin.

Hajde merre vesh se ç'ndodhte atje!

Ne dëgjua zërin e gruas së avokatit: «Mos kaq fort, se do ta plasësh fare!.. «Më pas dëgjuam edhe zërin e djalit: «Jo mama, unë nuk i bie aq fort, po ai është shumë i fryrë», pastaj zhurmën e takave të gruas që largohej, siç duket për t'u futur në shtëpi.

— Djali i avokatit po luaka me top! — tha Mirandi.

— Me top? — pyeta unë. — Po topat s'bëjnë kaq shumë zhurmë!

— Është top i madh ky! — vazhdoi Mirandi.

— Vë bast, — që ky çdo gjë mund të jetë, po jo top. Bah, topat bëjnë «pim, pim», kurse ky «bum, bum», — nguli këmbë vëllai.

— Ku merr vesh ti! — u nxe Mirandi. — «Pim, pim» bëjnë topat e vegjël të llastikut. Ja ku të them unë, ky është top i madh, madje më i madh se çdo top llastiku. Ky është top lëkure.

Po nuk pat kohë të vazhdonte më gjatë, sepse, në këto e sipër, që lart murit pamë diçka të madhe, të rrumbullaktë, si lëmsh i verdhë, që u lëshua teposhtë, mu pranë nesh «bum, bam, bum».

— Nuk ju thashë? — thirri Mirandi. — A nuk është top lëkure?

Dhe e kapi në duar atë top të madh e të verdhë që ishte ndarë në katrore, ashtu si ai topi që donte të kapte portieri në fotografinë e fletores së vizatimit.

Që të dy u afruam dhe, me një kureshtje të madhe, e prekëm me duar topin prej lëkure. Ishte shumë i lehtë. E përplasëm për tokë. «Bum, bam, bum» ja bëri topi.

Do ta kishim përplasur edhe më shumë për të dëgjuar atë «bum, bam, bum» që na joshte, po krisma e portës na ndërpreu. Drejt nesh vraponte djali i avokatit me pamje të shqetësuar.

— Topin... më jepni topin tim! — thirri ai.

— Mos ki frikë, nuk ta marrim, — tha Mirandi. — Ne deshëm vetëm ta shikonim çfarë topi ishte...

Rreth nesh u grumbulluan dhe fëmijë të tjerë. Ata habiteshin kur shihnin një top kaq të madh e të rrumbullaktë dhe i luteshin djalit të avokatit që t'ua jepte. Ai shikonte me një pamje krenare, gërmushej, kurse ata i luteshin të luanin me të.

Ç'është e vërteta, edhe neve na e kishte ënda të luanim, por për t'u lutur nuk i luteshim. Kalamajtë e tjerë nuk ju ndanë djalit të avokatit që më së fundi tha:

— Epo mirë, hajde të luajmë! Po shikoni, se mos e goditni fort!..

Eh, ç'u bë atëhere! Sheshi mori jetë rishtas e ne filluam të ngasim si të marrë pas topit prej lëkure. Secili donte ta godiste sa më parë. Edhe unë kisha shumë dëshirë, po mendja më rrihte për portier.

U bë një rrëmujë, sa s'e merrte vesh i pari të dytin.

— Këtij i thonë top! — thoshin kalamajtë. — Shiko, ta mbush këmbën! E jo si ata topat prej lecke! — Dhe ngisnin pas topit.

E godita unë, Mirandi, e goditi dhe im vëlla. Po për dreq i ra kaq fort, sa topi, pasi bëri një «boom» të fortë, shkoi e u zhyt plluc-plluc në një batak me ujë të ndenjtur, që dimër e verë mbetej tërë llum e pisllek.

Djali i avokatit ja dha kujes kur e pa topin e verdhë të lyer si me katran. U munduam ta qetësonim por ai më keq e vinte kujen.

Atë çast dëgjua portën të hapej me rrëmbim e në prak të saj u duk vetë avokati, veshur me pizhama. Nxori nga goja ç'mundi, sikur t'i kishim vjedhur shtëpinë.

— Hajde mbushuni që këtej! — tha, duke tërhequr pas vetes djalin e tij, që po fshinte lotët. — Të mos ju shoh më kurrë këtu!

Mirëpo asnjëri prej nesh nuk lëvizi. E përse të lëviznim? Se mos ishte sheshi i tij.

Kur e pa që s'po i ecte fjala, avokati turfulloi, na shikoi vëngër, po s'e bëri të gjatë, ndaj mbylli portën.

Sa dëshironim të kishim një top lëkure! Atëhere me siguri nuk do shqiteshim nga sheshi.

Qëndronim të pikëlluar, vetëm ardhja e Kreshnikut na ngushëlloi pak.

— Top si ai tani për tani nuk mund të kemi, — tha Kreshniku. — Po një farë topi lëkure do të përpiqemi tua gjejmë. S'do të jetë e largët ajo ditë kur edhe ne do të kemi topa të vërtetë lëkure.

Vetëm më vonë u binda se Kreshniku kishte patur të drejtë.

VI

**FSHIKZA**

Unë, im vëlla dhe Mirandi preknim me duar copat e lëkurës, të qepura e të stërqepura, që na kish sjellë Kreshniku. Lëkura që e fishkur, e rruddhur dhe e vjetëruar. Gëzimi që ndjeva atëhere kur Kreshniku na premtoi për një top lëkure, më ishte zhdukur. Kur mendoja topin e verdhë të djalit të avokatit dhe e krahasoja me lëkurën që kisha nëpër duar, ndjeja hidhërimin që më shtrëngonte si lëmsh në grykë.

— Po llastiku ku është? — pyeti im vëlla, të cilin kërsëria s'e linte të qetë.

— Ja dhe llastiku! — tha Mirandi.

Ai na zgjati një gjë të qullët e të lagët, që i ngjante një zorre. Unë dhe im vëlla rruddhëm buzët se s'po merrnim vesh asgjë.

— Ç' llastik qenka ky? — pyeta.

— Nuk është llastik, po fshikzë.

— Po ç'punë ka fshikza me topin tonë?

— Ehu, s'merr vesh ti nga kjo punë! — tha Mirandi. — Po mos u çudit. Këtë fshikzë do ta fus në lëkurë e do ta fryj, siç fryhen llastikat e topave dhe të biçikletave.

Atëhere u kujtuash ç'ishin fshikzat. Pranë shtëpisë sonë banonte një kasap ku blinim ç'të mundnim: mish, këmbë, plënca. Në dyqanin e tij kalamajtë e mëhallës gjenin nga këto fshikzat e ujit të bagëtive të trasha, të cilat, pasi i lanin mirë e mirë, i frynin me gojë. Atëhere ato bëheshin të mëdha si balona. Sa zbaviteshin kalamajtë me to! Po që këto fshikza mund të shërbenin në vënd të llastikut të topave, s'më kish shkuar ndërmënd kurrë.

Vëreja me kujdes Mirandin që, pasi e futi fshikzën brenda në lëkurë, nisi ta fryjë me gojë. Tani lëkura e fishkur dhe e tharë filloi të zmadhohej. Fryhej fshikza, fryhej dhe lëkura. Ne shihnim Mirandin që merrte frymë thellë, frynte bulçinjhtë, ndërsa fytyra bullafiqe e qafa e trashë i skuqeshin, dhe sytë gati sa nuk i kërcenin jashtë nga mundin.

Dalëngadalë lëkura erdh dhe u fry fare mirë. Ç'është e vërteta, topi nuk u bë tamam i rrumbullaktë se, ta merr mendja, edhe fshikza, kur fryhet nuk bëhet e rrumbullaktë, po diçka që i ngjan më tepër një kungulli. Edhe topi ynë doli diçka më vete: midis formës së kungullit dhe atij të shalqinit. Po neve aq na bënte se ç'formë kish topi. Puna ish se me të mund të luanim sa të donim. Tani s'kishim përse t'i luteshim djalit të avokatit. Ne kishim topin tonë. Do të thërrisnim gjithë kalamajtë e mëhallës, madje edhe ata të mëhallës tjetër, për të luajtur në sheshin para shtëpisë së avokatit.

## VII

### NJË GODITJE NË SHENJË

Babai qeshi kur i treguam se si e kishim sajuar atë top. Nëna s'dinte ç'të thoshte. Asaj nuk i pëlqente të luanim, po, kur pa babanë të ngazëllehej së bashku me ne, qeshi edhe ajo.

U drejtuam nga sheshi unë, im vëlla dhe Mirandi. Pas nesh ishin nja dhjetë a pesëmbëdhjetë kalamaj të tjerë. Ata rrihnin duart, kërcenin, dërdëllisnin e na luteshin t'ua jepnim topin.

Donim që me ne të ishte dhe Kreshniku. Mirëpo ai s'dukej gjëkund. S'e merrnim vesh se ç'po ndodhte me të. S'ishte më ai i pari. Ku e kalonte tërë ditën e ditës? Mos na e kishte dhënë këtë top për të na hequr qafe?

U derdhëm në shesh. Të tërë donim të luanim.

— Më merr mua. Unë luaj mirë.

— Ikë, ore, ku mësove të luash ti, dy pëllëmbë mbi tokë.

— Më merr, pa ke për të parë.

— Kot e ka ky që çirret kështu. S'i ka rënë një herë topit me këmbë. Po të më shikosh mua!

— Edhe ty të kam parë. Një para s'bën.

— Opo ky, ore! Që kur të qenka rritur mendja? Ç'më kapardisesh ashtu si gjeli në pleh! Apo pse ke atë top në duar.

— Mua, më merr mua!..

— Ah po, ti vërtet luan mirë.

— Edhe unë.

— Ç'thua, që kur kështu!

— Provomë dhe ke për të parë.

— Ngadalë se të tërë nuk do të luajmë. Do ta bëjmë me radhë.

Ç'është e vërteta, ne edhe krenoheshim një çikë e u rrinim ca rëndë kalamajve të tjerë, se, fundja, ne e kishim topin. Po, për të luajtur, do të luanim të tërë.

Si më parë, kisha qejf të luaja portjer. Mendoj se, të ishe portjer tani, duhej të ishte më lehtë, se topi ishte i madh e kapej më lehtë se ata topat e leckës, që humbisnin nëpër këmbët tona.

U bëmë gati të luanim, mirëpo...

Nga rruga, drejt sheshit, pamë të vinte avokati së bashku me dy oficerë xhandarmërie. Kohët e fundit na kish zënë syri oficerë që hynin e delnin në shtëpinë e tij. Ata vinin me gratë dhe me fëmijët e tyre. Siç duket bënin vizita, hanin dreka e darkëra. Avokati qe lidhur shumë me gjermanët e ballistët e qe bërë vegël e tyre, ashtu siç kishte qenë vegël edhe në duart e fashistëve italianë.

Sapo na pa, avokati u vrenjt në fytyrë.

— Akoma këtu ju? — foli ai rëndë-rëndë. — Hajde, këputni qafën që këtej...

Po asnjëri nuk luajti vendit.

— E shikoni çfarë rrugaçësh? — tha pastaj avokati duke ju drejtuar oficerëve. — Tërë ditën rri në këtu e një minutë nuk të lenë rehat.



Ai gënjente.

Njëri nga oficerët, që ishte më i pispillosuri, me një palë mustaqe që i shkonin vesh më vesh, tundi kokën e na u hakërrua:

— Muarët vesh?.. Sakën se shoh njeri këtu, se do t'ja bëj varrin. Hë pra, ç'prisni... Hajde marsh!

Kalamajtë nisën të shpërndahen.

— Shpejt, shpejt! — çirrej oficeri mustaqemadh ndërsa ai tjetri me avokatin po bënë sehir.

Na vinte të hanim veten me dhëmbë. Kishte gjetur me kë të matej mustaqemadhi! Më thoshte mendja se, po t'i delte përpara ndonjë partizan, do t'ja mbathte me bisht ndër shalë.

Kalamajtë u shpërndanë, kurse unë, im vëlla e Mirandi ndenjëm mënjanë, rrëzë murit.

Avokati dhe dy oficerët u gajasën. U dëgjua kërcitja e portës dhe ata u futën brenda.

Ç'të bënim? Donim të luanim, po dhe frikë kishim. Po sikur të dilte ai oficeri mustaqemadh? Qëndruam ca kohë ashtu. Kalamajtë që qenë larguar, filluan të mblidhen prapë. Të gjithëve ua kishte ënda të luanin.

Mbase do të kishim qëndruar gjatë ashtu, sikur të mos kishim parë Kreshnikun.

— Hë pra, përse nuk luani? — pyeti ai.

Ne nuk dinim ç'ti thoshim. Po foli Mirandi. I tha se ç'kishte ngjarë. Kreshniku u ngrys.

— Të poshtërit, — tha. — Gjejnë me kë të merren. Po ju luani...

— Si të luajmë, kur ata mund të dalin dhe... — u hodh im vëlla.

— Le të dalin. S'kanë se ç'ju bëjnë.

— Po mund të na marrin topin!

— Le t'jua marrin po mundën...

Kaq donim ne. S'e bëmë të gjatë dhe u ndamë për të luajtur.

— Po ti, Kreshnik, nuk do të luash? — pyeti Mirandi.

— Jo, tani nuk bën më, — u përgjegj Kreshniku. — Ju mund të luani fare mirë dhe pa mua.

— Të paktën mos ikë që këtej, — u hodh vëllai.

Kreshniku vuri buzën në gaz.

— Paskë frikë! — tha.

— Jo, — foli vëllai. — Po më mirë rri, që të na mësoh...

— Ne qeshëm. Kuptohej që im vëlla kishte frikë.

— Mos u bëni merak, këtu do të rri, — u përgjegj Kreshniku dhe i bëri shenjë Mirandit t'i afrohej.

Ata u mënjanuan ca e Kreshniku diç i pëshpëriti, po asnjëri prej nesh nuk mori vesh.

Ne nisëm të luajmë. «Bam, bum, bam» topi kalonte nëpër këmbët tona. Ngaqë s'ish i rrumbullaktë, topi sapo binte në tokë nuk kthehej drejt, po merrte shtrembër, po kjo s'na pengonte të luanim tërë qejf. Kreshniku shqyhej së qeshuri kur shihte se si kalamajtë ngisnin pas topit me një shkathësi të çuditshme.

Po nuk luajtëm dot gjatë.

U dëgjua të kërciste porta. Me sa duket avokati dhe oficerët po dilnin. Kalamajtë ngrinë në vend dhe hodhën sytë nga Kreshniku.

— Vazhdoni të luani! — tha Kreshniku qetë-qetë, duke u mbështetur pas murit, dhe i bëri shenjë Mirandit.

Tani me siguri diçka do të ngjiste. Dhe me të vërtetë, ne pamë Mirandin që e mori topin në duar. Nuk duhet të ishte më tepër se pesëmbëdhjetë metra larg. Kalamajtë në shesh lëvizën. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë te porta u dhanë ata të tre. Oficeri mustaqemadh turfulloi kur na pa që po luanim. Po nuk pati kohë as të hapte gojën. Mirandi e gjuajti topin aq fort sa ai, duke kaluar përmes nesh, shkoi dhe e goditi mu në fytyrë. Oficeri mustaqemadh uluriu dhe mbuloi me duar fytyrën, që ju bë gjithë dhe nga topi.

Kjo ishte një goditje në shenjë. Atëhere e kuptova se ç'i kish thënë Kreshniku Mirandit.

U bë rrëmujë, kalamajtë ikën majtas e djathtas. Njëri mundi të rrëmbejë dhe topin, ndërsa oficeri mustaqemadh vazhdonte të çirrej.

## VIII

### TË FSHEHTAT E RADIOS

Ajo ishte për mua e për vëllanë një gjë e çuditshme. Zakonisht çuditë ne dinim se i bënin dragonjtë, kuçedrat, shtrigat e xhuxhmaxhuxhët e përrallave, për të cilët dëgjonim shpesh herë netëve të ftohta pranë zjarrit bubulak.

Po dhe ajo na dukej si një çudi e madhe. Ne habiteshim kur mendonim se këtë e bënte një kuti e vogël me një xham të gjelbër, pas të cilit ndizej një llambë e vogël. Kjo kuti, që bënte të tilla çudira, quhej radio.

Kur ishte e shuar llamba, radioja dukej me mece, si një plaçkë zbukurimi, që e ka humbur vlerën e saj. Po mjaftonte të ndizej llamba e vogël, që kutia të fillonte të nxirrte zë. Të kishte një zë, nuk do të ishte një çudi dhe kaq e madhe. Po puna ish se, duke lëvizur një sumbull tjetër, radioja fillonte të nxirrte zëra të ndryshëm: dëgjohej një grua që këndonte, pastaj një që fliste, pas pak fishkëllima, zhurma si bubullimë; sa herë lëvizte sumbulla, këto zëra të çuditshëm humbisnin, pastaj dëgjohehin ca të tjerë më të fortë, ca buri dhe dauille, që të shurdhonin veshët. Ata rriteshin

gjithnjë e më shumë, po të lëvizje një sumbull tjetër, po edhe zhdukeshin po qe se këtë sumbull e lëvizje nga ana e kundërt. Në mes të kësaj kutie ishte dhe një si sy, që herë më dukej se mbyllej e herë sikur hapej, sa herë lëvizte sumbulla e gjëmonin zërat.

Ku e kish tërë atë forcë ajo kuti që ti bënte ato çudira? Unë dhe im vëlla vrisnim mendjen, po nuk ja dilnim ndanë.

— Vë bast se aty brenda do të jetë ndonjë njeri i vogël, — më tha një ditë vëllai dhe fytyra i ndriste si të kish zbuluar të fshehtëm më të madhe të botës.

Ne kishim dëgjuar për Gishton e përrallave që futej ku mundte e s'dukej. Mos ndoshta dhe ky njeri ish fshehur si Gishtua midis atyre telave, vidave e hekurave?

Babai qeshi kur dëgjoi për Gishton që na kish marrë mendjen. Ai foli shumë, megjithëse ne pak morëm vesh. Na tregoi për njerëz që flisnin kudo nëpër botë në gjuhë të huaja e zërat e tyre kalonin nëpër tela, derisa mbylleshin në këtë kuti si zogjtë në kuvli. Po mua s'më mbushej mendja e nuk më besohej që zëri mund të kalonte nëpër tela e arrinte që nga larg me kaq forcë, përderisa mezi dëgjoja zërin e vëllait, që, kur përtonte të ngjite shkallët, më thërriste që nga oborri, për të luajtur futboll.

Midis fjalëve të pakuptueshme, radioja lëshonte dhe fjalë shqip. Kjo për ne ishte çudia më e madhe. Na dukej se kjo bëhej për ne. Njeriu (qëllonte të ishte herë burrë herë grua) fliste shumë. Ne dëgjonim fjalët gjermanë, komunistë, Bashkimi Sovjetik, luftë, që plekseshin njëra me tjetrën. Bëheshim kureshtarë të dëgjonim, po babai nxehej dhe i thoshte nënës tërë mllef:

— Gënjejnë të mallkuarit! Të tëra së prapi i thonë. Po tani që po u vjen fundi, s'dinë nga t'ja mbajnë...

— Kujt po i vjen fundi? — pyeti im vëlla.

— Gjermanëve — na tha babai. — Po ua mbathin nga sytë këmbët.

— Po nga ne, do të ikin?

— S'do mend që edhe nga ne do të shporren!

Babai në mbrëmje e hapte radion pak, sa zëri vinte si një murmuritje. Ai dëgjonte diçka në gjuhë të huaj. Ne dëgjonim fjalët: «Moska... Moska... Stalin...» Atë çast më dukej se zëri vinte i butë dhe i ngrohtë, sepse babai vazhdonte t'i thoshte nënës:

— S'e kanë të gjatë, s'e kanë të gjatë. Radioja po thotë lajme të mira.

Po duket se radioja nuk e kish thënë ende çudinë e saj më të madhe. Kjo ndodhi një pasdite, kur babai dhe nëna kishin shkuar diku për vizitë, ndërsa unë e im vëlla kishim mbetur në shtëpi.

Jashtë binte shi dhe ne nuk mund të luanim. U mërzitëm shumë. Do të ishim mërzitur edhe më, po u kujtuam të hapnim radion, megjithëse babai na kish përositur të mos e ngisnim më dorë.

Ne e ndezëm, lëvizëm sumbullën e sakaq syri, si i përgjumur, filloi të çelej e të lëvizte, ndërsa zëri pas pak turfulloi me zhurmë, duke lëshuar, siç e kish zakon, herë ulurima, herë fjalë pa kuptim, copa këngësh, që buçisnin në dhomën e heshtur.

Po, duke lëvizur sumbullën me shpejtësi, shigjeta, siç duket shpoi thellë shkronjat e një qyteti, sepse nuk dëgjuam një zë, po një mizëri zërash, që ulurinin me kaq forcë, sa ne për një çast u drodhëm.

Im vëlla lëvizi sumbullën tjetër e sakaq ajo mizëri zërash erdh e u shua dalëngadalë, siç shuhet flaka e zjarrit kur i hedhim ujë. Mirëpo tani s'dëgjonim gjë fare, ndaj unë lëviza sumbullën pak nga pak nga ana e kundërt dhe zërat filluan të ngrenë kokë, të grinden njëri me tjetrin. Mua më dukej sikur përplaseshin në xhamin e gjelbër. Le të bënin ç'të donin këto zëra, se ne i kishim në dorë. Mjaftonte të lëviznim pak sumbullën dhe ata do të ngordhnin si peshku pa ujë.

Po nuk donim t'i mbytnim fare. Po vrisnim mendjen se ç'ishin ata zëra. Të tillë s'kishim dëgjuar kurrë. Ato qenë britma, po çfarë britmash! S'merrej vesh fare se ç'thonin.

Befas, përmes kësaj zhaurime filloi të ngrihej një zë i vetëm. Ai fliste kaq shpejt, sa s'mernim vesh asgjë. Midis këtij kaosi, zëri i vetëm mezi shquhej. Ky ishte zëri i një njeriu që lëshonte ca fjalë shpejt e shpejt, si plumbat e mitralozave që jo rrallë kishim dëgjuar të kërkëllinin, në lagjet e jashtme të qytetit, kur partizanët sulmonin ndonjë postbllok. Ai po ndiqej nga mizëria e njerëzve, sepse, sa më shumë shtoheshin zërat, aq më shumë humbiste zëri. Madje, për një çast, m'u duk se mizëria që e ndiqte zërin e dëshpëruar, tani e kapi atë dhe veç një djall e dinte se ç'do t'i punonte. Unë e im vëlla u shikuam sy në sy dhe po prisnim përfundimin e kësaj beteje të pabarabartë.

I shkreti njeri, veç ai e dinte se ç'do të hiqte tani! Mirëpo, për çudi, ai thirri, çfarë thoni ju? «Gool, gool, goool!»

Me siguri unë e im vëlla asgjë nuk kishim marrë vesh se çfarë kish ndodhur gjer atë çast, po fjalën, «gool» e dëgjuam mirë tri herë. U shashtisëm.

Po goli ç'donte këtu? Si për çudi, mizëria e njerëzve që gjer atëhere lëshonte thirrje pa kuptim, me të dëgjuar fjalën «gol» që zëri e shqiptoi me aq gëzim, si të kish shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga ajo ndjekje e sëkëlldisur, filloi dhe ajo të thërriste «gool».

Po na mundonte kureshtja. Mirëpo, për të shuar këtë kureshtje, nuk na ndihmonte asgjë: as shigjeta mbi xhamin e gjelbër, as shkronjat me emrat e qyteteve, as syri i radios që tani na dukej se na përqeshte, duke u hapur e u mbyllur.

Mbase do të kishim qëndruar gjatë aty, sikur të mos kish ardhur babai me nënën. Kaq shumë ishim mbërthyer pas radios, sa nuk ndjemë se si babai kaptoi hajatin dhe papritur e pakuptuar u fut në dhomë. Kjo ndodhi në një çast kur zëri që kish filluar të dridhej lëshoi një «gool» kaq të fortë, sa mizëria e njerëzve e pasoi duke buçitur si bubullimë «gool» dhe ne, pa ditur se si, thirrëm me një zë: «gool».

Babai mbeti në mes të dhomës e na shikoi me habi. Kurse në te zënë në faj, u shikuam sy në sy.

— Ç'bëni këtu? — pyeti babai dhe, pa e zgjatur, ju afrua radios dhe lëvizi një rën sumbull. Tërë zërat humbën shpejt, si shkëndijat e thëngjijve të pandezur mirë që i thith errësira. Bashkë me to humbën dhe thirrjet «gool». S'patëm kohë të dëgjonim gjatë sepse na përmendi zëri i babait:

— Ç'bëni këtu?

Të kishte qenë ndonjë këngë apo ndonjë zë, ndryshe ishte. Mirëpo për ne që nuk dinim se ç'lidhje kishin ato zëra me fjalën «gol», përgjigja ishte e vështirë. Kështuqë në vend të përgjigje-



shim, pyetëm. Pyetjet tona s'di përse e prunë në qejf babanë sa ja plasi të qeshurit.

— Kjo që po dëgjoni ishte futboll, — tha babai.

— Si, futboll? Po futbolla shikohet. Si u dëgjuaka? — pyeta unë.

— Edhe dëgjohet, mor bir, edhe dëgjohet me radio...

— Po përse të dëgjohet, përderisa tërë njerëzit mund të venë të shohin. Mos ndoshta nuk i lenë të tërë të shkojnë? — foli im vëlla.

— Nuk është ashtu. Puna është se stadiumi nuk nxë të gjithë ata që duan të shohin futboll. Kështuqë ata mund të rrinë si ju, pranë radiove, dhe të ndjekin lojën nëpërmjet atij që flet.

— Po kush flet?

— Ja, ai që po dëgjonit e që thërriste «gol».

— Po çfarë flet ai?

— Thotë çfarë bëhet në fushë, kush e merr topin, kush e gjuan në portë, kush e pret, kush bën gol. Të gjitha këto i thotë:

— Arrin t'i thotë të gjitha këto? — pyeti i habitur im vëlla. — Po emrat e tyre i thotë? —

— Ta merr mendja, i thotë, — u përgjegj babai; — ndryshe do të bëhej një mishmash e ata që dëgjojnë, nuk do kuptonin asgjë.

— Si i mban mend!

— Epo me atë punë merret ai! Dhe njerëz që e bëjnë këtë punë duhet të jenë të zotë.

Nuk di sepse, po unë fillova ta kem zili atë që fliste aq shpejt; më lindi dëshira që ta dëgjoja përsëri. Madje nuk e kuptoja përse babai e kish fikur ashtu me inat radion. Unë ju luta ta ndizte përsëri, po ai tundi kokën e më tha:

— Jo, ç'të duhet të dëgjosh!

— Po përse, baba, unë dua të di se ku luajnë.

— Jashtë Shqipërisë.

Babai u nxehtë dhe atëhere kuptova përse ai nuk donte që unë ta dëgjoja përsëri zërin e atij që tregonte për futbollin.

Mirëpo vëllait tim nuk i rrihej pa pyetur:

— Po shqip e tregojnë kështu futbollin?

— Jo, nuk e tregojnë.

Kisha dëshirë të dëgjoja një që të fliste shqip, të dëgjoja me ç'fjalë i tregonte lëvizjet e lojtarëve në fushë. Kjo më mundonte. Pastaj isha kureshtar të shihja dhe një ndeshje, ku të luanin burra si ai me pantallona të shkurtëra, që kisha parë në fotografinë e çuditshme. Në dhomë hyri nëna. Përfitova nga rasti në ato çaste të pyesja babanë, që më dukej i mërzitur, siç duket nga pyetjet tona vend e pa vend.

— Baba, përse nuk na merr dhe neve ndonjëherë të shohim si luajnë burrat futboll...

— Mirë! — tha pas pak babai. — Së shpejti do të ketë një ndeshje të bukur. Patjetër do të vemi ta shohim.

Atë natë ne ramë të flemë tërë qejf. Unë pashe dhe një herë fotografinë e çuditshme, portierin që mendohej të kapte topin. Po atje, në fushën e futbollit, do të shihja dhe lojtarët e tjerë, që, s'kish dyshim, duhej të luanin sa s'ka më mirë.

## IX

### NE FUSHE

Ditët shtyheshin. Kjo vinte jo vetëm se qenë ditë vere, po pas asaj ngjarjeje që kish ndodhur me atë oficerin e xhandarmërisë, e kishim vështirë të luanim te sheshi para shtëpisë së avokatit, prandaj hidheshim në mëhallën tjetër. Mirëpo atje nuk kishte shesh. Shtrëngoheshim të luanim në rrugë. Merre me mend se si mund të luanim kur topi nga këmbët tona kalonte nëpër ato të udhëtarëve, apo, më keq kur rrokullisej nën barkun e maqinave, e si për çudi, shpëtonte përmes rrotave të tyre.

Shoferët ndalonin maqinat, na qortonin, po ne vazhdonim punën tonë. Megjithatë, në rrugë e kishim vështirë të luanim. E pamë të udhës të shikonim në oborrin tonë. Po të tërë nuk mund të luanim, se oborri qe i vogël. Atëhere Mirandi s'di se si shpiku një lojë, që neve as na kish shkuar ndërmend. Loja qe shumë e thjeshtë: duhej ta godisje topin me këmbë pa e lënë të binte në tokë. Fitonte ai që e mbante më shumë. Është e kuptueshme se, që ta mbaje sa më shumë topin, duhej ta godisje **kaq** lehtë, sa ai shumë-shumë të shkëputej një pëllëmbë nga këmba.

Mirandi qe bërë mjeshtër. Kjo vinte ndoshta sepse ai e kishte këmbën e gjatë. Të tërë ja kishim zili. Njëherë e mbajti topin, duke e goditur lehtë pa e lënë të bjerë në tokë, nja pesëdhjetë herë. Ne të tjerët u shastisëm.

Dita ditës me këtë lojë merreshim. Megjithatë, mendjen e kishim te ndeshja që do të zhvillohej në fushën e qytetit. Babai na kishte premtuar të na mirrte me vete.

Kështu, një pasdite, plot kureshtje u nisëm atje ku do të zhvillohej kjo ndeshje. Morëm me vete dhe Mirandin. Kishim disa ditë që nuk e kishim parë Kreshnikun. Të na kish harruar? Kështu duhet të ish, se s'e kishim parë asgjekundi.

Ishim kureshtarë të dinim se cilët ndesheshin. Pyeta babanë.

— «Shqiponja» me «Bashkimin», — na shpjegoi babai.

Mirëpo ne ngritëm supet, sepse nuk dinim se ç'ishte «Shqiponja» dhe «Bashkimi».

Atëhere ai na tha se «Shqiponja» ishte skuadra më e fortë e qytetit tonë, që kish fituar zemrën e tërë atyre që venin në fushë; ajo përbëhej nga të rinj të varfër që, pasi punonin andej-këndej, mezi gjenin kohë pasditeve të luanin me top. Kur zuri të fliste për «Bashkimin», babai u ngraz në fytyrë e fjalët i tha si me inat. Në këtë skuadër bënin pjesë bijtë e pasanikëve, që kapardiseshin e donin me çdo kusht të dilnin të parët e qytetit tonë. Djemtë e «Shqiponjës» kishin pranuar të luanin kundër tyre e t'u jepnin një dajak për t'ua ulur hundët atje në fushë, para tërë popullit. Pastaj babai na tha se shumë prej djemve të «Bashkimit» qenë bërë ballistë.

Dhe ja, tani «Shqiponja» me «Bashkimin» po ndesheshin midis tyre.

— Ata të «Bashkimit» do të bëjnë ç't'u vijë ndore për të mundur «Shqiponjën», — tha babai.

— Po sikur ta mundin? — pyeta unë.

Babai qeshi.

— Mos u druaj, — tha pastaj, — ke për të parë se si luajnë djemtë tanë. Me ta është tërë populli, sepse ai i urren ballistët kudo që të jenë.

Kjo ma shtoi dhe më shumë kureshtjen për të parë ndeshjen.

Ne zumë vend në shkallët e drunjtja. Që andej fusha, që ishte mbuluar vende-vende me bar, dukej mirë, në shkallë kishte njerëz të ndryshëm. Kishte dhe shumë ballistë. Madje dhe gjermanë. S'do mend që ata donin të fitonin ata të «Bashkimit».

Papritur Mirandi, që gjer atëhere kish heshitur, duke më prekur në krah, më tha me zë të ulët:

— Pa shiko se kush po na vjen.

Unë hapa sytë përreth, po s'pashë njeri të njohur.

— Vështro poshtë! — vazhdoi Mirandi.

Dhe me të vërtetë poshtë, në shkallën e parë, pashë avokatin me djalin e vet. Avokati kapardisej, duke shikuar majtas e djathtas. Kapardisej edhe i biri që i vinte nga pas. Ata u përshëndetën me nja dy oficerë gjermanë; pastaj me atë oficerin ballist që Mirandi e kish goditur me top atë ditë kur po luanim në shesh. E njoha mirë nga mustaqet e tij të mëdha që i shkonin vesh më vesh.

Mirandi qe zverdhur në fytyrë.

— Të poshtërit — tha ai.

Pas një copë here, djali i avokatit hodhi sytë nga ne e na vështrroi, sikur të donte të na thoshte: «Hë, e shikoni se me kë rri unë dhe babai im?»

Po ne tani nuk e kishim mendjen te ai. Prisnim pa frymë të fillonte ndeshja.

Ajo qe shumë e vrullshme.

Sa herë që topi kalonte andej nga porta e «Bashkimit», turma, si të kishte një zë, gjëmonte: «Përpara djem».

Të gjithë në fushë donin të fitonte «Shqiponja».

Turma thërriste sidomos kur topin e mernte një prej tanëve. «Përpara, Kopi, përpara!» dëgjohja zërat. Kopi ishte, me sa më dukej mua, më i vogli i të gjithëve. Si e mernte topin! Sikur ta kish të ngjitur pas këmbë. Kur i sulej një kundërshtar, ai sa të hapësh e të mbyllësh sytë, i ikte, i sulej një tjetër ai prapë ikte e çante përpara. Atëhere kujtova se si na ikte të tërëve Kreshniku e si i suleshim ne.

Një herë topi doli jashtë. Dikush e kapi me duar dhe ja solli Kopit. Se si e pashë me kujdes dhe njoha Kreshnikun. Po, po, Kreshnikun, që ish zhdukur pa lënë gjurmë. Ja dha topin Kopit, i buzëqeshi dhe i rrahu shpatullat. Atëhere vura re që ai që quhej Kopi, mund të ishte shumë-shumë një vit më i madh se Kreshniku, ose dhe mund të ishin barabar me moshë.

— Kreshniku! — i thashë vëllait dhe Mirandit që qenë strukur pranë meje.

— Po, po, ai vetë, Kreshniku! — thanë ata të dy njëzëri.

Mirëpo zëri im s'arriti dot deri te Kreshniku.

Thirrëm të tre; atëhere vura re që Kreshniku ktheu kokën nga ne dhe na bëri shenjë me dorë.

Desha të ngrihesha e të veja te ai, po babai më ndaloi.

— Rri më tha, — Kreshniku do të vijë vetë këtu!

Ata në fushë vazhdonin të luanin, po unë s'e kisha mendjen aty. Ktheja kokën sa andej këtej për të parë se ku ishte Kreshniku. Dhe e vura re. Ai qëndronte sa në një vend, në një tjetër; zhytej mes njerëzve, ngatërrohej, humbiste, po prapë dukej. Ngandonjëherë u fliste njerëzve nën zë dhe, kur këta ngriheshin në këmbë, diç u jepte.

Mbeta për disa çaste i pezmatuar, pa ditur t'i jepja zgjidhje kësaj pune.

Kur ja papritur, Kreshniku na mbiu mu përpara. Neve vetëm na buzëqeshi, kurse babait, si pak me ndrojtje, i zgjati dorën grusht, e seç i lëshoi në dorë.

Po kjo ç'ishte! Vura re babanë që edhe ai shikoi përreth se mos e kish pikasur njeri dhe futi në xhep atë që i kish dhënë Kreshniku, ndërsa ai, siç na mbiu përpara, ashtu dhe u zhduk, si ta kish përpirë turma. Babai i hodhi pastaj sytë nga unë e vuri gishtin në buzë, duke më bërë shenjë të heshtja.

Unë mbeta si i shastisur. S'po i jepja udhë kësaj pune. që po më dukej shumë e ndërlikuar. Lloj-lloj mendimesh më vërtitëshin në kokë. Kisha dëgjuar për njerëz që, kur bënin ndonjë gjë të fshehtë, merreshin vesh me shenja, apo dhe me shënime që, siç thoshin, i shkruanin nëpër copa letrash, të cilat ose i linin nëpër vende të fshehta, përshëmbull në zgavra lisash, nëpër vrima shkë-

mbinjsh, ose i jepnin fshehurazi, ashtu siç ja dha Kreshniku babait tim.

Prisja që babai të hapte atë copë letër të bërë shuk, mirëpo ai, sikur ta kish harruar atë, vazhdoi të ndiqte lojën. Kur më pa që unë e kisha humbur fare, më foli:

— Ç'pate kështu? Sa ishe në shtëpi më plase të shihje një ndeshje futbollit, kurse tani...

Atëhere edhe unë nisa të ndjek lojën. Mirëpo, në këto e sipër, gjyqtari i vërshtëllëu bilibilit nja tri herë e sakaq lojtarët e lanë lojën.

Prisja me padurim që ata të dilnin prapë. Edhe im vëlla, edhe Mirandi ishin shumë kureshtarë të dinin si do të përfundonte ndeshja.

Ballistët e gjermanët, dukeshin të shqetësuar. Xhandarët filluan të lëvizin nëpër rreshtat e njerëzve. Po avokati me djalin e vet mbahehin të krekosur. Që donin të fitonin të «Bashkimit», për këtë as që dyshoja. Kur shikonte nga ne, mua më dukej se thoshte: «Mos u mprehni e mos fërkoni duart. Do ta shihni tani ç'do të ngjasë!» Edhe oficeri mustaqemadh mbahej i krekosur. Po më i krekosur mbahej një oficer tjetër i gjatë dhe i trashë, me një fytyrë të kuqe si lafshë gjeli, i cili, nga gradat që mbante, duhej të ishte i madh, sepse as që i pyeste të tjerët. Ai kërcënonte njerëzit, i shtynte si pa gjë të keq, urdhëronte oficerët e xhandarët të mbanin rregull.

Babai më tha se ai ishte një nga ballistët më të fëlliqur, që kish marrë më qafë shumë njerëz të pafajshëm. Edhe ai, duke shikuar me përçmim turmën e njerëzve, dukej sikur thoshte: «... Do ta shihni tani ç'do të ngjasë!»

Ç'do të ngjiste, pra?



X

DY GODITJE TË SAKTA

Tani Loja në fushë i ngjante një lufte. Topi gjëmonte nga goditjet, kalonte nëpër këmbët e atyre që e gjuanin pa mëshirë dhe unë habitesha se si nuk pëllciste. Fluturonte sa në njerën portë në tjetrën, po për t'u futur në portën e ballistëve nuk futej. Unë po digjeshja nga dëshira që ta shihja topin të përplasej e të ngatërrohej në rrjetë, ashtu siç ngatërrohen peshqit.

Turma e njerëzve ishte ndezur dhe lëvizte nëpër shkallë, lëkundej e shtrëngohej gjithnjë më shumë rreth fushës, aq sa xhandarët mezi e mbanin. Ballistët e gjermanët mbi shkallët e drunjta kishin filluar të shqetësoheshin shumë.

Mirëpo s'kisha kohë të mendoja më gjatë, se loja që kaq e shpejtë sa nganjëherë më dukej se s'do të mund ta kapja me sy.

Ata të «Shqiponjës» sulmonin. Po edhe të «Bashkimit» s'mbeteshin prapa. Njëherë këta sulmuan rrezikshëm. Topi ishte gjuajtur andej nga një anë e fushës dhe zuri e ulej poshtë. Mirëpo se si ndryshoi drejtim dhe po merrte drejt portës së djemve tanë. Këto të gjitha ngjanë në pak çaste,

po mua m'u duk një kohë e gjatë. Topi i rrumbullaktë po i sulej nga lart kokës së një lojtari të «Bashkimit» që ndodhej pranë portës. Mirëpo edhe ai, si për inat, s'donte t'i linte gjë mangut, ndaj po sulej drejt topit, duke kërcyer në ajër.

Atëhere portieri i tanëve u sul menjëherë dhe e mbërtheu me duar topin, ndërsa lojtari kundërshtar shkoi e u përplas brenda portës. U orvat të ngrihej, mirëpo këmbët i qenë ngatërruar në rrjetë. Siç duket e pengonin dhe thumbat që kishin këpucët.

Atëhere njerëzit shpërthyen me të qeshura. Qeshëm dhe ne, sa na dolën lot nga sytë, tek shihnim lojtarin e «Bashkimit» të bërë tym e flakë. Më së fundi u ngrit dhe vrapoi, ndërsa ne vumë re se ish nxirë në fytyrë. Sigurisht nga inati. Kështu po nxiheshin tani tërë fytyrat e djemve të tjerë pasanikë. Siç duket, ata kishin pandehur se fitoren do ta kishin të lehtë. Mirëpo po ndodhte e kundërta.

Të kishte mbetur puna me kaq, mbase ballistët e rinj nuk do të ishin inatosur dhe aq shumë. Mirëpo në këto e sipër ndodhi diçka që i përmbysi të gjitha.

«Përpara djema, përpara!» thërrisnin njerëzit. Djemtë sulmonin më dendur. Kur e merrte topin Kopi, njerëzit nuk përmbaheshin: «Të lumtë, Kopi, të lumtë!» Dhe Kopi, me shaminë e bardhë në kokë, si të merrte krahë nga këto fjalë, se si gjente shteg midis lojtarëve ballistë e topi nuk i shqitej nga këmbët.

Siç duket, ata të «Bashkimit» filluan ta kuptojnë që rreziku më i madh u vinte nga Kopi, pra ndaj filluan ta ruanin. Me sa shihja, disa edhe

mundoheshin ta pengonin, madje dhe ta rrëzonin. Në një rast, Kopi u ndodh me top përballë një kundërshtari të shëndoshë. Ai po i rrinte pranë dhe e ruante si macja miun ngado që shkonte. Kopi mbeti në mëdyshje për disa çaste, pastaj u nis kinse nga e djathta. Atëhere ai i «Bashkimit» zgjati këmbën, po Kopi ja kaloi topin midis këmbëve. Tjetri desh të kthehej po qe shumë vonë dhe u shemb sa gjatë gjerë në fushë.

Njerëzit gjëmuan përsëri nga brohoritjet. Lojtarët e «Bashkimit» u shastisën fare. Kopin u mundua ta pengonte dhe një tjetër, po edhe ai u rrëzua. Ne po fluturonim nga gëzimi. Kopi po i afrohej portës. Përballë tij, si dem i egër, rrinte portieri kundërshtar. Sikur t'ja merrte topin! Rend Kopi e rend portieri; kur ja, Kopi, ndërsa portieri ju hodh në këmbë (gjer ahëre s'kisha parë një njeri të hidhej aq larg për të kapur topin), ja kaloi topin mbi trup dhe u fut me gjithë të në rrjetë.

«Gool, gool!» — gjëmuan njerëzit e bashkë me ta edhe ne.

Merret me mend se si u bënë ballistët e gjer-manët. Mua m'u duk se atyre, më tepër se sa goli, u kishte bërë përshtypje mënyra se si ishte shënuar ky gol, që, ç'është e vërteta, i turpëronte fare, ndaj u drodhën e filluan të turfullojnë. Edhe ballistët mbi shkallët e drunjtja po turfullonin. Avokati dhe djali i tij më kishin humbur fare sysh.

Njerëzit nisën të thërrasin: «Shqiponja, Shqiponja». Ballistët lëvizën. Madje komandanti ballist, me fytyrë kuqaloshë, doli nga fusha dhe i kërcënoi turmat të heshtnin, ndryshe do të merrte masa. Po ata s'donin t'ja dinin.

Në këto e sipër ndodhi diçka e papritur. Kopi e mori topin, u sul përpara. Me sa dihej, topi kish marrë shtrembër, meqë po dilte jashtë fushe. Megjithatë, në çastin e fundit, ai e arriu (e kjo ndodhi nja pesë a gjashtë metra larg vendit ku qëndronte komandanti ballist) dhe gjuajti me forcë. Të them të drejtën, goditje kaq të fortë nuk kisha parë. Mua m'u duk se topi do të pëllciste, ashtu siç plasi ai topi i leckës, që kish patur brenda copën e llastikut të biçikletës. Por topi nuk plasi. Me atë vrull të çmendur që kish marrë, ai shkoi e u përplas në fytyrën e komandantit ballist. Unë dëgjova një «bum» të fortë e ai u përmbys, duke lëshuar një ulurimë të çjerë.

S'është vështirë të kuptohet se ç'ngjau pas kësaj. Ne të gjithë, babai, vëllai, Mirandi, sa nuk fluturoam nga gëzimi. Po kështu dhe turma e njerëzve.

U bë rrëmuje. Rreth komandantit ballist u grumbulluan disa oficerë.

Loja ishte ndërprerë. Kopi, që ishte bërë qull në djersë, kish mbetur mënjanë me duart e vëna në bel. Në fushë hynë komandanti ballist duke mbajtur dorën në faqen e skuqur. Ai ju drejtua Kopit dhe filloi ta kërcënonte. Ne s'dëgjonim asgjë se ishim shumë larg. Po, me sa shihej, ballisti po e shante Kopin, që e kishte goditur, ndërsa Kopi, shumë i qetë, pa e prishur fare terezinë, diç i shpjegonte. Mirëpo ballisti s'donte t'ja dinte për asgjë, çirej e krekosej më shumë në sytë e turmës.

Në këto e sipër ai i bëri shenjë Kopit të dilte jashtë. Në tribunat njerëzit filluan të mërmëritnin. Pse po e nxirrnin jashtë Kopin? Desha të pyes babanë, po ai qe zverdhur, ndërsa sytë i lësho-

nin shkëndija. Kopi mblidhte supat, pa kuptuar përse ndodhte një gjë e tillë. Atë çast u afrua gjyqtari. Prisja që ai ta zgjidhte këtë çështje si duhej, se kisha dëgjuar që gjyqtarët janë të drejtë e për këto punë janë vënë. Po gjyqtari i bëri she-një Kopi të dilte jashtë. Aty pranë vura re dhe Kreshnikun, po edhe atë e shtynë me forcë jashtë. Atëhere u sulën djemtë tanë, rrethuan gjyqtarin dhe filluan t'i flisnin. Siç duket dhe ata po kundërshtonin që po nxirrej Kopi jashtë fushe. Po gjyqtari, i frikësuar nga komandanti ballist, ngulte këmbë. Në tribunat filluan të dëgjohen fishkëllima. Xhandarët filluan të lëvizin. Kopi s'po tundej fare nga vendi. Atëhere komandanti ballist e kapi për fyti dhe u orvat ta shtynte me forcë jashtë. Unë s'e përmbajta veten dhe lëshova një klithmë.

— Të poshtërit! — tha babai.

Im vëlla dhe Mirandi kishin mbetur të ngurosur. Po ashtu dhe të tjerët. Komandanti ballist, duke pandehur se Kopi nuk do të kundërshtonte, u orvat ta mbërthejë më fort. Megjithëse ishte nja dy herë më i vogël se ai, Kopi ja shtrëngoi duart, bëri një lëvizje, sa komandanti ballist u përmbys për tokë.

Në çast nja dy-tre xhandarë e gjermanë u sulën, e mbërthyen Kopin dhe e nxorrën jashtë e i vunë dhe zinxhirat në duar.

Lojtarët e «Shqiponjës» deshën ta linin lojën, siç duket për ato që ndodhën. Mirëpo ballistët e rinj, nga që po humbnin, nuk donin t'i linin të dilnin jashtë.

Më dukej se nga çasti në çast diçka do të ngjiste. Ndoshta tërë turma e paarmatosur do të

derdhej në fushë për të shprehur urrejtjen e thellë.

«Përpara, djema! S'ka gjë, luani dhe pa Kopin» — dëgjoreshin zëra.

Këto zëra i qetësuan lojtarët.

Kishin mbetur dhe pak minuta që të mbaronte loja. Ata të «Bashkimit» u bënë si të xhindosur. Po bënë çmos jo për të fituar, po të paktën për të barazuar. Mirëpo ku i linin shqiponjat. Ata ja kalonin topin njëri tjetrit. Ballistët suleshin duke hungëruar pas tyre, mirëpo ishte e kotë. Njerëzit filluan përsëri të qeshin. Atëhere ata, ngaqë nuk kishin si të godisnin topin, mundoheshin të qëllonin këmbët e tanëve.

Po me Kopin ç'bëhej? Të tre, mua, tim vëlla dhe Mirandin, na mundonte kjo pyetje.

— Ku është tani Kopi? — pyeta babanë.

— E kanë arrestuar! — m'u përgjegj ai.

— Po pse e kanë arrestuar? Çfarë bëri ai?

Babai nuk u përgjigj. Kisha dëgjuar që gjermanët e ballistët i arrestonin kot njerëzit, madje dhe i vrisnin, sidomos kur s'kishin ç't'u bënë partizanëve. Po kjo që kishin bërë me Kopin kalonte çdo masë.

Megjithëse gjyqtari e shtoi kohën disa minuta, prapsepapë lojtarët ballistë s'bënë asgjë e, që të mos turpëroheshin, me të dëgjuar bilbilin e gjyqtarit, që priti gjersa ata vetë t'i bënë shenjë, u zhdukën nga fusha.

Prapë u bë rrëmuje. Njerëzit brohorisnin me të madhe e suleshin në fushë për të përqaftuar lojtarët e «Shqiponjës» që kishin dalë fitimtarë, megjithëse xhandarët e ushtarët gjermanë i shtynin, i godisnin dhe mundoheshin të mos i linin të futeshin në fushë.

Njerëzit po linin fushën e lojës.

Ne dolëm në rrugë. Ballistë e gjermanë, ca në këmbë, ca me motoçikleta e maqina, po ua mbathnin.

— Kësaj i thonë të mundur! — tha vëllai, që e kish marrë veten pas qortimeve të babait.

— Sikur të kishin bërë edhe një gol tjetër, — tha Mirandi.

— S'ka gjë, dhe një gol s'është pak. Puna është që fituam, — vazhdoi vëllai sikur vetëm ai t'ja dinte vlerën fitores.

Mirandi s'dukej dhe aq në qejf. Ai do të donte t'u kishim bërë sa më shumë gola.

— Sikur të luanim dhe ne si lojtarët tanë, — tha pastaj.

— Do të luajmë, — tha im vëlla. — Unë kam qejf të luaj si Kopi.

— Kaq lehtë të duket ty? — ja ktheu Mirandi.

Ne do të vazhdonim të flisnim, kur papritur pamë Kopin me duart e lidhura fort me zinxhirë. Pas tij vinin dy ballistë e dy gjermanë, të cilëve po u fliste komandanti ballist, që tani po krekosej më tepër se kurrë. Njerëzit ndaluan. Ndaluan edhe ne. Kopin, siç duket, do ta futnin në ndonjë maqinë, pastaj do ta çonin në burg. Ai s'thoshte asnjë fjalë dhe i vështronte me përbuzje gjermanët e ballistët.

Njerëzit u shtuan. Si duket gjermanët kuptuan se e kishin nxjerrë Kopin për ta çuar në burg atëhere kur s'duhej, ndaj shpejtuan ta fusnin në një maqinë. Aty përreth pamë Kreshnikun. Ai, duke çarë me bërryl, ju afrua Kopit.

— Kopi, ne do të shihemi përsëri! — tha Kreshniku.

Kopi vetëm vuri buzën në gaz.

— Hapni rrugën shpejt, hapni rrugën! — filloi të çirej komandanti ballist duke shtyrë majtas e djathtas njerëzit. Pastaj i dha një të shtyrë të fortë Kreshnikut, po ai s'lëvizi fare.

Atëhere, papritur, u dëgjuan dy krisma e komandanti ballist u përmbys, ashtu siç ish përmbysur qëparë në fushë, po këtë radhë për të mos lëvizur më fare.

As që e morëm vesh se nga erdhën këto krisma. U bë rrëmujë. Gjermanët e ballistët midis turmës s'dinin ç'të bënin. Disa ja mbathën nga sytë këmbët.

Ne mbetëm të shtangur me sytë mbërthyer tek Kopi. S'kuptonim se çfarë po ngjiste.

Ishte hera e parë që dëgjoja krisma kaq të forta. Më kërcisnin veshët.

Kopi, me zinxhirë në duar, u hodh midis turmës. Kjo ndodhi kaq shpejt, sa ai m'u zhduk fare nga sytë.

Tre ballistë e gjermanë, me atë oficerin mustaqemadh në krye, që kishim parë me avokatin dhe birin e tij, siç duket, e mblodhën veten dhe me revolverët në duar u derdhën përmes turmës që ish ngjeshur si mur.

Atëhere dhe ushtarë e oficerë të tjerë, duke marrë zemër, u vunë pas tyre. Ata ulurinin, goditnin majtas e djathtas, po turma nuk zbrapsej. Në këto e sipër, një oficer gjerman kërceu në një maqinë dhe e ngau përpara si i çmendur. Turma u shtrëngua të zbrapset. Oficerët e ushtarët gjer-



manë dhe bashkë me ta dhe ballistët, gjetën shteg e vrapuan të ndiqnin Kopin. Turma u lëkund, u drodh dhe përsëri u ngjesh. S'arrita të shoh asgjë. Ushtarë të tjerë me pushkë në duar filluan të na shtynjë duke na bërtitur. Babai na mori të treve dhe ashtu u nisëm për në shtëpi.

S'di se si e bëmë tërë atë rrugë. Ne nuk flisnim, veç një gjë na mundonte të gjithëve; mos e kishin kapur Kopin?

## DITË TË ZYMTA

Prandaj, me të ardhur në shtëpi ju sulëm nënës e secili prej nesh u mundua t'i fliste sa më parë. Ajo s'po merrte vesh asgjë, se ja rrëmbenim njeri tjetrit fjalën nga goja. Po atëhere ndërhyri babai dhe na shtrëngoi të rrinim në një cep të dhomës e të merreshim me lodrat tona. Ne bënim sikur luanim po veshët i mbanim ngrehur e donim të rrëmbenim ndonjë fjalë nga ato që babai i thoshte nënës.

Një gjë s'e kishim të qartë: kush kishte qëlluar mbi komandantin ballist dhe ku ishte Kopia? Këtë mbase nuk e dinte as babai, që, duke folur me nënën, bënte shenjë me dorë, tundte kokën, megjithëse dukej i qeshur si asnjëherë. Edhe nëna dukej e qeshur. Ai po shpjegonte se ndeshja që organizuar enkas për të kryer atentatin kundër komandantit ballist. Dhe ja, në fushë ai kish pësuar atë që meritonte. Babai futi dorën në xhep dhe nxorri një copë letër të bardhë. Atëhere m'u kujtua Kreshni-

ku. Ai si pa gjë të keq, kish futur edhe nëpër xhepat e të tjerëve të tilla letra.

Babai e shpalosi letrën dhe filloi ta lexojë me nënën. Mirëpo ata vetëm sa lëviznin buzët e në s'muarëm vesh asgjë.

Diçka e çuditshme duhej të ishte shkruar në atë copë letër, mbase dhe diçka e gëzueshme, sepse unë vija re që atyre u ndriste fytyra. Pastaj, duke na parë ne, fytyrat morën pamje serioze. Nëna dëshi ta hedhë në zjarr copën e letrës, po babai e ndaloi. Ai e mori, e palosi dhe e vuri në sirtarin e komodinës, ku qe vendosur radioja; pastaj, si e kyçi, ndezi radion.

Befas dëgjuam një zë që ishim mësuar ta dëgjonim shpesh herë natën ndonëse nuk kuptonim asnjë fjalë. Ai nisi të shqiptonte të vetmen fjalë që mbanin mend: «...Moska...Moska...»

Ne deshëm të qëndronim, po nëna na bëri she një të shkonim të flinim.

Shkuam në dhomën tonë, po gjumi nuk po na zinte, sepse ngjarjet në fushë na silleshin në mendje. Më dilte përpara turma e njerëzve, Kopi, kur shënoi golin, Kreshniku me atë pamjen e dyshimtë, duke u zhytur midis njerëzve, komandanti ballist, dy të shtënat, pastaj përsëri komandanti ballist i larë në gjak. Ai kish mbetur top në vend. Ç'është e vërteta, nga të vdekurit kisha frikë, po ballisti i vdekur më kish ngjallur vetëm kureshtje e jo frikë.

Po ajo letër, ç'ishte ajo letër!... Po Kopi, ku do të ishte në ato orë të vona të natës?

...U zgjuam vonë. Dëshira jonë e parë ishte të rrëmbejm topin me fshikzë e të luajm futboll. Babai s'ishte; siç duket ishte nisur në punë në mën-

gjez herët. Po edhe nëna nuk ishte. Kjo na gëzoi, sepse nëna dhe mund të na pengonte të dilnim menjëherë, pa ngrënë, për të luajtur (ne, kur luanim, as që na binte ndërmend për të ngrënë).

U bëmë gati të dilnim, kur, papritur, im vëlla u ndal. Unë s'e mora vesh sepse, ndaj mbeta i topitur.

— Pa vështro këtu! — tha vëllai dhe tregoi me gisht sirtarin e komodinës, ku që vendosur radioja.

— E çfarë? — u habita unë pa kuptuar asgjë.

— Çelsi i sirtarit...

Atëhere u kujtova. Mbi komodinë, pranë radios, ishte çelsi i sirtarit. Me të tani mund të hapnim sirtarin e të nxirrnim që andej atë letrën që kishte lexuar mbrëmë babai me nënën. Siç duket nëna, duke nxjerrë së andejmi gjësendi, e kishte harruar aty.

Kishim në dorë çelësin për të shuar kureshtjen tonë. U sulëm të dy, kush ta rrëmbente më parë. Po im vëlla që më pranë, ndaj e kapi më shpejt. Mua më erdhi inat që ndodhi kështu. Im vëlla u bë gati ta çelte sirtarin.

— Shiko! — i thashë unë. — S'bëjmë mirë që e hapim.

— Pse? — tha ai.

— Mbase ka ndonjë gjë të ndaluar për ne!

— Po ç'mund të ketë?

Unë nuk dija ç't'i thosha. Që bënim gabim duke hapur sirtarin, këtë e dinim mirë si unë ashtu dhe vëllai. Ai mbeti. Po kureshtja nxirrte gjithnjë krye e nuk na linte të qetë.

— Ma jep mua çelsin! — i thashë.

— Përse?

— Që t'ja dorëzoj nënës.

— Po të jetë ashtu puna, ja jap vetë... Unë e di ku e ke hallin ti. Do që të iki unë, pastaj ta hapësh, — tha vëllai, duke i rënë më të.

— Po edhe vetë mund ta hap. A nuk jam më i madh se ti?

— Oh, ç'na the! Ne jemi binjakë.

— Mirëpo unë dukëm më i madh se ti.

Po s'qe e mundur t'ja mbushja mendjen.

Ai hapi sirtarin dhe ne pamë në një cep letrën. Para syve tanë u derdhën ca shkronja të zeza e të trasha. Po poshtë tyre dukeshin disa figura. Ja ngulëm sytë me ngulm letrës për të ditur ç'ishin ato figura. Një burrë, veshur si ushtar (siç duket duhej të ishte partizan, sepse në kokë mbante një kapefë me yll në ballë), me një shkop të trashë si topuz, po i binte me forcë në kokë një gjermani (se i tillë duhej të ish, meqë mbi helmetë dukej një kryq i thyer) dhe, ngaqë kish marrë shumë vrull, duke e shpënë shkopin e trashë prapa shpine, kish qëlluar edhe një tjetër, të veshur si ushtar me qeleshe, ku dukej një shqiponjë. Ky me siguri ishte ballist. «Kështu do ta pësojnë nazistët dhe ballistët», shkruhej në letër. Ja pra, çfarë shpërndante Kreshniku. Ne qeshëm kur pamë këto figura. Dhe kishim përse të qeshnim. Me një të goditur ai partizani po shembte dy armiq.

Do të kishim vazhduar ta mbanim gjatë në duar atë copë letër, po dëgjuam hapa në oborr. Siç duket po vinte nëna. Im vëlla nxitoi ta fuste në sirtar letrën, e mbylli dhe çelsin e la mbi komodinë. Me një frymë vrapuam në rrugë, duke lënë të habitur nënën që po na qortonte, meqenëse ne, pa u ngritur mirë, po dilnim për të luajtur.

Ardhjen tonë kalamajtë e mëhallës e pritën me brohoritje.

Filluam t'u tregonim çfarë kishim parë në fu-  
shë. Ata rrinin e na dëgjonin gojëhapur. U treguam  
edhe për Kopin edhe për komandantin ballist, për avo-  
katin dhe djalin e tij që ishin krekosur aqë shumë  
në fillim, po pastaj ishin zhdukur, si mijtë vrimave.

Në këto e sipër erdhi dhe Mirandi. Ne u bëmë  
gati të luanim.

— Po sikur të vinim te sheshi yqë? — tha një-  
ri prej kalamajve.

— Vemi! — tha Mirandi. — Përse të mos  
vemi?

Kjo na dha zemër të gjithëve. Mirandi, që kish  
goditur oficerin mustaqemadh, nuk kishte frikë,  
përse të kishim frikë ne? Fundja ç'do të na bënte  
avokati dhe i biri?

Kaluam nëpërmjet oborrit tonë në rrugicën  
që të shpinte në sheshin e lojës, kur, papritur, pa-  
më Kreshnikun të vraponte drejt nesh. Ne lëshuam  
britma gëzimi dhe pandehëm se Kreshniku po  
vinte të luante.

Mirëpo ai, më të na parë, na bëri shenjë të  
heshtim dhe, duke futur nën këmbë disa letra,  
që më shëmbëllyen si ajo letra që babai kish fshe-  
hur në sirtar, na bëri shenjë të largoheshim me-  
njëherë dhe u zhduk pas një porte. Ne u shikuam  
sy në sy.

Diçka duhet të kishte ngjarë. Dhe me të vër-  
tetë, duke u kthyer, në murin e rrugicës pamë të  
ngjitur një nga ato letrat me ato figura, me parti-  
zanin, që, me një të goditur, po shembte gjerma-  
nin e ballistin bashkë. Nga sa shihej, Kreshniku jo  
vetëm i shpërndante ato letra dorë më dorë, por  
edhe i ngjiste mureve të shtëpive.

U dëgjua një zhurmë motoçiklete, pastaj në

hyrje të sheshit pamë disa xhandarë që shqisnin nga muret fletët e kuqe. Siç duket, Kreshniku kish ngjitur shumë të tilla në shesh.

Për të humbur gjurmët, ne u shpërndamë pa rënë në sy në të gjitha drejtimet. Unë e im vëlla u kthyem në shtëpi. Nëna u habit kur na pa që u kthyem aq shpejt.

— Ç'ndodhi kështu? — pyeti e habitur.

Po të kishte heshtur im vëlla, asgjë s'do të kishte ngjarë. Mirëpo ai, ashtu si gjithnjë, u ngut dhe këtë radhë.

— Kreshniku po ngjiste në mure disa letra, si ajo që ishte... ishte në sirtar.

Vetëm atëhere e kuptoi gabimin, po qe shumë vonë.

— Si, e paskeni hapur sirtarin? — tha nëna.

Ne ulëm kokën të turpëruar. Mua më vinte të haja veten me dhëmbë.

— Jo unë, po ai, — i thashë nënës duke treguar tim vëlla.

— Përse kërkon të ma hedhësh vetëm mua fajin? — u mundua të shfajësohej ai. — Nuk më the se, meqë je më i madh, doje ta hapje vetë i pari?

Nëna u vrejti kur ne po vazhdonim të haheshim me fjalë.

— I thatë njeriu për letrën? — pyeti ajo.

— Jo, — u përgjegjëm ne njëzëri.

— As edhe kalamajve?

— As kalamajve.

— Mos i tregoni asnjëri. Këto janë komunikata të Partisë Komuniste. Ato duhet të lexohen, të shpërndahen dhe të mos u bien në dorë armiqve. Kini kujdes mos flisni poshtë e lart, armiku përgjon, se, siç i thonë fjalës, edhe muret kanë veshë...

Nëna na kish treguar përralla, po s'na kishte folur kurrë me këtë gjuhë!

Ne as që e morëm vesh se ç'ishte kjo Partia Komuniste e na habitën fjalët «Edhe muret kanë veshë». S'e merrnim me mënd se si mund të dëgjonin muret.

— Ç'është Partia Komuniste? — pyeti papritur im vëlla.

— Partia Komuniste? — tha nëna, si të kish mbetur ngushtë. Partia është... ajo që drejton luftën e partizanëve...

Po s'pati kohë të vazhdonte më gjatë, se atë çast në dhomë u dha babai. Ai hyri kaq papritur, sa ne u drodhëm. Babai dukej shumë i zymtë.

— Ç'ke kështu? — pyeti nëna e trembur.

— Kopin e kapën së bashku me dy të tjerë! — tha babai.

Ne mbetëm të ngrirë. Kopin e kishin futur në burg, ndoshta për të mos dalë kurrë. Kopin që kaq shumë kishim filluar ta donim.

— Të poshtërit! — tha babai. — Do ta shtrëngojnë të tregojë, do ta mundojnë. Po ai do të qëndrojë...

Unë mbylla sytë dhe u përpoqa të përfytyroj se si do ta mundonin Kopin. Nuk kishte dyshim që ishte nga ata të Partisë, për të cilën më kish folur nëna. Gjermanët e ballistët këta njerëz i ndiqnin dhe i zhduknin.

Dhe Kopin do ta mundonin shumë. Po ai, siç thoshte babai, do të qëndronte.



## XII

### NJË BISEDË NË MESNATË

Atë natë gjumi më zuri shumë vonë. Po flija i shqetësuar duke parë ëndërra të frikshme, aq sa u zgjova i mbuluar me djersë të ftohta.

Nata ishte sterrë e zezë. Ajo ma shtonte shqetësimin. U përpoqa të flë prapë, po s'që e mundur. Ndihej zëri i babait dhe i nënës. Edhe ata nuk po flinin. Papritur dëgjova në derën e oborrit disa të trokitura të lehta. Pandeve se më bënë veshët, ndaj mbajta frymën për të dëgjuar më mirë.

Përsëri të trokitura. Po ç'ishin vallë?

Ato mezi dëgjoheshin. Mos qenë ballistët? Përsëri trokitje, këtë radhë më të forta. Unë u ngrita nga shtrati dhe u bëra gati të dilja, por dëgjova këmbë në hajat. Nuk kishte dritë (në orët e vona ato gjithnjë fikeshin). Ishte babai me nënën që mbantë në dorë një qiri.

Babai diç i tha nënës, po unë nuk kuptova asgjë. Vetëm nga dera pakëz e hapur vura re që nëna nuk dukej e shqetësuar.

Babai po zbriste poshtë. Trokitjet nuk e kishin trembur fare. Pra, priste ndonjë mik. Po përse kaq vonë! Im vëlla vazhdonte të flinte.

U hodha në dritare.

Babai zbriti në oborr dhe hapi derën. Nëna e kish shuar qiriun. Dëgjova derën që hapej, pastaj pashë të futej një njeri, me shtat të shkurtër, po s'dallohej mirë se cili ishte. Dukej vetëm i përku-  
lur e diç mbante në kurriz. Babai e ndihmoi të fu-  
tej brenda.

Prisja që të ngjiteshin nëpër shkallë, mirëpo ata qendruan poshtë. Kjo ma shtoi dhe më shumë kureshtjen. Dola nga dhoma, zbrita pak shkallët e mbajta vesh. Babai ndezi rishtas qirinë. Unë nuk mund të zgjatja kokën për të parë se cili ishte ai që bisedonte me babanë, se kisha frikë mos bija në sy. Po drita e qiriut i pasqyronte hijet e tyre në mur.

Siç dukej, ajo që mbante ai burri tjetër në kurriz ishte një thes, bile pak i rëndë.

— Nuk të pa njeri? — pyeti babai.

— Jo, — u përgjegj tjetri. — Përfitova nga errësira. Patrullat tani nuk kalojnë nëpër rrugë të ngushta!

Unë mbeta. Të ishte zëri i Kreshnikut ky, apo më bënin veshët!

— Të gjitha brenda janë? — pyeti rishtas babai.

— Të gjitha! —

Tani u binda. Ishte Kreshniku. Po ku kish qe-  
në? Çfarë kishte sjellë në thes? Nga i kishte sjellë?

— Ke rënë shumë në sy? — e pyeti babai.

— Jo, — u përgjegj Kreshniku. — Nuk dy-  
shojnë te unë, më pandehin të vogël.

— Duhet patur kujdes!

— E kam parasysh.

— Qe e vështirë t'i merrje?

— Po, shumë vështirë. Vendi ishte i dukshëm, po kapërxeva murin nga ana e prapme.

— Ashtu, nga ana e prapme!

— Më vjen keq që nuk mora më shumë.

— S'ka gjë! Dhe këto nuk janë pak.

Ata e ndërprejnë bisedën. Çfarë kish marrë ashtu Kreshniku? Ku i kish marrë? Asgjë nuk po merrja vesh.

— Qenkan të forta! — tha pastaj babai.

— Mall i pregatitur për luftë, — tha Kreshniku.

— Ke bërë punë të madhe, Kreshnik. Shokët do të të lëvdojnë.

— Faleminderit! — tha Kreshniku duke qeshur lehtë.

Babai e përgëzonte.

Një copë herë ata nuk folën. Babai siç duket po shikonte ç'kishte thesi, kur papritur Kreshniku tha:

— Gjeta dhe një të tillë!

— Vërtet? — u habit babai. — Qenka gjë e bukur. Ja të tilla të kishim patur me shumicë. Si e gjete atje?

— Duhet ta ketë harruar roja.

— Këto janë të mira, s'shpëton dot nga goditjet e tyre.

Siç duket po bëhej fjalë për ndonjë armë, se armët kishin të tilla goditje, prej të cilave nuk shpëtoje dot.

Desha të shihja ç'armë mund të ishte ajo e dalëngadalë zgjata kokën përmes parmakëve të shkallës, kur, papritmas, dëgjova hapa. U ngrita rrëmbimthi dhe u futa në shtrat.

Nuk guxoja të dilja nga dhoma. Im vëlla vazhonte të flinte. Ata poshtë diç bisedonin. Kaluan

kështu disa minuta, që m'u dukën orë të gjata. Dëgjova zhurmë në oborr. Babai me nënën po përcillnin Kreshnikun. Hijet e tyre mezi shquheshin në oborr. Pastaj ata u kthyen, duke folur me zë të ulët. Pas pak, shtëpinë e mbuloi heshtja dhe errësira.

Doja të zbrisja poshtë e të shihja ç'kishte brenda ai thes, që më dukej se mbante tërë çudirat e botës, po babai e kish fshehur me kujdes nën shkallë e, po të zbrisja, me siguri do të bëja zhurmë.

### XIII

## BASTISJA

Gjithçka u zgjidh të nesërmen në mëngjes.

Unë e im vëlla u zgjuam vonë. Desha t'i tregoj ç'kishte ngjarë, kur papritmas u dëgjuan të trokitura. Po këtë radhë ato qenë të forta. Porta e vjetër sa nuk u shemb.

S'qe nevoja të zbriste njeri e ta hapte, se ajo nga të shtyrat, u hap dhe ne pamë të futeshin në oborr... disa ballistë dhe dy gjermanë.

Me një frymë e hapëm derën e dhomës. Atëherë vumë re babanë që po zbriste shkallët. Mamaja kish mbetur në mes të hajatit, pa ditur ç'të bënte.

Ajo u sul me rrëmbim në sirtarin e komodinës, rrëmbeu së andejmi atë letër të shkruar, e futi shpejt në gji dhe na bëri shenjë të mos flisnim. Dukej shumë e shqetësuar.

Zbrita shpejt shkallët. Mbas meje zbriti dhe nëna me tim vëlla, që dukej se e kish humbur fare.

E dija që ata ishin gjaksorë e s'ta bënë të gja-të. Kisha frikë se mos rrëmbenin babanë, ashtu si Kopin në fushë.

Njëri nga gjermanët, që dukej oficer, ju drejtua babait. U habita kur pashë pranë tij oficerin

mustaqemadh, të cilin Mirandi e kish goditur me top. Ishte dhe avokati me të birin. Oficeri gjerman ju drejtua babait, që dukej i qetë si të mos kish ngjarë asgjë. Ai nisi të flasë ngadalë, pastaj, siç duket, u nxeh, sepse e ngriti zërin. Se ç'liste, babai s'mund ta kuptonte. Atëhere ndërhyri avokati:

— Mbrëmë, — tha ai, — në depon e kazermës gjermane, që ndodhet poshtë mëhallës suaj, janë vjedhur shumë materiale ushtarake dhe disa armë. Vjedhësi nuk u kap, po materialet duhet të jenë të fshehura diku në mëhallën tuaj. Kudo do të bëjnë bastisje!

Ai i hodhi babait një shikim mospërfillës.

Babai e vështroi oficerin gjerman drejt e në sy e pastaj i tha:

— Mund të kontrolloni ku të doni, po do të jetë e kotë... këtu nuk do të gjeni asgjë.

Babai po ua fshihte të vërtetën. Kjo ishte një e vërtetë e madhe, për të cilën as që më kish shkuar në mendje. Përfytyrova ngjarjet në fushë, Kreshnikun, fjalët që i kish thënë si nëpër dhëmbë, duke i dhënë komunikatën, të trokiturat te porta, thesin, që mbante Kreshniku, bisedën në mesnatë.

Unë nuk kisha gabuar. Vërtet ishte bërë një vjedhje; po jo në ndonjë dyqan, po në depon e një kazermë gjermane. Këtë e kish bërë Kreshniku me shokë dhe babai kish lidhje me ta përderisa kishte ardhur njëri prej tyre në shtëpinë tonë. Babai kish lidhje dhe me partizanët, ndryshe nuk do t'i thoshte Kreshnikut: «Shokët do t'u falnderojnë!» Me siguri që ato materiale do t'u duheshin partizanëve.

Ja, kjo ishte e vërteta e madhe.

— Urdhëroni, urdhëroni lart! — tha babai duke u lëshuar rrugën.

— Vetëm lart kini dhoma? — pyeti oficeri mustaqemadh.

— Siç e shihni vetëm lart! — pohoi babai. — Po urdhëroni, mund të kontrolloni ku të doni!

Ata u ngjitën lart. Shkallët kërcitën nga goditjet e çizmeve dhe të këpucëve të rënda me gozhda.

Pandeha se do të ngjiteshin të gjithë, po vura re se një ballist (edhe ai i kishte mustaqet e mëdha si të ofiercit), qëndroi poshtë, pranë shkallës.

Nëna, sipër shkallëve, po ndiqte me vëmendje çdo veprim të tij. Ai vente e vinte në hajatin e poshtëm të shtëpisë sonë.

Ajo qëndroi ca e pastaj, për të zhdukur çdo dyshim u ngjit sipër, ndërsa unë dhe im vëlla mbetëm vetëm me ballistin. Nga sipër trokitjet e çizmeve dhe të këpucëve me gozhda dëgjoheshin aq të forta sa dukej se tavani do të shembej nga çasti në çast. Sipër po bëhej rrëmujë e madhe e gjer-manët e ballistët po kërkonin në të gjitha skutat.

Qendruam disa çaste pa folur. Ballisti na hodhi një vështrim të ftohtë dhe mbështeti pushkën në gjunjë. Ashtu siç po rrinte ishte shumë mirë. Mirëpo ai shpejt mund të mërzitej e ndoshta... ndoshta, duke vështruar përreth, do të kthente kokën prapa, do të hiqte dërrasën, do të bëhej kurreshtar të shihte ç'kishte nën shkallë e atëhere... do të pikaste thesin, që kish fshehur babai.

— Duhej bërë diçka që t'i tërhiqej vëmendja. Po çfarë?

— Pushkë e bukur! — i thashë.

— E bukur është, tha ballisti me një zë të vrazhdë.

— Qëllon mirë?

— Aq sa s'bëhet.

— Ta shoh pak — foli vëllai, që nuk përmbahet kur shihte diçka që i bënte përshtypje.

— Hy, tutje, se t'i zbraza trutë!

Djali i avokatit që kish qenë sipër, zbriti shkallët e na u afrua. Me sa duket edhe atë po e tërhiqte pushka dhe përdorimi i saj. Ballisti që e dinte se i biri kujt ishte, e përkëdheli dhe filloi ti tregojë se si shtihej me pushkë. Mua më vinte inat e doja ta shembja në dru birin e avokatit, që krekosej gjithnjë si gjel.

E urreja, aq sa urreja dhe të jatin, që ishte spiun i gjermanëve dhe i ballistëve. Duhej patjetër t'i tregoja tim vëllai se si qëndronte puna, ndaj e tërhoqa për dore në oborr. Nisa t'i flas. Ai më dëgjoi me vemendje dhe pas çdo fjale vija re që ngrysej, po, tek më shihte mua rishtaz, e mblidhte veten.

Hymë brenda. Ballisti foli e foli, pastaj, me sa duket, u mërzit e pushoi. Tani po mundoheshim të gjenim një mënyrë si e si të tërhiqnim vëmendjen e ballistit, që dashur pa dashur mund të zbulonte thesin, kur papritur pashë Mirandin.

— Do të vini të luajmë? — tha ai, po u step kur pa të ulur në stol ballistin dhe aty pranë, djalin e avokatit që po e lëmonte pushkën.

— Ç'ka ndodhur kështu? — pyeti, pa arritur të kuptojë se ç'donte ballisti e për më tepër djali i avokatit në shtëpinë tonë.

— Bastisje — u përgjegj im vëlla.

— Përse?

I shpjeguam si qëndronte puna. Mirandi dëgjonte dhe gjithnjë e më shumë habitej. Ballisti,



me sa duket u mërzit e filloi të lëvizë. Sipër vazh-  
donte bastisja. Dukej se gjermanët po përmbysnin  
çdo gjë.

- Merre shpejt topin! — tha befus Mirandi.
- Topin! — u çudita unë. — E ç'hyn këtu topi!
- Merre shpejt! Ku e keni lënë?
- E di unë! — tha vëllai dhe u turr ta merrte.

Ai u kthye me topin në duar, në kohën kur unë  
dhe Mirandi i ishim afruar djalit të avokatit. Mi-  
randi e mori topin dhe filloi ta përplaste për tokë.

— Hajt, largohuni! Paskeni dhe top? — tha  
ballisti, duke na u afruar.

— Sa për të qënë, — u përgjegj Mirandi.

— Po ti kush je? — pyeti ballisti.

— Një nga kalamajtë e mëhallës.

— Pse erdhe këtu?

— Për të luajtur me top.

— Po ku luani ju?

— Luanim në një shesh.

— Po atëhere, marsh.

Duket se ballisti donte të na hiqte qafe. Ç'ju  
desh Mirandit t'i thoshte se kish ardhur për të luaj-  
tur! Pastaj s'e merrja vesh se përse e kërkoi topin.

Mirandi s'po dinte se ç'përgjigje të jepte, kur  
ndërhyri djali i avokatit:

— Nuk kanë se ku të luajnë! — tha ai, duke  
na shikuar me përbuzje.

— Në shesh, de! — foli ballisti.

— Nuk i le babai im të luajnë në shesh, — u  
krenua djali i avokatit dhe i tregoi ballistit histori-  
në që kish ngjarë atë ditë kur, duke luajtur me  
top, Mirandi kish goditur oficerin mustaqemadh. Si-  
kur ballisti ta kish ditur që fajtori s'ndodhej veçse  
dy metra larg tij, do ta kish kapur e patjetër do të

kish thirrur oficerin mustaqemadh. Atëhere do të ngjiste ç'do të ngjiste.

— Ashtu! — u ngrys ballisti. — Mirë ua paska bërë, — dhe duke u ulur në vendin e tij na vësh-troi vëngër.

Punët po shkonin keq. Po Mirandi ç'do të bën-te me topin në duar?

— Hë pra, zhdukuni! — u hakërrua ballisti.

Po Mirandi, nuk e përfilli fare hakërrimën, mori topin dhe filloi të godasë lehtë me këmbë, ndërsa ai i shqitej disa gisht nga këmba e pastaj, ngrihej lehtë pa rënë në tokë.

— Mor, po qenke djall i madh! — thirri i habi-tur ballisti. — Të godasësh topin njëzet herë pa rënë në tokë!...

E kuptova qëllimin e Mirandit.

— Njëzet herë s'janë gjë fare. Ai e mban edhe njëqind herë — thirra unë.

— Si ore? Pa provoje njëherë të shohim! — tha ballisti.

— Këtu është ca ngushtë, — foli Mirandi. — Dalim pak më tutje.

Ne u matëm të dilnim, kur në shkallët u dha nëna.

— Ku vini kështu? — pyeti ajo e habitur, kur pa që ballisti ish larguar pak nga vendi i rrezikshëm.

— Këtu jemi. Ja, po luajmë, — i thashë unë duke e vështruar drejt në sy.

Sytë e nënës ndritën. Si duket e kuptoi qëlli-min tonë.

Mirandi vazhdonte të mbante topin me goditje të lehta me këmbë, pa e lënë që të binte në tokë. Kurrë s'më kish shkuar ndërmend se do të vinte një ditë dhe kjo lloj loje do të shërbente kaq shumë.

Njëzet... tridhjetë... pesëdhjetë!...

Ballisti e kish përqendruar tërë vëmendjen te këmba e Mirandit që goditte papushim topin. Djali të avokatit s'po i vinte mirë.

— Edhe unë di ta mbaj me këmbë topin, — tha.

— Edhe ti? Mrekulli e vërtetë. Të shohim si do ta mbash edhe ti, — tha ballisti.

— Po jo me këtë top.

— Po me cilin?

— Me topin tim.

— Mirë, pra, me topin tënd, — thashë unë, duke e kuptuar që djali i avokatit gënjente.

— Po e kam në shtëpi.

— Shko, e merre!

Djali i avokatit, siç duket, mbeti ngushtë, u mat të nisej, po mbeti pranë derës, duke vështruar me zili Mirandin.

— Nëndëdhjetë... njëqind!... numëroi ballisti.

Mirandi qe mbuluar i tëri në djersë. Se sa qe lodhur, vetëm ai e dinte. As kokën s'e ngrinte, po ashtu i përkulur, vazhdonte të godiste topin e futbollit, që shqitej, ngrihej, ulej, po për të rënë në tokë nuk binte.

— Njëqind e dhjetë! I kaloi të njëqindat për besë! — thirri ballisti, që dukej se e kish humbur fare.

Ai mbase do të kishte vazhduar të numëronte, sikur në shkallë të mos ishte dëgjuar zhurmë. Siç duket ata po zbrisnin. Nëna, që e kish ndjekur tërë atë skenë, lëvizti. Lëvizti dhe ballisti. Ai rrëmbeu pushkën nga duart e djalit të avokatit dhe bëri drejt qendrim. Mirandi la topin të përplasej në tokë dhe fshiu djersët që i rridhnin në fytyrë.

I pari zbriti oficeri gjerman. Ai dukej i egër-

suar, ngaqë nuk kishin gjetur gjë në shtëpinë tonë. Pas tij zbritën dhe të tjerët.

Kishte ardhur çasti më i rrezikshëm. Po sikur oficeri gjerman të kujtohej të kontrollonte përreth! Ai qendroi, i hodhi një vështrim të ftohtë ballistit, që kish qëndruar si statujë pranë stolit dhe bëri përpara.

Ne morëm frymë. Nëna, për të mbajtur veten, ngriti flokët e zinj që i kishin rënë mbi ballë, ndër-sa babai ja kish ngulur sytë oficerit mustaqemadh.

— S'ka asgjë këtu? — pyeti ai ballistin.

— Këtu? Jo, jo këtu... këtu s'ka asgjë! — u përgjegj ballisti si duke e marrë veten.

Ata dolën në oborr. Pas tyre edhe ne.

— Djali juaj? — pyeti oficeri mustaqemadh babanë, duke treguar Mirandin.

— Jo, është një nga djemtë e mëhallës sonë, u përgjegj babai.

— Të tërë janë të prapë! — tha vrazhdë oficeri mustaqemadh, duke kujtuar, siç duket, goditjen që kish marrë atëhere te sheshi.

— Po, po, të padurueshëm, s'na lënë fare të qetë! — tha avokati, duke na parë tërë inat. — Gjithë ditën në shesh luajnë.

— Epo të vegjël janë, — tha babai.

— Po bëjnë zarar të madh. E dini se në rrugicën tonë janë vënë komunikata?

— Pandehni t'i kenë vënë këta? — pyeti me habi të shterur babai.

— Ku dihet! Edhe prej tyre duhet patur frikë.

— Të jeni të sigurtë se këta vetëm të luajnë me top dinë, — tha babai.

— Edhe me top të luajnë sa më rrallë — ndërhyri oficeri mustaqemadh. — Në shtëpi të rrinë tërë ditën. Muarët vesh?

— Siurdhëron, tërë ditën në shtëpi do të rri-  
në, — përsëriti si me tallje nëna.

Ata u zhdukën prapa portës.

Këtë radhë morëm frymë; sikur të ishim çliru-  
ar nga një barrë e rëndë. Unë e im vëlla ju hodhëm  
Mirandit në qafë. Nëna u afrua dhe na përqafoi të  
tre.

— Gjithçka e kemi nga këta! — tha nëna, pa  
i shkëputur duart nga ne.

— Si nga këta? — pyeti duke zvarisur fjalët  
babai.

Nëna i tregoi babait fill e për pe çfarë kishte  
ndodhur. Pas çdo fjale, fytyra e tij çelej.

Edhe babai na përqafoi si nuk na kish përqa-  
fuar kurrë. Përqafoi edhe Mirandin, sepse ai ishte  
shpëtimtari. (Unë, të them të drejtën, e pata zili.)  
Im vëlla krenohej se edhe atë e kishin quajtur  
shpëtimtar, megjithëse ai vetëm kish parë çfarë  
kish ndodhur. Mirëpo unë as që e kisha mendjen  
t'ja thoshja këtë.

Po kalonim çaste të lumtura.

— Duhet të kishim besim te djemtë tanë! —  
tha nëna.

— Vërtet! — pohoi babai. — S'e dija që, kaq të  
vegjël ta bënin një punë kaq të madhe.

Megjithëse fjala «të vegjël» s'na pëlqente, se  
donim të rriteshim sa më shpejt e të quheshim të  
mëdhenj, ajo nuk na bëri përshtypje, sepse, siç tha  
babai, ne kishim bërë shumë, ndoshta aq sa mund  
të bënin të mëdhenjtë.

Tani e dinim se thesin e madh, me armë dhe  
materiale të tjera, që Kreshniku ua kish rrëmbyer  
gjermanëve, do ta shpinin në mal.

Kjo ishte lumturi e madhe për ne.

## XIV

### DIÇKA DO TË NGJISTE

Kaluan kështu disa ditë. Ne dolëm përsëri rrugicave të mëhallës sonë të vjetër, ku gjermanët dhe ballistët kishin bërë bastisje. Vinim re që burra e gra, ndërsa ne grumbulloheshim këndeve, pyesnin njëri tjetrin me zë të ulët:

— E, gjetën gjë?

— Asgjë...

— Ndoshta do të ketë qenë ndonjë nga mëhallat tjetër.

— Ndoshta!

Ata fjaloseshin dhe për vrasjen e ballistit në fushën e futbollit, vrasje që kish marrë dhenë. Flisnin edhe për ngjarje të tjera që ne s'i kishim degjuar.

Edhe kalamajtë kështu fjaloseshin. Madje kishin edhe nga ata që, duke pandehur se unë dhe im vëlla nuk dinim gjë, fillonin të na tregonin se ç'kishte ngjarë në kazermën e gjermanëve. Ne shikoheshim sy në sy, por heshtnim. Edhe Mirandi heshte. Babai na kish porositur të mos nxirrnim fjalë nga goja. E kuptonim se ç'gabim do të ishte,

sikur, padashur, të na shpëtonte gjëkafshë, megjithëse, tek i shihja ashtu kalamajtë, më vinte, t'ua thosha të gjitha një për një.

E merrja me mend se ç'do të ndodhte atëhere. Kalamajtë do të na rrethonin e do të kërkonin të dinin më shumë. Sigurisht, ata do të kërkonin të dinin më shumë nga Mirandi, të cilit i kishte rënë ndërmend t'ja tërhiqte aq bukur vëmëndjen e ballistit. Po do të pyesnin pastaj edhe për Kreshnikun, që ishte zhdukur pa lënë gjurmë.

Madje ngandonjëherë, kur qëllonte të isha vetëm në shtëpi, filloja dhe unë të luaja me top e përpiqesha ta mbaja sa më shumë. Atëhere mendoja se, po të rastiste të vinin ballistët përsëri në shtëpi për të kontrolluar, do të bëja ashtu si Mirandi.

Mbrëmjeve në shtëpi babai me nënën nuk flisnin më me zë të ulët, siç ndodhte më parë, kur ne, të pushtuar nga një kureshtje e madhe, mbanim veshin ngrehur, për të kapur qoftë edhe një fjalë nga ato që thoshin. Nga bisedat në merrnim vesh se babai kishte lidhje me partizanët e këto lidhje bëheshin me anë të Kreshnikut, që nuk shihej gjëkund.

— Kush e vrau komandantin ballist? — pyeta një natë babanë. — Mos ishin ata të maleve?

— Po, ata të maleve, partizanët! — u përgjigj babai.

— Edhe Kopi është me ta!

— Edhe Kopi.

— Po pse, ka qenë në mal? — pyeti vëllai.

— Jo!

— Si qenka atëhere nga ata të maleve, përderisa nuk ka qenë atje?

— Po armikun nuk e luftojnë vetëm ata të maleve, po dhe ata të qyteteve.

— Çfarë bëjnë ata?

— Djegin depo, maqina, vrasin spiunë, siç vranë komandantin ballist.

— Kush janë këta që i bëjnë? — pyeta unë.

— Njerëzit e varfër revolucionarë si Kopi, Kreshniku, e të tjerë.

— Po ti, baba?

Babai qeshi.

— Sot populli, po bën çmos për të ndihmuar ata të maleve, partizanët, madje dhe fëmijët.

— Po ç'bëjnë fëmijët? — pyeti vëllai.

— Ja, atë që bëtë ju, atë që bëri Mirandi. Edhe gomat e maqinave i shpojnë, edhe telat e telefona-ve i presin.

— Vërtet, edhe këto i bëjnë, baba? — u çudit im vëlla.

— Jo vetëm kaq, po edhe në mal dalin.

Pas këtyre fjalëve, ajo që kishim bërë ne na u duk si puna më e lehtë në botë, që mund ta bënte edhe një fëmijë që sapo kish filluar të ecte, ndaj u shikuam sy në sy me vëllanë dhe e ndjemë veten të pikëlluar.

Babai si të na kish blerë mendjen, foli:

— Po mos kujtoni se këta janë të vegjël si ju. Jo, këto ju s'mund t'i bëni, sepse janë punë të rënda që i bëjnë fëmijët e rritur si Kreshniku, që është pesëmbëdhjetë vjeç.

— Po, kur të rritemi, dhe ne do t'i bëjmë këto, — e ngushëlloi veten im vëlla.

— Ç'thua ashtu — qeshi babai. — Domethënë ti dashke të qendrojmë dhe disa vjet të pushtuar nga gjermanët, që tani po u vjen fundi!



Im vëlla këtë radhë, ashtu si dhe herë të tjera, ish nxituar dhe kish nxjerrë fjalë të papjekura nga goja.

— Po Kopin me ata të dy të tjerët, do t'i mbajnë shumë në burg? — i thashë pastaj babait.

— Do t'i mbajnë. — u përgjigj babai.

— Ç'do t'i bëjnë pastaj? Nuk do t'i lëshojnë? Babai u ngrys e nuk foli.

— Armiqtë janë egërsuar më shumë nga vrasja e komandantit ballist e po i mundojnë tmerrësisht që të thonë kush ishin ata që qëlluan. Po trimat nuk tregojnë kurrë, — tha babai si atë natë pas ndeshjes.

— Ç'do t'u bëjnë atëhere?

— Mund edhe t'i vrasin...

Ne u premë fare. Që po i mundonin, këtë e dija, po që mund t'i vrisnin, kjo s'më kish shkuar ndërmend.

Çdo të ngjiste?

**PUSHKATIMI**

Atë natë u zgjuam të trembur. Nga dritarja gjysmë e hapur u dëgjua zhurma e një maqine. Në rrugën tonë, kurrë s'kalonin natën maqina, prandaj na bëri përshtypje. Duhej të ishte një maqinë e madhe, sepse edhe zhurma ishte e madhe. Unë dhe im vëlla s'po merrnim vesh se ç'po ngjiste.

U dëgjuan ca zëra, pastaj të thirrura nga larg që arrinin gjer te ne. Dëgjua të hapet dera e dhomës. Babai me nënën qenë ngritur. Ata u afruan te dritarja, që binte nga rruga. Pas tyre edhe ne. Siç duket ata donin të shihnin se ç'po ndodhte. Por ishte kaq errësirë sa asgjë nuk shquhej.

Të thirrurat sa vinin e shtoheshin: Në qetësinë e natës ato dëgjoheshin gjithnjë e më qartë:

— Nëna, vëllezër, mos u dëshpëroni!

— Liria po vjen. Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

— Vdekje nazistëve dhe tradhëtarëve!

U dëgjuan pastaj ca britma të çjera, pastaj përsëri ato thirrjet që po humbisnin në errësirën e natës së bashku me zhurmën e maqinës.

— Mos janë ata? — pyeti nëna.

— Ata do të jenë me siguri. Po i çojnë për t'i pushkatuar...

Ne u drodhëm. Cilët ishin ata që po i çonin për t'i pushkatuar?

— E tmerrshme! — psherëtiu nëna.

Sigurisht, nëna e kishte fjalën për ata që thërrisnin. Po atyre nuk u dukej e tmerrshme kjo vdekje, përderisa thërrisnin: «Mos u dëshpëroni, ne po vdesim të lumtur!»

Desha të pyes babanë, po atë çast u dëgjuan disa krisma pushkësh. Ne u drodhëm; babai s'foli fare. Doja të shihja, po në errësirë nuk shquaja asgjë. Me siguri fytyra e babait shprehte urrejtje e zemërim për xhelatët.

U dëgjua pastaj një breshëri e zgjatur. Po shtinin me sa duket me mitraloz. Pastaj heshtje...

— Të mjerët djem! — tha nëna me zë të ngashëryer. — I vranë gjaksorët!

— Kë vranë? — s'm'u durua mua pa pyetur.

— Kopin, bir, Kopin me shokët e tij! — u përgjegj babai.

Kopin e kishin vranë! Kopin që kishim parë të luante aq bukur në fushë, Kopin që kishte lidhje me partizanët në male.

Ndjeva një lëmsh të madh të më mblidhej në grykë. U përplasa në shtrat dhe nisa të qaj. Dhe im vëlla po qante. Nëna dhe babai nuk thoshin asnjë fjalë.

S'vumë gjumë në sy. Agimi sikur po ulej nga malet e trishtë, i lodhur, ndërsa qielli sikur po thithte re të dendura, që po mblidheshin mbi qytetin tonë.

U ngritëm. Kishim vetëm një dëshirë: të shkornim te vendi i pushkatimit.

Babai me nënën nuk na lanë, po ne bëmë si bëmë dhe dolëm në rrugë. U kthyem nga e majta e morëm lumit, që ndodhej jo shumë larg mëhallës sonë. Me ne që bashkuar dhe Mirandi. Pak më prapa vinin dhe fëmijë të tjerë.

Ne vraponim, se kishim frikë mos gjerim nët dhe ballistët merrnin trupat e tyre. Sa më shumë afrohesha, aq më tepër ndjeja që fuqitë po më lirin. Nuk mund të besoja që Kopin ta kishin vrarë.

Arritëm më në fund. Qenë mbledhur shumë njerëz të tjerë: burra, gra dhe fëmijë. Kufomat nuk i kishin trazuar. Siç thanë, ato do t'i lirin gjithë ditën aty, që t'u kalnin datën banorëve të qytetit. Rreth të vrarëve dukeshin nja tre ballistë, që nuk lejnin njeri të afrohej.

Njerëzit gjithnjë shtoheshin. Të gjithë dukeshin të mpirë, të heshtur, me urrejtje në vështrimin e tyre për vrasësit.

U afroam ca më pranë. Doja të njihja Kopin. Dhe e njoha. Ishte në mes, me kokën kthyer nga qielli e buzët e mbledhura, ashtu siç i kisha parë ato buzë t'i mbledhte kur godiste topin atje, në fuqinë. Një plumb e kish shpuar mu në ballë. Në trup nuk kishte asnjë shenjë gjaku, po këmbët sikur i kishte të thyera.

Një plak aty pranë mezi përmbante veten.

Unë pandeha se mos ishte i ati i Kopit apo i ndonjerit prej të vrarëve, po nuk ishte kështu.

— Vështroja nga dritarja e shtëpisë, — thoshte plaku, duke treguar me gisht dritaren e një shtëpie të vogël e të vetmuar aty pranë, — djemtë që ndronin sytë prej njeri pranë tjetrit. Këto biasha të mallkuara i qëlluan shpejt, sikur të kishin frikë prej tyre. Qëlluan së pari këta dy djemtë

anash. Ai në mes mbeti më këmbë. «Qëlloni frikacakë, — thërriste ky, — po vdekja do t'ju vijë shpejt». Dhe ata e qëlluan, jo me pushkë, po me mitraloz. E qëlluan në këmbë. Ai u këput e ra. Këta bisha kënaqeshin duke e parë ashtu e gajaseshin. Ai e mblodhi veten dhe nuk bëri zë. Se ku e kish gjetur atë fuqi ashtu i këputur! I afroi kufomat e dy shokëve pranë vetes. «Po ju vjen fundi, si miu do të ngordhni!» — u tha ai me një zë tinglles. Dikush nga ata ju afrua. Pashë se si djaloshi mblodhi grushtin dhe e ngriti lart. Një nga ata bishat e mallkuar uluriu. Një tjetër nxori nga këllefi revolverin dhe e qëlloi drejt e në fyt.

Pranë nesh pamë të afrohet avokati me të birin si gjithnjë të krekosur. Avokati shtynte sa majtas djathtas, për të qënë sa më pranë. Pas tij vinte i biri. Ca më tutje pamë dhe Kreshnikun, që dukej shumë i vrarë e i zemëruar në fytyrë. Po Kreshniku nga mbiu kështu? Siç duket dhe ai kishte ardhur për të parë Kopin, të cilin, ashtu si ne, duhet ta kish dashur shumë. I bëmë shenjë me dorë, po me sa duket, ai nuk na pa.

— Ja, shikoi! — i tha avokati të birit. — Kështu e pësojnë ata që ngrenë krye. Edhe kush? Këta zbatharakët, që s'e ngopin barkun kurrë...

Ai e ngriti zërin lart, siç duket që ta dëgjonin të tjerët.

Në turmë u dëgjuan murmuritje.

— Babi, ky që e kanë qëlluar në fyt, mos është ai që luante me top? — pyeti djali i avokatit.

— Hë, ai është! — u përgjegj i ati. Gjeti atë që kërkonte!

Përsëri në turmë u dëgjuan murmuritje. Të gjithë i kishte pushtuar urrejtja.

— Ç'maskara! — tha plaku.  
Avokati ktheu kokën dhe e shikoi plakun nga koka gjer te këmbët.

— Kujt i thua maskara? — ju kërcënua duke ju afruar.

— Ty! — ju përgjigj plaku. — Ja ku po ta them përsëri: je njëqind herë maskara.

— Si guxon ti! — uluriu avokati. — E di ti që unë të bëj...

— E ç'do të bësh ti, kërmë! Tani juve të tërëve po ju vjen fundi. — Asgjë s'ju shpëton.

Avokati i xhindosur e kapi plakun për fyti. Turma lëvizi.

— Roje, kapeni këtë. Është komunist! — briti avokati.

— Këtë di të bësh ti, maskara. Ptu! — foli plaku dhe e pështyu avokatin në fytyrë. U bë rrëmujë. Shumë ju sulën avokatit. Atëhere nga turma u shkëput Kreshniku. Ai e goditi avokatin me pëllëmbë në fytyrë. Avokati uluriu, zgurdulloi sytë e, duke vënë re se të gjithë po e shikonin sikur do ta hanin, ua mbathi, duke marrë me vete djalin e tij.

Po ne me Mirandin qemë vërsulur. Në atë kohë Mirandi e kapi nga këmisha djalin e avokatit. Ai përpiquej t'i shqitej e thërriste me kuje:

— Paskë ardhur edhe ti këtu? — i thoshte Mirandi. — Do të ta bëj turirin përshesh, more qurraman!

Megjithëse nuk ishte rasti, ne gati sa nuk qeshnim. Ndërhynë rojet. Mirandi, pasi i dha një shqelm në prapanicë djalit të avokatit, u zhduk në turmë.

Dy nga rojet balliste kishin kapur plakun nga duart e donin ta merrnin përpara.

— E ç'mund të bëni ju! — thërriste plaku. —

Ja, më vratë mua, pandehni se do të shpëtoni, more qyqarë?...

Njeri nga rojet e goditi plakun me kondak nga prapa. Plaku u rrëzua e koka ju përplas pas një guri. Filloi t'i rrjedhë gjak.

Atëhere disa njerëz nuk u përmbajtën, po ju sulën ballistëve. U sul dhe Kreshniku. Ata të tmerruar lëshuan plakun. Njëri nga ballistët qëlloi kurturu, në ajër. Nga kreu i udhës u duk një patrullë që u përgjigj me të shtëna pushkësh. Ajo po afrohej.

Njerëzit filluan të largohen. Ne kaluam përmes disa shtëpive në një rrugicë e s'andejmi dolëm në rrugë. Nga larg pamë Kreshnikun që po zhdukej. Ku vente ai?

Kishin ndodhur gjëra që nuk i pritnim: ata tre ballistët e kishin patur pisk. Edhe avokati me të birin, që kishin shpëtuar si kishin mundur. Ndonëse ne ktheheshim me shpirt të lënduar nga vdekja e Kopit dhe e shokëve të tij, prapëseprapë ndjenim një gëzim: na dukej se edhe ne ishim përleshur me armikun, për të cilin ai plaku me flokët borë të bardhë nga thinjat, kishte thirrur: «Tani juve të gjithëve po ju vjen fundi!»

Arritëm me një frymë në shtëpi. Po mudo-heshim të shpiknim ndonjë gënjeshtër, po nga ana tjetër na e kishte qejfi edhe të tregonim të tëra ato që kishin ndodhur.

Fundja, përse të gënjenim?

Nëna u shqetësua kur na pa ashtu të lodhur, ndërsa babai u bë kureshtar të dinte se ç'kishte ndodhur. Nisëm t'i tregojmë. Ja rrëmbenim fjalën njeri tjetrit nga goja, sepse secili donte ta tregon-te i pari.

— Njëri të flasë, se asgjë s'po marr vesh! —  
tha babai, duke rrudhur ballin.

Si më i madh që dukesh, megjithëse ishim binjakë, fola unë, se, po të tregonte im vëlla, ngaqë nxitohej, do t'i thosh fjalët gjysma-gjysma. Babai dhe nëna më dëgjuan me vemendje dhe, pas çdo fjale, vija re se fytyrat e tyre çelëshin.

— Ja ç'forcë ka populli! — tha babai duke e bërë dorën grusht. — Të dërrmon!

Vonë, si u rrita kuptova domethënien e këtyre fjalëve.



## XVI

### E PAPRITURA NË SHTËPINË E PAMBARUAR

Poshtë mëhallës sonë, në një fushë të lënë shkretë, kishin filluar të ndërtonin një shtëpi. Më parë ne kishim lakmuar që të luanim atje, mirëpo planet na i prishi shtëpia që po ngrihej midis blerimit si një kërpudhë e stërmadhe.

Shtëpia ishte e një pasaniku, që e kish blerë atë copë tokë pa kursyer asgjë. Megjithëse kishte muaj që po punohej, shtëpia ende s'po mbarohej. Madje njëra prej dhomave nuk ishte shtruar ende me dysheme. Shpesh punëtorët, për të kaluar nga koridori në dhomat e tjera, ecnin me kujdes nëpër trarët e mëdhenj, duke mbajtur tullat, llaçin apo tjegullat, ashtu si pelivani që shkel me kujdes mbi telin e hollë e ruan drejtpeshimin me shkopin e gjatë që mban në duar.

Ne kishim bredhur shpesh nëpër të hyrat e të dalat e asaj shtëpie e kishim luajtur symbyllazi. Po atë pasdite unë, im vëlla e Mirandi ishim ulur në një pirq rëre e bluanim me mendje të gjitha ato që kishin ngjarë.

Dielli kishte perënduar e mëhalla jonë po

mbështillej dalëngadalë nga hijet e mugëta të mbrëmjes.

Ndoshta ne ishim vonuar shumë e po bëheshim gati të ktheheshim nëpër shtëpitë tona, kur papritur pamë të vinte duke vrapuar në drejtimin tonë një djalë. Ngaqë ishte larg, nuk e njohëm, po, kur u afrua, vumë re se ai ishte Kreshniku.

Përse po vraponte?

Që të tre u ngritëm në këmbë. Kishim ditë që nuk e kishim parë Kreshnikun. Dhe ja ai tani na doli para syve i larë në djersë, i kapitur, duke marrë frymë me vështirësi.

Nga pas, shumë larg, dëgjoheshin britma, hapa që trokëllinin në rrugë. Një gjë ishte e qartë: Kreshnikun po e ndiqnin. Ne nuk patëm kohë të shkëmbejm asnjë fjalë, po e kuptuam njeri tjetrin.

Kreshniku i hodhi shtëpisë së pambaruar një vështrim të nxituar e u sul nëpër shkallë. Pastaj papritur u kthye nga ne dhe tha:

— Ata po më ndjekin, ju mos bëni zë. Do të fshihem këtu.

Ne u vrëjtëm. Ai shtërngoi dhëmbët, rrëmbeu një copë dru të trashë anës shkallës dhe u zhduk brenda shtëpisë, që sakaq e përpiu me gjymtyrët e saj.

Britmat dhe kërcitjet e këmbëve tani po afroheshin dhe më shumë. Ne pamë në krye të rrugës oficerin mustaqemadh më nja dy a tre xhandarë.

Ata qëndruan disa çaste më mëdyshje. Pastaj oficeri mustaqemadh u tha atyre që të shpërndareshin e të viheshin në ndjekje.

Ai vetë po afrohej drejt nesh.

Ne heshtnim. Sa më shumë afrohej, aq më te-

për shquanim tiparet e tij të egra që genë nxirë, ashtu si mustaqet e zeza që i vareshin deri poshtë buzëve. Ai po afrohej me hapa të ngadalshme, duke mbajtur në dorë koburen që shkëlqente në muzgun e mbrëmjes.

Unë ndjeva një drithmë të ma përshkojë tërë trupin, ashtu si netve të ftohta kur nëna më trengonte ndonjë përrallë të frikshme.

Mirandi, sikur të mos kishte ngjarë gjë, filloi të lozte me rërë. Im vëlla, tek e pa, rrimbeu një çekan e nisi të godasë disa gurë. Unë nuk pata kohë të bëja asnjë lëvizje, se atë çast oficeri mustaqemadh, duke na u afruar, tha:

— Ah, ju qenkeni!

Ai qëndroi dhe tundi koburen që mbante në duar.

— Çfarë bëni këtu? — pyeti me ashpërsi.

— Po luajmë, u përgjigj im vëlla.

— Keni kohë?

— Ndonjë orë.

— A patë njeri të kalonte kënde?

Ne heshtëm dhe u shikuam sy më sy.

Po tani ç't'i thoshim?

Mua filloi të më rrihte zemra me të madhe.

El merrja me mend se kështu do t'i rrihte zemra dhe tim vëllai dhe Mirandit.

Po duhej thënë diçka, nuk i duhej lënë asnjë çast oficerit që të dyshonte.

— Pamë një burrë që vraponte... thashë unë. As vet s'e di si më dolën ato fjale nga goja.

— Një burrë? — tha duke ngrysur ballin oficeri.

— Po, po, një burrë. Ai vraponte si i çmendur.

Kish një kapele në kokë, një thes në shpinë, — shtoi Mirandi si për të më ardhun në ndihmë.

— Po koburen e harrove! — thashë unë.

— Si, mbante dhe koburë? — pyeti rishtas oficeri ballist.

— Koburë dhe çfarë kobureje, — ja ktheu im vëlla. — Nja dy herë më të madhe nga ajo që mban zotrote.

— Po nga vajti?

— Kaptoi fushën prapa shtëpisë dhe vrápoi poshtë, — tha im vëlla.

Mirëpo, si gjithnjë, dhe këtë radhë ishte nxituar se fusha zgjatej kaq shumë, sa ishte vështirë të zhdukesh brenda pak sekondash, pa u vënë re.

Duket se oficeri mustaqemadh nuk e gëlltiti këtë e, ndërsa ne po mendonim të thoshim ndonjë gjë tjetër për ta ngatërruar, na u hakërrye:

— More edepsëzë, ju po më gënjeni! E para e punës ai që ka kaluar këndeje, nuk është burrë, po një spurdhjak më i madh se ju. E dyta nuk ka ikur, po fshihet diku këtu.

— Jo për kokën e nënës nuk kemi parë ndonjë të tillë të kalojë këndeje, — tha si pa të keq Mirandi.

— Hë, ç'jeni ju, — na kërcënoi oficeri, — bëni dhe sikur s'e njihni! Kaq shpejt e harruat? Po ju kini luajtur kaq herë me të! Hajde, mos e zgjatni shumë tani, se ndryshe në hell do t'ju pjek...

Ai tundte koburen që mbante në duar.

— S'kemi parë gjë! — nguli këmbë im vëlla. — Po ju meqë nuk besoni futuni e shikoni.

Oficeri mbeti për një çast, pastaj tha:

— S'thua keq ti, veçse do ta pësoni dhe ju në goftëse nuk më keni thënë të vërtetën.

Me këtë përgjigje që i dha, m'u duk sikur vëllai i kish ngatërruar të tëra...

Si të bënim që oficeri të mos futej fare në shtëpi?

Tani nuk kishim kohë as të mendonim, aq më tepër që oficeri me kobure në dorë filloi t'u ngjitej shkallëve.

Pastaj qëndroi një hop dhe ktheu kokën nga ne. Mirandi filloi të fishkëllente. Unë dhe im vëlla e mblodhëm veten. Gjithë puna ishte që oficeri mustaqemadh të mos kuptonte asgjë.

— Ejani dhe ju, — na kërcënoi — shpejt pas meje!...

Ai tundi koburen. Fytyra i ishte nxirë. Buzët i dridheshin. Ishte e qartë: Kish frikë se mos Kreshniku do ta sulmonte papritur. Kështuqë, për siguri, na vuri ne përpara.

Kaluam në koridorin e errët të shtëpisë.  
Ku mund të ishte Kreshniku?

Heshtje, heshtje...

Mirandi më vështroi me ngulm. Sytë e tij shkrepëtinin. Ai nuk kishte frikë. As im vëlla. As unë.

Po ç'do të ngjiste tani?

Ne ecëm përpara. Pas nesh oficeri. Diku ishte dhe Kreshniku. Po ku, në cilën dhomë?

Heshtje si në ato përrallat e frikshme.

Po më rrihte zemra. Dhe sytë po më visheshin. Nga frika?...

Jo, jo... Po tani oficeri mustaqemadh na shtynte drejt derës që të çonte në dhomën pa dysheme. Atje ishin vetëm trarë, që, nga errësira, nuk shquheshin.

Një hap të bëje me vrull, dhe...

Duhej bërë diçka. Diçka e madhe dhe e rrezikshme. Po, duhej bërë. Befas një mendim më shkrepri në kokë.

U ndala dhe u ktheva. Mirandi dhe im vëlla më vështruan me habi, oficeri mustaqemadh kap-salliti sytë.

— Ç'është? — pyeti ai me gjysmë zëri.

— Këtu — i bëra shenjë unë.

Oficeri shtrëngoi koburen. Sytë i ndrinin. Mirandi dhe im vëlla u zbehën në fytyrë. E dija se ç'mendonin ata për mua. «Po duroni. Pas pak do ta kuptoni të vërtetën».

Oficeri s'dinte ç'të bënte? Ndoshta priste të vinin xhandarët. Atëhere do të ishte vonë.

Eca drejt derës. Pas meje oficeri. Ai turfu-llonte.

Nuk e merrte me mend së ç'e priste pas derës, në dhomën pa dysheme. Dë të këpuste qafën; në mos po do ta qëllonte Kreshniku, që ndoshta ishte fshehur atje.

Ai ngriti koburen, shtërngoi dorezën e derës, na vështroi me sy të tmerrshëm e u sul brënda. Ne pamë se si trupi i tij rrëshqiti përmes trarëve dhe humbi teposhtë. U dëgjua një klithmë, një përplasje, një rënkim. Asgjë më shumë.

Ç'u bë?

Këtë donim të dinim dhe ne të tre. Po, poshtë, i ngrirë, kish mbetur oficeri mustaqemadh.

Anës murit dëgjuam zhurmë, kthyem kokat dhe pamë Kreshnikun me shkopin në dorë. Ai eci lehtas nëpër trarë dhe na u afrua.

— Ka vdekur — tha ai. — Ndryshe do ta ngordhja unë.

— Si, ka vdekur? — pyetëm ne.

— Top në vend. Tani të ikim. Ata mund të vij-  
në sa më parë. Ju shkoni drejt e në shtëpi!

— Po ti, Kreshnik?

— Mua nuk do të më shihni më. Do të dal  
partizan. Lamtumirë!

Ai u zhduk përmes hijeve të mugëta. Këto  
ndodhën shumë shpejt.

Ne vrapuam për nga mëhalla jonë. Nëna kish  
dalë në krye të rrugicës.

— Ku qetë? — na pyeti ajo.

«Ah moj nëna jonë, ta dish ti se ku kemi qenë  
ne! Atëhere kur bëhej bastisja ty as që të shkonte  
mendja se ne do të bënim diçka më rëndësi. Po sot,  
moj nënë, ne kemi bërë një gjë edhe më të ma-  
dhe!..»

Vetëm kur u futëm në dhomë, nëna mori frymë  
lirisht.

Ajo nisi të na qortonte si disa ditë më parë.  
Erdhi dhe babai, si gjithnjë ishte i qetë.

— E di ç'kemi bërë ne? — tha vëllai.

Atij s'i rrihej pa folur i pari. Dhe filloi të  
tregojë fill e për-pë ç'kishte ndodhur.

Babai dhe nëna u habitën e na përqaftuan, si  
atëhere kur ballistët dhe gjermanët kishin basti-  
sur shtëpinë.

— I kemi të zgjuar fëmijët tanë, — tha nëna.

— Edhe të guximshëm, — shtoi babai.

Ai na kish folur për aksionet e fëmijëve që  
ishin pak më të rritur se ne. Atëhere na pat ar-  
dhur keq që nuk mund të bënim ndonjë aksion.

Po ja që kishim shpëtuar Kreshnikun nga  
thonjtë e armiqve, ishim bërë shkas që të vritej  
oficeri mustaqemadh.

Pse, ky nuk ishte një aksion?

## XVII

### DITË TË VRULLSHME

Ditët më dukej së vraponin. Qenë ditë të vrullshme, të mbushura me ngjarje të reja. Çdo mbrëmje, sa vinte babai, ne do të dëgjonim diçka të re. Lajmi i vdekjes së oficerit mustaqemadh qarkullonte në tërë mëhallën. «U lumtë atyre që e vranë Kreshniku që kish dalë partizan. Neve s'na vinte mirë që nuk dinim të vërtetën. Po do të vinte një ditë dhe do ta mësonin e atëhere do të na përgëzonin. Armiqve u kishte hyrë frika në palcë. Një mëngjez u gjend i vrarë para derës së shtëpisë së tij një spiun ballist; mbiri kufomën e tij kishin shkruar: «Kështu do ta pësojnë gjithë ata që kanë tradhëtuar. atdheun».

Edhe në e përdornim fjalën «tradhëti». Kish rastisur që ndonjë shoku ynë, në lodrat që bënim në mëhallën tonë të vjetër, të linte shokun e tij të ngushtë e të bashkohëj me një tjetër. Këtë ne e quanim tradhëti. Po të tradhëtoje atdheun, sigurisht ishte një gjë shumë e madhe. Tradhëtarë të tillë kishin qenë oficeri mustaqemadh spiuni ballist. I tillë ishte edhe avokati, që tani e shihnim rrallë. I



biri s'shihej fare. Kishin marrë, me sa duket, tmer prej atyre që e kishin pësuar para disa ditësh.

Armiqtë ruheshin. E kishin humbur krenarinë e mëparshme, nuk kapardiseshin më.

Ne nuk kishim më ndrojtje të dilnim te sheshi para shtëpisë së avokatit për të luajtur me topin tonë me fshikzë.

Po, ç'është e vërteta, tani nuk luanim shpesh. Kishin ardhur kohë të tjera.

Kreshnikun e kujtonim gjithnjë. Na kishte marrë malli për të. Kujtonim ditët kur ai, ndonëse disa vjet më i madh se ne, kishte luajtur me top e na kishte mësuar të fshehtat e asaj loje që na kish bërë për vete.

Njeriun, që miratonim më tepër tani, ishte Kreshniku, sepse kishte dalë partizan.

Po të kishim qenë të mëdhenj, ne patjetër do të kishim dalë partizanë. Mbyllja sytë e sillja ndër-mend se si Kreshniku kishte kaluar atë mbrëmje të shtëpia e pambaruar e ishte hedhur tutje lumit, përmes fushave, në mal. Atje partizanët do ta kishin pritur krahëhapët, siç prisnin tërë ata që dilnin e bashkoheshin me ta; do t'i kishin dhënë pas-taj dhe një pushkë, ndoshta më të mirë se ajo që kishte ai ballisti. Ndoshta do t'i kishin dhënë dhe një kobure (ne i kishim qejf koburet).

Hidhnim sytë nga mali. Nuk di sepse, po ai, ndonëse ishte i madh e i ashpër, me shpatullat e gurta, që dukeshin se do të shëmbeshin ndonjë ditë drejt e në mëhallën tonë, tani më dukej i butë. Njëpër drurët e dëndur, që i rrinin mbi kurriz si flokë të ngritur, me siguri lëvrinin partizanë. Ata zbrisnin edhe njëpër shtigjet shkëmbore e bënin plane si do të sulmonin për të çliruar qytetin tonë.

Kur e shihja ashtu më dukej se mali thoshte me zë të ngrohtë: «Kini durim, kini durim. Djemtë e mi shpejt do të vinë t'ju çlirojnë».

Vërtet, nga do të vinin partizanët të na çlirojnë?

— Unë them nga ana e lumit, poshtë faqes me gurë, — tha njëherë vëllai, duke treguar me gisht.

— Kurse unë them se ata do të zbresin drejt e poshtë, — u përgjigja unë.

— Ç'thua, ore! Vë bast që nga lumi do të zbresin.

— Po andej i bie larg.

— Jo e ke gabim.

Ne do të vazhdonim si gjithnjë të haheshim me fjalë, sikur të mos kishte ardhur babai.

— Partizanët do të vinë nga malet e jugut të Shqipërisë e do të bashkohen me partizanët që luftojnë në malin dhe kodrat rreth qytetit tonë, — tha ai.

Ne mbetëm të shushatur. Përfytyroja tutje malit tonë male të tjera, më të mëdha e më të ashpëra se mali ynë, që gjer atëhere më ish dukur më i madhi në botë. Sigurisht, ai priste atë ditë kur partizanë të tjerë do të vinin në kurrizin e tij të mbuluar me pyje.

Dhe mali ynë, që na vështronte si babaxhan, nuk priti shumë.

## XVIII

### LUFTA

Ajo erdhi së bashku me vjeshtë, me erërat e freskëta e me shirat, që derdhte qielli i zymtë dhe i ftohtë. Gjethet e pemëve qenë zverdhur. Mjaf-tonte të frynte një erë e lehtë e ato, si duke pshe-rëtirë, shkëputeshin nga degët.

Vjeshta gjithnjë më mërziste.

Po jo kjo vjeshtë...

Malet kishin filluar të gjëmonin; po bëhej luf-të e madhe.

Gjermanët qenë egërsuar shumë. Kishin ve-ndosur ta mbanin qytetin tonë. Ata kërcënonin po-pullsinë, ngaqë nuk kishin ç't'u bënin partizanëve. Për të kallur frikë, dogjën një mëhallë anës një rreme që merrte papastërtitë e qytetit. Gjyhët e flakëve ngjiteshin gjer në qiell. Ishin të tmerrshme ato flakë.

Në vjeshtë ne do të shkonim përsëri në shkollë. Po shkollat nuk u hapën, sepse filloi lufta. Njerë-zit pëshpërisnin, po asnjëri nuk dinte gjë me siguri.

Flitej se partizanët mund të sulmonin nga ana e lumit drejt mëhallës sonë. Kjo më gëzonte mua dhe tim vëlla.

— Do të shohim luftën! — i thashë një ditë Mirandit, që po vinte në oborrin tonë.

— Si do ta shihkemi?! — u habit ai.

— Partizanët do të sulmojnë nga mëhalla jonë.

— Po pastaj?

— Si pastaj! — u hodh im vëlla. — S'e kupton që partizanët do të ndeshën me gjermanët edhe në rrugicat e mëhallës sonë?

— Po lufta është plot krisma! Nuk i thonë lojë me top! — tha Mirandi.

Ti je frikacak! Po të duash, futu në ndonjë vrimë. Unë për veten time do të rri në dritare e do të shoh si do të luftohet.

— Unë frikacak! — u nxeh Mirandi. Isha i bindur që ai, në ato çaste, do të ketë kujtuar se si ja mori mendjen ballistit ditën që u bë bastisja. — Ti s'merr vesh fare. Po të friksh në dritare, do të hash ndonjë plumb kokës.

S'di në se do ta kishim bindur njëri tjetrin, kur atë çast në oborr u duk nëna, që vinte nga jashtë.

— Shpejt, bëhuni gati! — tha ajo me nxitim.

— Të bëhemi gati?! — pyetëm ne pa ditur ç'po ngjiste.

— Do të ikim që këtej.

— Pse? — pyeta unë.

— Sepse ka rrezik të na qëllojnë predhat.

— Po nuk do ta shohim luftën, nënë? — tha im vëlla.

— Ç'luftë mëre! — e qërtoi nëna. — Ka rrezik të shembet shtëpia e të na zërë brënda.

Në ato çaste më duk se bashkë me shtëpinë po shembej dhe ëndërra për të parë luftën. (Atëhere mendoja se, kur të luftohej, do të dilja dhe

unë në rrugë, do të bashkohesha me partizanët. Po të mos kishin frikë, më mua do të bashkoheshin dhe im vëlla me Mirandin. Mbase atëhere do të takoheshim dhe me Kreshnikun, do të merrnim nga një pushkë dhe do të luftonim).

Po që të gjitha këto shkuan e vanë.

Hyri dhe babai.

— Ku do të vemi, baba? — pyeta unë.

— Në shtëpinë e gjyshit.

— Po pse në shtëpinë e gjyshit?

— Sepse atje ka më pak rrezik.

— Po sa do të qëndrojmë atje? — pyeti im vëlla.

— Gjersa të çlirohet qyteti.

— Po kur do të çlirohet qyteti?

— Së shpejti! Po mos humbni kohën! Bëhuni gati!

Se çfarë desh të thoshte babai me fjalën së shpejti, nuk arrita ta kuptoj, po, siç duket, ishte fjala për punë ditësh.

Neve na kish trastisur të largoheshim nga shtëpia për disa ditë. Kjo kishte ndodhur kur kishim shkuar në fshat, ose te kushurinjtë tanë. Atëhere na kish marrë malli për shtëpinë tonë. Po të largoheshim për shumë ditë, kjo nuk kish ndodhur kurrë.

Së bashku me në do të vinim edhe disa familje të tjera. U gëzuam shumë së midis tyre ishte dhe Mirandi me të afërmit e tij. Përsëri do të ishim bashkë.

Po bëheshim gati të linim shtëpinë, kur vura re që babai po përqafonte tim vëlla. Pastaj më përqafoi edhe mua. Ç'ishte kjo?

— S'do të vish me ne, baba? — e pyeta i habitur.

— Jo! — tha ai.

— Do të ruash shtëpinë?

Babai qeshi.

— Kam punë të tjera, — tha pastaj.

Kaq tha babai, po kur pyetëm nënën, ajo na tha se babait i kishin ngarkuar të merrej me grumbullimin e ushqimeve për partizanët.

— Të qendroj me ty, baba? — ju luta unë.

— Ç'thua ashtu? — u habit ai. — S'bën të qendrosh. Unë nuk do të jem në shtëpi. Ti vetëm mund të më ngatërosh.

— Po ku do të jesh?

— Herë në një vend, herë në një tjetër.

Ishte e kotë të bisedoja më gjatë me babanë.

U përqaftuam.

— Unë do të vi ndonjë ditë, — tha babai. — Mos u mërzitni!

Ne u nisëm. Lamë pas rrugicën e ngushtë e dolëm te sheshi, ku kishim luajtur aq shumë. Gjithçka përreth m'u duk e afërt, e dashur, veç derës së shtëpisë së avokatit, që më dukej se na vështron-te si armik. Ku ish futur tani avokati me djalin e tij?

Sheshi më kujtoi topin. Po ku e kishim topin tonë, si mund të ndaheshim prej tij?

U gëzova kur pashë tim vëlla që nxorri topin nga një trastë që i kish dhënë nëna. Qe vjetëruar i shkreti top, po, megjithatë, mbahej.

— Po atë ç'e morët? — tha nëna, që ecte përpara me disa gra të tjera. — Kohë për të luajtur me top është tani?

Ajo ecte shpejt sa mezi e arrinin.

Lamë pas rrugicat dhe dolëm në rrugën e madhe. Në çdo njëqind metra ishin vënë gurë, dërra-

sa, fuçia; tela me gjëmbe, që ishin mbledhur lëmsh. Dukej se tërë plaçkurinat e qytetit i kishte grumbulluar një dorë e padukshme dhe i kishte hedhur atje në rrugën e madhe.

U dëgjuan ca krisma. Në mbetëm. Pas nesh erdhën edhe disa familje të tjera, të cilat, si ne, kishin lënë shtëpitë e tyre, për t'u hedhur në mëhallat që nuk kishin rrezik të shkatërroheshin. U dëgjuan përsëri krisma. Këtë herë edhe më të forta. Nëna lëshoi një psherëtimë, po shpejt e mblodhi veten. Krismat dëgjoheshin shumë pranë. Dukej se diku përreth luftohej.

Për të shkuar në mëhallën ku banonte gjyshi, duhej të kalonim përmes rrugës së madhe. Mirëpo atje gjëmonin e fishkëllenin plumbat, sa të merrnin mendë.

Të kaloje ishte vështirë. Po, ama, edhe të rrije aty ku ishim ne, ishte rrezik. Ku i dihej: mund të kalonin gjermanët. Ndoshta ata mund të dilnin pa pritur e pakujtuar nga një rrugicë. Po mund të dilnin edhe partizanët. Atëhere do të ishte çdo të ishte. Me siguri do të bëhej luftë e madhe. Në do të strukëshim rrezë një muri e do të shikonim. Mbase do të gjënim edhe ndonjë pushkë dhe do të shtinin kundër gjermanëve.

Mirëpo nga rrugicat s'po dilnin as partizanë e as gjermanë. Krismat vinin vetëm nga rruga.

— Kaloni, kaloni shpejt! — tha një burrë që doli nga një portë aty pranë! — Pa humbur kohë, një nga një dhe kini kujdes, ulni kokën!...

Si tha këto fjalë, burri na bëri shenjë të ecnim. Nëna na mori përdorë. Ndjeva se duart e saj qenë të ftohta akull. Ajo shqetësohej për ne.

— Ulni kokën! — na tha kur po kalonim pas

pirgut me gurë, dërrasa e fuçija, që e zinin rrugën fund e krye.

Mirëpo, për t'i mbushur mendjen asaj që nuk kishim frikë, ecnim me kokën lart; po ne që ishim më të shkurtër se nëna, e çila ecte e përkulur mëdysh, sado që të ngrinim kokën, ajo nuk kalonte sipër pirgut.

Kur kaluam në anën tjetër të rrugës, nëna mori frymë thellë. Tani nuk ecnim dhe aq shpejt. Duket se rrezikun e kishim kaluar.

Kur arritëm në shtëpinë e gjyshit, kish rënë mbrëmja. Dukej sikur atje nuk kishte frymë njeriu. Po nuk ishte ashtu; në bodrumet qenë mbledhur pleq e plaka dhe gra me fëmijë.

— Futuni shpejt brenda! — tha gjyshi, duke dalë në shkallët që të shpinin në bodrum, si të kishte frikë se në ato çaste do të na ngjiste diçka.

Bodrumet e shtëpisë së gjyshit qenë të pambarruara, muret s'qenë s'vatuuar dhe dyer s'kishte fare. Kështuqë mund të bridhje lirisht. Ne shpesh, kur vinim në shtëpinë e gjyshit luanim kukaçefthi nëpër të hyrat e të dalat e bodrumeve, sa shqepeshim. Mirëpo, me të hyrë, na u duk se na u zu fryma: brenda në bodrume kishte kaq shumë njerëz, sa dukej sikur tërë mëhalla qe shkullur e përplasur aty.

— Bëjuni vend të ardhurve! — tha dikush.

Njerëzit lëvizën: një burrë u ngrit duke marrë me vete një fëmijë të vogël; një grua hoqi një velenxë e nja dy jastekë, dikush shtyu ca më tutje një dyshek. Kjo më habiti: po dyshekët ç'duheshin këtu? Pyeta nënën.

— Po këta, këtu do të flenë?

— Po, këtu.

— Tërë natën?

— Sigurisht tërë natën.



— Po ne ku do të flemë?

— Edhe ne këtu.

— E pse? - tha vëllai duke u ngrysur. - Pse të mos flemë sipër?

— Sepse sipër ka rrezik. Gjermanët kanë filluar të qëllojnë me top. Po sikur të bjerë një predhë mu në këtë shtëpi, çdo të ndodhë? Shtëpia do të bëhet pluhur.

— Po këtu në bodrume?

— Këtu do të jemi jashtë rrezikut, sepse bodrumet janë të forta.

Unë vështrova muret e zhveshura, që, nën dritën e qirinjeve e të kandilëve, zbulonin ashpërsinë e tyre. Muret qenë bërë me gurë të pagdhëndur. Ndonëse të heshtur, m'u dukën me të vërtetë të fortë. Me atë heshtje sikur donin të na thoshin: «Mos kini frikë, se na kini ne».

Mëgjithatë, unë nuk doja të flija aty.

— Në do të flemë sipër, - i thashë vëllait.

— E pse jo, - tha ai.

— Po mund të bjerë ndonjë predhë! — foli Mirandi.

— E ç'predhë do të bjerë. Gjer tani vetëm pushkë janë dëgjuar, — thashë unë.

Mirëpo, si për inatin tonë, u dëgjuan ca krisma, pastaj ca shpërthime sa muret e bodrumeve u drodhën.

S'bëhej shaka të ngjiteshe sipër. Mund të bin të ndonjë predhë, ndoshta dhe dy, tri. Ku i dihej.

— Sikur të bien dhjetë predha, si do të bëhet shtëpia sipër? — tha im vëlla.

— Me dhjetë predha do të shuhet fare, thashë unë.

— Po bodrumet do të mbajnë?

Im vëlla nuk foli. Ai picërronte sytë, si të llogariste nëse me të vërtetë bodrumet do të mbanin.

— Dhjetë predha na shuajnë edhe neve këtu, e jo më shtëpinë, — tha Mirandi.

— Jo more! Dhjetë predha të bëjnë këtë? — u çudit im vëlla.

— Ti më duket s'paske haber fare se ç'janë predhat e topit, — vazhdoi Mirandi.

— Predhat? Ja, si plumbat, vetëm pak më të mëdha.

— Ç'thua, ore, s'i paske parë.

— Pse ti ke parë?

— S'kam parë, po kam dëgjuar, ama.

— E si janë këto predha? — pyeta unë.

— Ohu, ato janë të mëdha, sa krahu, ç'them ashtu, sa unë, madje ka edhe shumë të mëdha, ja sa gjyshi. (gjyshi ishte i gjatë dhe i shëndoshë).

— Kaq të mëdha të jenë?

— Mjafton një prej tyre e jo shtëpia, po një mëhallë e tërë digjet e përvëlohet.

— S'më besohet! — tha im vëlla.

— Aq më bën mua! — u përgjegj Mirandi. — Pyet po të duash gjyshin.

Mirëpo gjyshi, duke dëgjuar fjalët tona, na qërtoi:

— Ç'flisni budallallëqe. Lerini topat dhe predhat. Mbetët ju për të folur për ato. Hani bukë dhe flini, se u bë vonë.

Nëna na kish rregulluar një dyshek që e kish marrë te gjyshi. Ngaqë ishte lodhur, e kish zënë gjumi ndenjor, me kokën mbështetur në jastëk. Dhe njerëzit përreth po dremisnin. Predhat s'dë-

gjoheshin më. Edhe krismat që vinin nga larg, si klithma të humbura, qenë rralluar.

Ne ramë të flinim. Kjo ishte nata e parë e luftës, që kish shpërthyer jo vetëm në malet, po edhe në rrugët e qytetit tonë.

Ç'bënte babai? Mbase dhe ai flinte. Mbase tani po përgatitej për t'u shpënë ushqime partizanëve. Po shtëpia jonë e vjetër a mbahej? Mos e kish goditur ndonjë predhë? Po avokati me djalin e tij dhe me atë gruan trashaluge, ku qenë futur tani?

## NE BODRUMET

...Kështu u. gdhinë dhe u ngrysën ditët e para.

Ndoshta ato qenë ditët më të mërzitshme. Ne rrinim të tërë tok. Edhe ditën duhet të përdornim qirinjtë dhe kandilet, se në bodrumet e thellë hynte shumë pak dritë. Përreth mund të dëgjoje lloj-lloj bisedash. Një burrë i trashë tregonte për luftën e parë botërore.

— Përse quhet lufta e parë botërore? — pyeti im vëlla, duke parë që ai burri s'e hiqte atë fjalë nga goja.

— Pse ka qënë e para.

— Po cila është e dyta?

— Ja, kjo që bëhet tani.

— Lufta e qytetit tonë?

— Ç'thua ashtu! — qeshi gjyshi. — Luftë po bëhet jo vetëm në qytetin tonë po edhe në qytete dhe vende të tjera të botës.

Atëhere solla ndërmend gerrat e qyteteve të ndryshme që ishin shkruar në radio, dhe mendova se dhe në ato qytete bëhej luftë si në qytetin tonë, e gjermani, me siguri edhe atje po hante dru.

Burri i trashë tregonte se atëhere kishte qenë oficer e kishte luftuar si luan. E, për të vërtetuar se sa kishte luftuar, na tregonte një kobure që mbante në brez. Ajo ishte e madhe, e rëndë. Megjithëqë nuk ishte aq e bukur sa ato të tjerat, që kishim parë, ne kishim dëshirë ta mbanim në dorë e të shtinim me të. Po burri i trashë s'dëgjonte kurrsesi të na e jepte.

— Pse e mbani, pra? — e pyetëm ne.

— Për çdo rast. Ku i dihet, mund të vinë gjermanët e atëhere ç'do të bëjmë ne këtu? Sigurisht që do të luftojmë.

— Me një koburë.

— Hë, si ju duket juve. S'ua mbush syrin, ë? Po veç në qëlloftë rasti, se gjëmën të bën kjo...

Ne u habitëm dhe na u shtua edhe më tepër lakmia ta shtinim në dorë atë koburë, që tani për ne ishte më e vlefshme se tërë thesarët që kishim dëgjuar në përralla.

Në përgjithësi, bisedat e tjera qenë të njëjta. Ne dëgjonim vetëm për luftë, predha, djegje... S'na tërhiqnin as përrallat. Po mërziteshim. E kup-tonim se mërzinë tonë do ta hiqnin vetëm partizanët.

— Kur do të vinë, pra, partizanët, moj nënë? — i thashë një ditë.

— Së shpejti, mor bir! — m'u përgjigj ajo.

— Po ku janë tani?

— Kanë hyrë në qytet.

— Pse po vonojnë?

— S'është lehtë. Luftojnë për çdo pëllëmbë tokë. S'tërhiqet lehtë gjermani.

Po edhe sa ditë kishin mbetur, këtë as nëna

nuk e dinte, kurse ne qemë të shtërnguar të burgo-  
seshim brenda mureve të errta të bodrumeve.

Nëna e gjyshi s'na linin as edhe një minutë  
të dilnim jashtë. Këtë s'e bënin as të mëdhenjtë e  
jo ne. Nga qielli gjithnjë i veshur me re dëgjohe-  
shin gjëmimet e topave dhe predhave, që çanin  
përpara me një fishkëllimë ngjethëse e shpërthe-  
nin me buçimë diku larg. Po, ama, në atë mëhallë  
s'kish rënë as edhe një predhë. Përse të mbylle-  
shim kështu?

Megjithatë, nganjëherë dilnim jashtë. Kjo  
ndodhte kur mbarohej uji. Në bodrume nuk kishte  
çezmë kështuqë, për të mbushur ujë, duhej ngjitur  
lart në kuzhinë. Nëna, kur ishte e zënë, na i jepte  
neve enët për t'i mbushur. Kjo ishte një kënaqësi  
e madhe, sepse më në fund dilnim nga burgu i  
errët. Megjithatë, ajo na porosiste gjithnjë të mos  
vonoheshim. Në këto raste shkonim të tre: unë, im  
vëlla dhe Mirandi.

Nëpër shkallët e bodrumit dilnim jashtë në  
oborrin e shtëpisë, kalonim nëpër shkallët e jashtë-  
me dhe ngjiteshim lart. Unë doja të rrinim sa më  
shumë. Doja që në ato çaste të dëgjoheshin shpër-  
thime, shtëpia të lëkundej e atje poshtë, në bo-  
drum, të bëheshin merak e pastaj të thoshin me ve-  
te «Ç'djem që janë! S'kanë fare frikë, e jo si ne që  
strukemi këtu!» Fundja, përse të kishim frikë, për-  
derisa kishim kaluar një rrezik jo të vogël, kur ki-  
shim rrokullisur e vvarë oficerin mustaqemadh?

Mirëpo asnjëherë nuk ndodhi që të shpërthe-  
nin predhat kur ne ishim sipër. Edhe kjo na e  
shtëtoi mërzinë, aq sa të ngjiturit sipër na dukej një  
punë angari.

Po një gjë duhet të bënim, ama. Po sikur të

luanim me top? Mirëpo ku të luanim? Ne s'mund të dilnim jashtë.

Filluam të luanim në bodrum. Ta merr mendja, jo lojë me dy porta, po kush e kush ta mban-te topin më shumë në këmbë, pa i rënë në tokë. Po të luaje këtë lojë, do të thoshte të rrije duke numëruar sa shumë do ta mbante Mirandi, se unë dhe im vëlla, edhe sikur të bashkoheshim, nuk mund ta mundnim atë.

Megjithatë, dhe kjo lojë nuk e pati të gjatë. Kjo ndodhi një ditë, kur, duke luajtur, im vëlla e goditi topin fort e ai shkoi e u përplas mu në një poçe me qumësht, që mezi e kish gjetur për femijën e tij të sëmurë një nga ata që strehohej në bodrumet e shtëpisë së gjyshit. Poçja u bë copë e grimë. Nëna e gjyshi u zemëruan shumë. Kuptohet vetiu se kjo nuk shkoi pa pasoja. Megjithëse e butë, nëna i tërhoqi tim vëllai një pëllëmbë.

Po tani ç'të bënim?

Shpërthimet e predhave dëgjoheshin në mëngjez. Pastaj rralloheshin. Nga larg vinte jehona e pushkëve. Po njerëzit vetëm nga predhat trembe-shin. Në oborr kishin filluar të lëviznin, disa anës e anës mureve shkonin në shtëpi për ndonjë nevojë. Ata që pinin duhan, dilnin në prak të bodrumit për të mos shqetësuar të tjerët që mund t'i zinte kolla.

Kurse ne duhet të rrinim brenda. Durohej kjo?

— Pse të mos luajmë jashtë! — thashë një mëngjez, kur koha që hapur dhe shkëlqente një diell i ngrohtë.

— Të luajmë, përse të mos luajmë! — u hodh e thà im vëlla.

— Dale, qysh do të luajmë! — tha Mirandi. —  
Po predhat?

— Të paska hyrë djalli në bark! — e ngacmoi  
im vëlla. — Gjithmonë do të gjesh ndonjë shkak.

— S'e kam hallin për vete, po mos thonë gjë  
prindët.

Vërtet, nëna mezi na kish lënë të ngjiteshim  
sipër në shtëpi e jo të luanim. Mirëpo, teksa e vris-  
nim mendjen se si do të luanim, në bodrum u dha  
një grua, që mezi merrte frymë.

— Partizanët po i afrohen mëhallës — tha ajo.

— Ç'thua, moj?! Vërtet!? — foli gjyshi i gëzu-  
ar. — Nga e more vesh?

— Ma thanë atje në rrugë. Gjermanët po tër-  
hiqen.

Atëhere shpërthyen bisedat:

— Nga po tërhiqen gjermanët? — pyeti burri  
i trashë.

— Andej poshtë, — tha gruaja.

— Sa keq! — u përgjegj burri i trashë.

— Si sa keq! Ç'domethënë kjo? — u nxeh  
gjyshi.

— Do të doja që disa prej tyre të vinin kënde-  
nga ne e t'ua tregoja qejfin me këtë babaxhanen  
këtu, — tha ai qetë-qetë, duke treguar në brez ko-  
buren e madhe.

Të tërë qeshën.

— Edhe këtë s'e kisha dëgjuar, — tha gjyshi,  
pa e mbajtur edhe ai gazin.

— Qeshni, qeshni ju, ore derëzinj, se shpëtuat;  
po sikur të vinin gjermanët, ç'do të bënit? — tha ai.

— Po t'i ç'do të bëje? — pyeti gjyshi.

— Ç'do të bëja unë? Ama pyetje! Do të luf-  
tojal!



— Po pse s'lufton atëhere, po më strukesh këtu!

Përsëri shpërthyen të qeshura, ndërsa burri i trashë u skuq edhe më shumë.

— Sikur të luanim tani në oborr! — i thashë nënës.

— Epo mirë, luani! — u përgjigj ajo. E pastaj, duke ju drejtuar gjyshit, shtoi: Ç't'u bësh këtyre, s'ke, si i mban!

Ne kaq donim. Dolëm në oborr. Veç kur mbinë pas nesh nja dhjetë kalamaj të tjerë, sa për të bërë një lojë me top.

Mirëpo unë nuk munda të luaj. Duke vrapuar, u pengova në një gur rrëzë murit e vrava këmbën. Shpesh, kur kisha luajtur, e kisha vrarë këmbën, po jo si këtë radhë.

S'mund të vrapoja. Të luaja portjer, nuk më pëlqente më. Ishte gjë e mërzitëshme të rrije midis dy gurëve e të prisje topat që gjuanin të tjerët, për më tepër edhe të shtriheshe sa gjatë gjërë (Pasi kisha parë Kopin në fushë, më pëlqente të luaja vetëm në sulm.)

Gati sa nuk qava. Jo nga dhembja, po nga inati.

Ç'të bëja? Të qendroja aty e të shihja si luanin ata, s'ish punë që bëhej. Po edhe të kthehesha në bodrum më dukej gjë e kotë. Të gjithë luanin e asnjë s'e kish mendjen te unë. Ngaqë nuk kisha ç'të bëja, u pështeta pas murit të shtëpisë e po ndiqja lojën e kalamajve. Oborri i shtëpisë së gjyshit që i gjerë dhe kalamajtë bridhnin pas topit, që vente e vinte sa andej këndeje.

— Po lozin? — dëgjova një zë nga brenda. Ish-te zëri i atij burrit të trashë.

- Po, po lozin, — ju përgjigja.
- Lozin mirë? — pyeti ai.
- Pse nuk del t'i shohësh?
- Hm, jam sëmurë, — tha burri i trashë.
- Nga brenda u dëgjuan përsëri të qeshura. Siç duket e kishin me burrin e trashë.
- Po ti dil, të shkretën, se nuk të gjen gjë, — foli gjyshi.
- Eh, ashtu thua ti. Kam të nxehtë e më vinë të dridhura. E di ç'domethënë shëndet, apo jo? tha i trashi.
- E qysh s'e di. Ti ke shëndet aq sa nuk bëhet.
- Duhet ruajtur, ama.
- Mor po i ruhesh se ke frikë...
- Unë frikë?!..
- Përsëri u dëgjuan të qeshura.
- Ç't'i bëj që nuk kalojnë këndeje gjermanët, pa do të shihnit ju se çdo të bëja me këtë babaxhanen time. (Ai me siguri u tregonte koburen e madhe, që mbante në brez).
- Edhe ata që kishin dalë nga bodrumi qëndronin te praku, mirëpo, nuk mund të shihnin se si luanin kalamajtë, se i pengonte muri i shtëpisë. Po edhe kalamajtë nuk donin t'ja dinin në i shikonte, apo nuk i shikonte njeri.

## NË PRITJE TË PARTIZANËVE

Ne pandehëm se do të luanim kështu dhe të nesërmen. Po e nesërmja na solli të papritura. Krismat e pushkëve dhe të mitralozave nuk vinin më si jehonë e largët. Ato dëgjoheshin qartë. Luf-tohej diku pranë. Shpërthyen pastaj predhat e to-pave. Ato fluturonin, duke lëshuar pas fishkëlli-mën e tyre ngjethëse, pastaj shembeshin me një buçimë shurdhonzëse, sa muret e bodrumeve dri-dheshin. Ne u strukëm përsëri brenda në bodrum. Të tërë dukeshin të shqetësuar. Ç'po ngjiste kështu?

Mbase nuk do të shqetësoheshin më shumë si-kur të mos ish dukur ajo gruaja, që një ditë më parë, na kish dhënë lajmin e afrimit të partizanëve.

— Korba, gjermanët po vinë kënde! — tha ajo.

— Dale moj ti, nga e more vesh këtë! — tha gjyshi.

— Ma thanë në rrugë! — u përgjigj gruaja.

— I dëgjon mirë ato që të thonë, moj?

— Ua, ç'thua kështu? Më vraftë perëndia, në gënjej!

— Po dje na the të tjera fjalë!

— Ku di unë e shkreta. Ç'më thanë, po ju them: gjermanët po vinë këndej.

Njerëzit filluan të lëviznin. Burri i trashë kish mbetur si i goditur nga rrufeja, më sytë e zgurdulluar e gojën pak të hapur.

— Po fundja le të vinë! — tha dikush. Me ne s'kanë asnjë punë. Kështuqë s'kanë ç'na bëjnë.

— Pyet gjermani. Apo tani që e ka kokën në trastë, — ja priti një tjetër.

— Pse çfarë mund të bëjë? — pyeti me gjysmë zëri i trashi.

— Hë, çfarë mund të bëjë? Ja, të hapë derën, e një breshëri automatiku të tërëve.

— Kush ndjell pënik'andej? — tha gjyshi. — Ç'janë këta frikacakë? Në pastë për të ardhur, le të vijë gjermani. Më ç'të mundim do ta presim. S'ka ç'të na bëjë. Ai nuk di nga t'ja mbajë e ku të fusi kokën, se partizanët s'po e lenë të marrë frymë.

Gjyshi kish qëndruar midis bodrumit. Drita i binte në fytyrën që i ishte skuqur. Ashtu, me grushtin e ngritur, ai dukej dhe më i madh nga ç'ishte.

Fjalët e gjyshit u dhanë zemër të gjithëve.

— Mirë e ke ti, shumë mirë! — tha burri i trashë. — S'ka ç'të na bëjë gjermani. Le të vijë po t'ja mbajë. Sa të kem këtë babaxhanen, mos u bëni merak se asgjë nuk do të ngjajë.

Dhe nxori koburen nga brezi.

Pas këtyre fjalëve, të gjithë ja plasën gazit dhe heshtja që kish pllakosur pak më parë, u kthye në rrëmujë.

— Po hë de, kur e ke, qëllo njëherë, të shkretën! — tha gjyshi pa e mbajtur të qeshurën.

— Qysh the, të shtie kuturu! Jor or jo, s'ë har-xhoj kot plumbin unë! Çdo e shtënë do të zërë në mish. Kini për të parë...

Po, ndërsa po thoshte këto fjalë, u dëgjua një buçimë e fortë e burri i trashë, që ishte ngritur më këmbë e po kapardisej, u shemb përdhé, duke mbyllur veshët.

Pastaj s'u dëgjua më asnjë e shtënë topi. Kjo vazhdoi për disa minuta. Ç'po ndodhte? Gjyshi hapte derën.

— Ku vete? — e pyeti nëna.

— Ja, të shoh pak, — tha gjyshi.

Ai doli e u zhduk pas portës. Kjo u dha zemër të tjerëve. Edhe ata lëvizën e dolën deri në prak të derës.

— Ku veni? — tha burri i trashë duke mbajtur koburen në dorë. — Mos lëvizni, se çdo gjë mund të ngjasë. Unë për veten time do të rri këtu. Nuk luaj vendit. Do ta pësoni, more të mjerë!

— Rri se mirë je! — i tha dikush.

— Sa s'ka më mirë. Në daçi të mbroheni, ejani pas meje sa nuk është vonë. Është një babaxhane kjo që nuk e ka shoqen.

Mirëpo asnjëri nuk ja vinte veshin burrit të trashë, që kish mbetur fillkat në bodrum, duke mbajtur gjithnjë në dorë koburen.

Të shtënat e topave nuk po dëgjoheshin më. Edhe krismat e pushkëve qenë rralluar. Në oborr u duk gjyshi.

— E ke marrë vesh gabim, moj e bekuar! — i tha gjyshi asaj gruas fjalamane. — Ngrite një mëhallë të tërë në këmbë. Partizanët do të vinë nesër këndeje nga ne.

Merret me mend si i pritëm ne këto fjalë. Nje-  
rëzit po putheshin njeri me tjetrin. Nëna po na  
puthte ne. Ne pastaj puthëm gjyshin.

Sa i guximshëm që ishte gjyshi ynë! E jo si ai  
burri i trashë, që vetëm të dërdëlliste dinte!

## XXI

### MITRALOZI GJERMAN

Po partizanët nuk erdhën të nesërmen.

Në mëngjez herët u zgjuam nga të shtënat e një mitralozi. Ai gjëmonte pa pushim. Ato të shtëna nuk i kishim dëgjuar kurrë kaq pranë.

Të tërë mbanim vesh.

— I dëgjoni? — tha burri i trashë. — Qëllojnë partizanët. Pritni kur të vinë këtu pas pak.

Ai hoqi nga supet batanien, me të cilën qe mbledhur gjatë natës, dhe u shtriq.

— Vërtet partizanët qëllojnë? — pyeti nëna. Gjyshit, që kish heshtur, s'ju durua, veshi xhaketën e doli në oborr.

— E pat edhe kjo punë, — vazhdoi të fliste burri i trashë. Lufta mori fund. Për një gjë më vjen me tërë mend keq: s'do të më vjellë më kjo deli kobure. Po do ta ruaj si kujtim.

— Pse nuk na e fal neve, — tha im vëlla.

— Mos, të keqen, po ç'ju duhet juve koburja, — tha nëna. — Gjë me zarar ajo.

Në atë kohë në bodrum u fut gjyshi.

— Mbaje dhe ruaje mirë koburen, — i tha burrit të trashë, se mbase do të të duhet.

— Përse, ç'ka ndodhur? — pyeti ai duke belbëzuar.

— Partizanët do ta kenë të vështirë të vinë shpejt këndeje.

— Si kështu? — pyetën të gjithë puthuajse njëzëri.

— Sepse mitralozi që shtie është i gjermanëve e jo i partizanëve.

— Bah, nuk është e mundur, s'më kanë lënë veshët mua. Në luftën e parë botërore me këto veshë njihja dhe tipat e mitralozëve.

— More po lëre atë luftën e parë botërore! — e ndërpreu gjyshi. — Dëgjo se ç'po të them: ky mitraloz është i gjermanëve. Ata e kanë vendosur në një shtëpi diku këndeje dhe kontrollojnë rrugën nga ku do të vinë partizanët. Po nuk u asgjësua ky mitraloz, partizanët do të vonojnë të vinë.

Gjyshi fliste tërë mllef dhe dukej shumë i inatosur.

Ne kishim mbetur të heshtur.

— Mitralozi vazhdon të shtjerë papushim. Asnjë hap nuk të lë të bësh përpara. Nuk asgjesohet me koburë as me mitraloz, po me bomba. Duhet gjetur një shteg tjetër nga duhet të kalojnë partizanët. Si mendoni ju?

Të gjithë filluan të vrasin mendjen. Edhe ne ashtu bëmë, megjithëse gjyshi as që na i hodhi sytë.

— Ka një shteg të tillë, — tha njëri duke ngritur zërin. — Partizanët mund të kalojnë duke kapërcyer mur pas muri, përmes kopshtëve, derisa të arrijnë të rrugica, ku ndodhet pisha e madhe.

— S'e ke keq, — u përgjigj gjyshi, — sepse



shtëpia nga ku shtien gjermanët me mitraloz, ndodhet para pishës dhe, nga rrugica, partizanët do të asgjësojnë atë me siguri. Mirëpo ata nuk e dinë këtë shteg.

— Si t'i lajmërojmë, — tha nëna.

— Ja, këtu ngec puna, se është e pamundur të kalosh përmes rrugës në anën tjetër të mëhallës, ku janë ata. E dëgjoni si kërcet mitralozi i mallkuar?

Pas këtyre fjalëve të gjyshit të gjithë filluan të flasin; secili mendohej t'i jepte rrugëzgjdhje kësaj çështjeje. Vetëm burri i trashë s'e nxirrte një fjalë nga goja. Ai herë shikonte njërin, herë tjetrin me sy të frikshëm, derisa u tërhoq në dyshkun e vet. Me sa duket, kishte frikë se mos e ngarkonin atë të kalonte në anën tjetër, meqënëse kishte kobure.

Po asnjë nuk kishte nge të merrej me të. Të gjithë mendonin vetëm për një gjë: si të lajmëronim partizanët.

Për një çast të tërë heshtën.

Befas, im vëlla, që gjer ahëre kishte mbetur me kokën pak të ngritur dhe sytë të ngulur diku në tavanin e nxirë të bodrumit, m'u afrua dhe më foli me një zë fare të ultë:

— E gjeta, e gjeta!...

— Çfarë gjete, more? — i thashë unë në vesh.

— E gjeta, kanali, kanali!

— Oh, sa mirë! Ky kanal të çon në anën tjetër të mëhallës.

Dhe m'u kujtua se, sa herë venim me nënën në shtëpinë e gjyshit, futeshim në një nga tubat e këtij kanali që kish filluar të hapej atje prej disa muajsh. Ai kalonte mospërmes dhe lidhej me

një kanal të madh. Punëtorët kishin gërmuar dheun,  
kishin vënë tubat, pastaj e kishin mbuluar me dhé.

Mirandi po na shikonte me kureshtje.

— A dalim në oborr? — i thashë unë me një  
zë të mekur.

Mirandi që e kuptoi se diç kishim, e priti me  
kënaqësi fjalën time.

## KANALI

Pa rënë në sy të nënës, ne së bashku me Mirandin dualëm jashtë mureve të bodrumit. Kaluam sheshin para shtëpisë së gjyshit dhe ju afruam kanalit. Ai që mbuluar me dhé e degë të thata, ndaj gryka tej nuk shihej fare. Po ne i larguam e sakaq para nesh u shfaq një tub çimentoje që zgjatej sipër, si i dalë nga nëntoka.

— Po ky, pse po më duket kaq i ngushtë sot? — tha im vëlla.

— Ç'thua, more, mos të hyri frika? — thashë unë.

Mirandi, si më i madh, ndërhyri.

— Se kush është frikacak do ta tregojë atje, në fund të kanalit.

Më parë ne ishim futur deri në mes të kanalit, deri atje ku ai lidhej nën rrugë me një kanal tjetër të madh, që shkonte përgjatë tij. Që aty dëgjonim oshëtimë zërash, «Ou, ou; ou-oi-oi... hum... hum...» Ishin oshëtimat e zërave të fëmijëve që vinin nga ana tjetër e kanalit. Më tutje nuk kishim vajtur. Pse kishte ndodhur kështu, nuk e spjegonim dot, ndoshta se kishim patur frikë. Mund të ishte dhe kjo.

U pamë sy në sy dhe rrëshqitëm nëpër tubin e ngushtë të kanalit. Ajri sa vinte e bëhej më i rëndë. Po ne ishim mësuar, se ishim futur sa herë.

Tani nuk shihnim asgjë, veçse errësi. Unë dhe Mirandi zvarriteshim të parët. Pas nesh vinte im vëlla. Nuk flitnim veçse bënim përpara.

M'u kujtua një përrallë: «Na ishte ç'na ishte. Na ishte një udhëtar që humbi udhën në një natë të errët. Ngaqë nuk kishte ku të flinte, u fut në një guvë shkëmbore. Mirëpo guva zgjatej thellë shkëmbit. Kjo e habiti udhëtarin që filloi të futej thellë guvës...»

Dhe ne po futeshim më thellë.  
— Dëgjuam një zhurmë. Po ç'ishte? Nga vinte? Mbajta vesh.

— Dëgjoni gjë? — u thashë.

— Zhurmë uji! — tha Mirandi.

— Po sikur të rrjedhë këndeje nga ne? — ndërhyri im vëlla.

Heshtje.

Vërtet, sikur uji të rridhte nga ne? Do të lageshim.

Po sikur të ishte ndonjë rrymë e fortë?

Të ktheheshim?...

«Udhëtari eci përpara dhe, papritur, ngaqë ishte shumë errësi, ra në një gropë të thellë me ujë. Bëri të dilte, po gjithnjë zhytej»...

Po, ndoshta dhe ne do të zhyteshim në ndonjë gropë të thellë me ujë. Nuk dinim se deri ku kishim arritur. Gjithçka para nesh ishte e panjohur. Po duhej guxim.

Befas pamë të depërtonte një rreze drite.

— Po arrijmë, — tha im vëlla.

Dëgjuam të shtëna që u ngjanin atyre të mitralozit gjerman. Po këto ç'ishin?

Zhurma e ujit po shtohet. Dhe rrezja e dritës. Të shtënat tani na buçisnin në veshët.

Duke u zvaritur gjithnjë përpara, arritëm të kryqëzimi i kanalit të madh, ku rridhte ujët. Ky ishte kanali që çonte në lumë ujrat e një përroi. Kapaku i kanalit që gjysmë i hapur.

Mitralozi rrihte gjithnjë. Ky duhet të ishte mitralozi gjerman. Në ishim tamam nën rrugën nga ku duhej të kalonin partizanët.

Befas Mirandi qëndroi.

— Ç'pate! — i thashë unë.

— Dikush, — më pëshpëriti, — është futur në kanalin e madh.

Dhe vërtet para nesh, në gjysmë errësirë, dukej trupi i një njeriu. Ai kish mbetur i ngrirë.

— Kush mund të jetë? — pyeti im vëlla me zë të ulët.

— Kush e merr vesh?

— Mos është ndonjë partizan?

— Po sikur të jetë gjerman?

Vërtet, po sikur të ishte gjerman?

— Si nuk u kujtuam të merrnim me vete koburen e trashaluqit! — tha im vëlla.

Eh sikur ta kishim patur me vete, do t'i kishim qëruar hesapet me këtë gjerman.

Ç'të bënim? Të ktheheshim?

Mbanim frymën. Ai qëndronte gjithnjë si i ngrirë.

Cili ishte, pra, dhe pse nuk lëvizte?

— Mos ka vdekur? — pyeti me dyshim im vëlla.

— Ndoshta dhe ka vdekur.

Ai nuk lëvizte. Uji rridhte me zhurmë poshtë trupit të tij. Krismat e mitralozit s'kishin të pushtuar.

Ndrojtja që na kish pushtuar, tani po zhdukej...

«Udhëtari desh të shkëputej me forcë nga uji i gropës, po ajo po e thithte; ndërsa një zë, që vinte që thellë guvës, kumbonte: «Deshe të futeshe në fshehtësitë e mia. Ja tani e pësove».

Dhe udhëtari vdiq, i përpirë nga uji i gropës»...

Këto mbaja mend nga përralla e frikshme. Po kjo që po ngjiste tani nuk ishte përrallë. Dhe ne nuk do të pësonim atë që pësoi ai udhëtari.

I panjohuri nuk lëvizte.

U zvarisëm përpara. Atëhere gjithçka u kthjellua para syve tanë: me kokën të zhytur në ujë e këmbët përpjetë, shihej kufoma e një ushtari gjerman. Duket se ish rrëzuar papritur e pakujtuar brenda në kanal e kish mbetur i vdekur. Po mbase e kish vrrarë ndonjë partizan e pastaj e kish flakur kufomën e tij në kanal, ose gjermani kish dashur t'u zinte pritë partizanëve e kish mbetur i vdekur nga plumbat e tyre. Ku dihej!

Po nga kufoma e gjermanit nuk kishim frikë, ndaj vazhduam të zvarriseshim. Kanali po fillonte të zgjerohej. Kishim arritur në kryqëzimin me kanalin e madh, ku rridhte ujët. E ndjemë veten më të lirë. Tani mund ta shihnim njëri tjetrin. Ktheva kokën dhe vëreja tim vëlla. Fytyra e tij qe nxirë. Jo nga frika, po nga pluhuri që vishte faqet e brendshme të tubave të kanalit. Kështu ishte bërë dhe Mirandi. Kështu do t'isha bërë me siguri dhe unë.

Kufoma e gjermanit na pengonte të vazhdonim rrugën nëpër kanalën e ngushtë, që do të na çonte në anën tjetër të mëhallës. E tërhoqëm. Ajo rrëshqiti lehtas dhe u zhyt në ujë, ndërsa automatiku, që mbante në duar, mbeti i varur në hekurin e kapakut të kanalit.

— E marrim me vete? — tha Mirandi.

— Si të mos e marrim, — i thashë unë. — Do t'u duhet partizanëve.

Të shtënat e mitralozit vazhdonin. Plumbat vërshëllenin mbi kapakun e kanalit.

«Qëlloni, nazistë të fëlliqur! Po kot e kini, se edhe pak e do t'ju vijë fundi», — mendoja me vete.

U zvaritëm përsëri nëpër kanalën e ngushtë dhe u zhytëm në errësirë. Po tani nuk kishim fare frikë.

— Ma jep mua automatikun, — tha im vëlla që vinte pas meje, — se të pengon.

E kuptova që ai kish qejf ta mbante vetë.

— Po sikur të na dalë ndonjë gjerman përpara, — tha Mirandi — ç'do të bëjmë?

— Le të guxojë, po të dojë të na dalë përpara ndonjë gjerman, po përshesh do t'ja bëj kokën, — u hodh im vëlla.

Pamë dritë. Po arrinim. Drita gjithnjë zmadhohej para syve tonë. Nuk dëgjonim më britmat «oi... ou... hum...», po të shtëna të shkëputura.

Këto duhet të ishin të partizanëve.

Ne nxituam, megjithëse e ndjenim veten mjaft të lodhur e mezi merrnim frymë.

Të shtënat dëgjoheshin gjithnjë e më pranë. Siç duket, luftohej diku përreth.

Ju afruam grykës së daljes së kanalit.

Po tani ç'të bënim? Duhej patur kujdes. Ishin partizanët andej, apo gjermanët? Këtë nuk e dinim, ndonëse na kishin thënë se në atë anë luftonin partizanët.

Mirandi dhe unë zgjatëm ngadalë kokën jashtë tubit dhe hodhëm sytë përreth.

Kanali na kish shpënë në një rrugicë tutje rrugës, ku nuk kishim qenë asnjëherë. Ne pamë njerëz të armatosur me pushkë, të veshur me rroba të gjelbra, po jo si ato të ushtarëve gjermanë, as si të ballistëve. Dhe shtinin nga dritaret e shtëpive dhe rrëzë mureve.

Këta duhet të ishin partizanë, megjithëse ne nuk i kishim parë kurrë.

Mirandi na bëri me shënjë dhe mori të dalë. Mirëpo në çast dëgjuam një zë të fortë.

— Ndal, ndal, mos lëviz, se do qëlloj!..

Futëm kokën brenda.

— Ç'është? — pyeti im vëlla i shqetësuar.

— S'e marr vesh.

— Mos janë ballistët?

— Kushedi.

U dëgjuan zëra të tjerë: «Kujdes, te gryka e kanalit u duk një kokë. Mund të jetë ndonjë armik. Po të mos dorëzohet, të asgjësohet».

Po sikur këta të ishin ballistë?

Mirandi e shtrëngoi fort automatikun.

Zërat dëgjoheshin shumë pranë. Siç duket, ata kishin rrethuar grykën e kanalit.

— Hej, dorëzohu, s'ke nga vete! — foli njëri prej tyre.

— Kush jeni ju? — ju thirra unë.



— Pa shiko. Nga zëri më duket se qenka fëmijë.

— Fëmijë, për besë. Po këta ç'duan këtu? — tha një tjetër.

— Kurse unë pandeha se mos ishte ndonjë gjerman a ballist.

— Partizanët... Këta qenkan partizanët! — thirra i ngazëllyer.

— Hej, ju, partizanë jeni?

— Po, po, partizanë, — folën ata.

Sakaq në grykën e kanalit pamë kokën e një burri.

Gjëja e parë që na ra në sy ishte kapelja me yll të kuq, për të cilën na kish folur aqë shumë babai, dhe një shall i kuq që i mbështillte qafën. Pastaj u duk një kokë tjetër me kapele me yll të kuq e shall të kuq, pastaj edhe një tjetër e mua në ato çaste m'u duk se gryka e kanalit po ndizej flakë nga ngjyra e kuqe.

Dy duar të fuqishme u zgjatën drejt nesh, na përfshinë e na tërhoqën si pendë.

— Pa shiko, pa shiko, qenkan të armatosur dhe me automatik!...

— More si qenkan nxirë!

— Duken dhe të lodhur!

— S'i thonë shaka. Kanë kaluar nëpër tërë atë kanal.

— Po he, more çuna, përse rrini si të shushatur? Përse kaluat këndeje?

— Flisni, pra. Ç'po ndodh në mëhallën tuaj?

Mirëpo ne i vështronim drej e në sy fytyrat e qeshura të partizanëve, po për të folur nuk flisnim.

— More, mos tremben këta kështu?

Ne nuk trembeshim. As kishim përse të trembeshim, po fjalët na kishin mbetur në grykë.

Ja ku i kishim partizanët përballë.

Preknim rrobat e tyre, rripat e trashë prej lëkure që i shtrëngonin në mes; kopsat e metalta të xhaketave të gjelbra, pushkët që mbanin në duar, i përqaфонim dhe ata na përqaфонin.

Kur e morëm veten, u treguam partizanëve përse kishim ardhur.

Ata na dëgjuan me kureshtje dhe vështruan me vëmëndje copën e letrës ku Mirandi kish shënuar shtigjet nga ku mund të kalonin për të goditur mitralozin gjerman.

— Ju lumtë, fëmijë!

— S'është shaka të kalosh nëpër tërë këtë kanal!

— Po këtë automatik ku e gjetët? — pyeti pastaj njeri. I treguam se si kish ndodhur puna.

— Pa shiko, pa shiko! — tha një partizan tjetër. — Qenka i atij gjermanit që desh të fshihej në kanal in e rrugës.

Ne ua dhamë automatikun partizanëve.

— Ju falemnderit, — tha njëri prej tyre. — Kjo armë do të na jetë e vlefshme. U thoni prindërve tuaj dhe tërë banorëve të mëhallës se do të vimë shpejt, madje shumë shpejt, e do ta zhdukim patjetër mitralozin gjerman. Të kenë besim. Tani kthehuni, se këtu është rrezik të qëndroni.

Ne do të donim të qëndronim e jo vetëm të shihnim.

## XXIV

### KRESHNIKU

Mitralozi gjerman vulli zjarr për orë të tëra.  
Ne pritnim me padurim që ai të heshte.  
Ku do të ishin tani partizanët? A kishin mundur të kalonin përmes kopshteve për ta goditur prapa mitralozin gjerman?

Nga pasditja, të shtënat u shtuan. U dëgjuan dhe buçima të forta. Pastaj heshtje e përsëri të shtëna e buçima.

Pas pak mitralozi gjerman heshti.

Ne mbajtëm frymën.

Po, ai nuk ndihej më.

Atëhere në bodrum shpërthyen britma gëzimi; njerëzit nuk e përmbanin dot veten.

Në ato çaste asnjë nuk mund të qëndronte më në bodrum.

Gjyshi nxitoi, lëvizi llozin e porta u hap.

Të gjithë u sulëm jashtë.

— Erdhën, ata janë.

— Po, po, ata janë. — Dhe njerëzit të gëzuar si kurrë përqafoheshin me çlirimtarët e tyre. Të gjithë të bodrumit, ç'ishin e ç'nuk ishin, po për-

qafoheshin me ta. Disa nuk i mbanin dot lotët. Unë dija që njerëzit qajnë nga hidhërimi, po këta lot ishin lot gëzimi.

Dhe ne u sulëm t'i përqafojmë partizanët. Përpiqeshim të përqafojmë njërin apo tjetrin, të gjithë donim t'i përqafojmë. Gjyshi po përqafohej me dikë. Ky ishte babai. Me të tani po përqafohej dhe nëna.

— E njihni këtë? — tha babai, duke na treguar një partizan që po na vështronte me sy të qeshur e priste krahëhapur që ne t'i sulleshim. E kundruam me kujdes partizanin syqeshur, po nën dritën e zbetë që e vështirë ta dallonim. Cili mund të ishte ai partizan që priste që ne ta përqafojmë?

— Kreshniku, ky është Kreshniku; — thirri Mirandi dhe u sul drejt partizanit.

— Kreshniku, Kreshniku! — thirrëm dhe ne pas tij.

Vërtet ai ish. Po sa kish ndryshuar! Ai sikur që zgjatur e rrobat ushtarake i kishin dhënë një tjetër pamje.

— Më njohët më në fund! — tha Kreshniku, ndërsa po i shtrëngoheshim përreth.

Ne ndjenim një gëzim të madh, sepse kishim një shok që kish luajtur me ne e që kishte dalë partizan. Me siguri Kreshniku duhej të ishte partizani më i vogël i të gjithë partizanëve.

Ato çaste ne nuk dinim çfarë të bënim.

— Ke luftuar shumë? — e pyeti im vëlla Kreshnikun.

— Shumë! — u përgjegi ai. — Të gjithë partizanët kanë luftuar.

— Me pushkë?

— Me pushkë dhe me armë të tjera.

— Po me top? — pyeta unë.

— Edhe me top, — u përgjegj Kreshniku, duke vënë buzën në gaz.

— Po gjermanë ke vrarë? — pyeti këtë radhë Mirandi.

— Ta merr mendja që edhe gjermanë kam vrarë...

— Me këtë pushkë?

— Po, me këtë pushkë.

Ne shtrëngonim në duar pushkën me një ndjenjë kureshtje dhe kënaqësie, se kjo pushkë kishte qëruar nazistët gjermanë e ballistët.

Pyesnim vend e pa vend, po Kreshniku na përgjigjej gjithnjë.

Ai na tregoi se, me disa shokë të tjerë, ishte bashkuar me skuadrën e partizanëve që kishim takuar ne dhe kishin rrethuar shtëpinë nga ku shtinin gjermanët me mitraloz. Me luftë të ashpër, i kishin vrarë të gjithë.

Ai fliste pak, e siç duket, nuk i pëlqente të tregonte për veten e tij. Po, me ç'vija re përreth, edhe partizanët e tjerë kështu flisnin. Nga të gjitha këto biseda, një gjë kuptoja qartë: lufta për çlirimin e qytetit tonë kishte qenë shumë e ashpër. «Ç'do pëllëmbë tokë është fituar me gjak!» — thoshte një partizan.

Të gjithë ishin të afërt dhe të dashur me partizanët. U jepnin bukë, çaj, djathë, ç'të kishin, megjithëse mezi u dilnin për vete. Po partizanët, për çudi, nuk pranonin asgjë. Madje ata as edhe qendruan shumë.

— Erdhëm vetëm për t'u takuar me ju! —  
tha Kreshniku. — Duhet të bashkohemi me sho-  
kët. Lufta ende s'ka mbaruar; kanë mbetur dhe  
disa lagje të qytetit pa u çliruar.

Na u bë qejfi. Kreshniku kishte ardhur për  
t'u takuar me ne, po na mbuloi një hije trishtimi,  
kur morëm vesh se ai do të shkonte aq shpejt.

Ata po bëheshin gati të iknin, kur papritur  
im vëlla u hodh e tha:

— Kreshnik, unë... dua të shtie me pushkën  
tënde!

Kreshniku po e vështronte, pa ditur ç'ti  
thoshte.

— I ka mbetur merak, — nisi të thoshte  
gjyshi,

— Epo, kur qenka puna kështu, le të shtje-  
rë! — tha një nga partizanët.

— Hajde, shpejt! — tha Kreshniku.

Edhe nga mëhallët e tjera dëgjoheshin të  
shtëna.

— Siç duket po shtien nga mëhallët e çliru-  
ara — tha nëna.

— Po, ashtu duhet të jetë, pohoi Kreshniku.  
— Janë të shtënat e fitores.

Ai i dha pushkën tim vëllai.

— Po ti je më i shkurtër se pushka! — qeshi  
gjyshi. — Si do të shtiesh?

— He, s'ke ç'i bën! — tha babai dhe i mbajti  
pushkën tim vëllai.

Këtë radhë ai, për të na mbushur mendjen  
se nuk ndruhej, na hodhi një vështrim triumfo-  
njës dhe, pa e zgjatur, e shkrepri pushkën, që bu-  
çiti dhe u lëkund, teksa ne të gjithë lëshuam një  
britmë gëzimi. Buçimë si kjo, nuk kishim dëgjuar.

— Mjaft tani! — tha Kreshniku duke parë që donim edhe ne të tjerët të shtinim. — Plumbat nuk duhet t'i harxhojmë kot. Ato duhet të zenë në trup të armikut. Ne do të takohemi përsëri pasi të çlirojmë qytetin. Mirupafshim!

Ata u zhdukën në errësirën e natës. Mua s'më hiqeshin nga mendja fjalët e tij: «Ato duhet të zenë vetëm në trup të armikut». Isha i sigurtë se plumbat e Kreshnikut dhe të partizanëve të tjerë patjetër do të zinin në trupin e armikut që po zmbropsej në panik.

## XXV

### PËRSËRI NË MËHALLËN E VJETËR

Qyteti ishte çliruar.

Ne linim pas shtëpinë e gjyshit me bodrumet e errëta, ku kishim kaluar ditët e luftës, e ktheheshim në mëhallën tonë të vjetër. Po ktheheshim nëpër shtëpitë e tyre dhe tërë njerëzit që ishin ato ditë në bodrum bashkë me ne.

Po merrnim drejt udhës që shpinte në shtëpi, jo ashtu me nxitim siç kishim ardhur, po të shpen-guar, të qetë, të çliruar nga ankthi i ditëve, që kundërmonin erë tym e barot, të cilat i kishim lënë prapa përgjithnjë. Kudo dukeshin njerëz të qeshur. Kurrë nuk kisha parë njerëz kaq të gëzuar. As atëhere kur bëhej ndonjë dasmë e njerëzit pinin dhe argëtoheshin.

Kisha dëgjuar për gjermadhat, po kurrë nuk i kisha parë. Njëherë mbaja mend që në mëhallën tonë, nga shiu i rrëmbyer dhe era e fortë, që rrëzuar një shtëpi, së cilës gjithë njerëzit e mëhallës i thoshin shtëpi gjermadhë.

Po gjermadhat që pashë gjatë rrugës, duke u kthyer në shtëpi, ja kalonin disa herë shtëpisë gjermadhë të mëhallës sonë të vjetër. Disa shtëpi



qenë bërë shkumb e hi. Siç duket, ato qenë goditur nga predha të mëdha, madje shumë të mëdha.

— Si është e mundur! — thoshte nëna, duke u ngrysur në fytyrë. — Ç'paskan bërë katilët!

— Epo, si do ta nxirrnin inatin ndryshe për humbjet që pësuan — thoshte babai.

Tregonin se gjermanët kishin pësuar humbje të mëdha. Kishin lënë andej këndeje të vrarë, robër, armë e ua kishin mbathur në veri, të ndjekur nga partizanët.

Ne lamë pas rrugën e mbushur me pengesa prej gurësh, tullash, dërrasash e lloj-lloj plaçkurinash, që njerëzit kishin filluar t'i pastronin, dhe morëm drejt mëhallës sonë të vjetër. Ajo s'qe dëmtuar shumë: veç disa shtëpi qenë shkatërruar e ashtu, nga larg, dukeshin si trupa të sakatuar që vështrojnë me dhëmbje.

Kaluan sheshin, ku sa herë kishim luajtur me top. Po sheshi dukej i vdekur. «Mos u mërzit, o shesh! — thosha me vete. — Së shpejti do të të ngjallim. Ke për të parë!» dhe shtrëngoja me duar topin, që nuk na ishte ndarë as ditëve të luftës.

Kaluan edhe para shtëpisë së avokatit.

— Hë, maskarai, — tha babai tërë urrejtje, duke shtrënguar dhëmbët. — Kushedi se ku fshihet.

— Pse, fshihet ai, baba? — pyeta unë.

— Me siguri që fshihet. Po edhe në vrimë të miut sikur të futet, do ta gjejnë.

— Ç'do t'i bëjnë baba?

— Do ta dënojnë për ato që ka bërë.

— S'ka bërë pak spiuni i ndyrë, — tha nëna.

Babai po tregonte se avokati kishte marrë në qafë shumë njerëz të pafajshëm.

Kur sillja ndërmend se sa shumë na kish munduar, më hipte një inat i madh dhe doja që ta kapnin sa më parë. Dhe me siguri do ta kapnin. Nuk kishte nga të ikte. I kishte ardhur fundi.

Lamë pas sheshin, kaluam nëpër rrugicën e ngushtë të shtruar me kalldrëm, ku kishim parë një ditë Kreshnikun të ngjiste traktet dhe, pasi u ndamë me Mirandin, erdhëm më në fund në shtëpinë tonë.

Sa shumë na kishte marrë malli për të!

Ndoshta ngaqë kisha shumë kohë pa e parë, ajo m'u duk më e mbledhur, më e vogël. Duke e parë ashtu, më dukej se na thoshte: «U kujtuat më në fund të vini. Sa ju kam pritur. Ku humbët kaq kohë?»

Ku ta dinte shtëpia ç'rrezik na ishte kanosur neve. Po tani të gjitha këto kishin marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Nëna me babanë u ngjitën sipër dhe filluan të merren me rregullimin e plaçkave, kurse ne po bridhnim në oborrin, që ish i mbuluar i tëri me gjethe të kuqërremta; ashtu, dukej sikur kish marrë flakë. Ndoshta do të ishim ngjitur lart, po papritur, im vëlla, që i ishte afruar një mani që ndodhej nga fundi i oborrit, më thirri:

— Pa shiko! Ç'është kjo këtu?

Pandeha se mos e kishte fjalën për ndonjë breshkë a kërmill që shpesh gjenim nëpër zgavrat e rrënjëve të manit. Mirëpo, duke u afruar, u habita kur pashë të rrasur në tokën e butë dhe të lagësht rreth manit një diçka të gjatë, të lëmuar, si të veshur me hekur, gjysmë të zhytur në tokë.

— Ç'është kjo? — pyeta unë i habitur.

Im vëlla ngriti supet. Kurrë nuk kishim parë diçka të tillë. Po kush e kish sjellë në oborrin tonë?

— Kush do ta ketë sjellë? — thashë unë. —

Im vëlla ngriti supet përsëri.

— Ndonjë njeri e ka sjellë! — tha pas një çikë vëllai.

— Po pse pikërisht këtu rrzëzë manit?

— E gjeta! — thirri im vëlla dhe sytë i shkrepëtinë. — Vë bast që këtu brenda do të jenë fshehur florinj.

— Florinj?

— Ja ku ta them unë: florinj, madje do të ketë shumë! Ai që e ka sjellë këtë, do të ketë dashur ta fshehtë nën rrënjët e manit, mirëpo siç duket nuk ka arritur. Kush e di përse!...

Ne kishim dëgjuar në përralla për thesarë të fshehur rrzëzë pemëve. Nuk ishte çudi që edhe në këtë gjë të gjatë dhe të veshur në hekur të ishte fshehur ndonjë thesar. Po mua nuk më besohej.

— Mirëpo thesarët fshihen nëpër qypa! — i thashë tim vëllai.

Ai mbeti për një çast, po pastaj u përgjegj:

— Në qypa kanë qenë fshehur në kohë të vjetra. Vë bast që ky do të jetë një thesar i madh!

Dhe duke thënë këto fjalë, ai e kapi me të dy duart atë gjënë e gjatë. U përpoq ta ngrinte, mirëpo ku donte t'ja dinte ajo. As që lëvizi fare.

— Qenka shumë e rëndë! — tha im vëlla. — Hajde ta ngremë të dy.

Dhamë e morëm, po s'qe e mundur. Ajo përsëri s'luajti vendit. Më dukej sikur atje brenda do të ish fshehur tërë thesari i botës.

— Ç'do ta bëjmë tërë këtë thesar? — pyeta vëllanë.

— Sigurisht që do t'ja dorëzojmë atij që i përket! — tha vëllai.

— Po ai më siguri do të jetë ndonjë pasanik.  
Dhë pasanikët janë armiq!

— Atëhere do t'ua dorëzojmë partizanëve.

Ndërsa ne po bisedonim, në oborr u duk babai.

— Ç'bëni aty? — pyeti ai.

— Baba, baba! — thirri im vëlla tërë gaz. —  
Kemi zbuluar rrëzë manit një thesar. Ta dish ti sa i  
madh është! Hajde ta shohësh vetë.

— Për ç'thesar flisni, more! — tha babai duke  
u afruar i habitur.

— Ja, shikoje! — tha im vëlla.

— Largohuni që andej, — thirri papritur babai,  
sa që ne u drodhëm e u larguam. — Sa më larg,  
ju them!

Ai dukej tepër i shqetësuar. Ne nuk e kuptonim  
përse.

— E prekët me dorë këtë?

— Po e prekëm! — tha me mburrje im vëlla.  
(Ai donte të ma rrëmbente gjithmonë fjalën nga  
goja, megjithëse, duke më quajtur si më të madh,  
babai gjithmonë më drejtohej mua).

— Budalla! — e qortoi babai. — Ç'thesar është  
ai...

— Po ç'është, baba? — pyeta unë.

— Bombë, ja se ç'është. Dhe ju e kini prekur  
me duar. Fëmijë të prapë! S'lini gjë pa prekur.  
Përse nuk pyesni një herë? Mbeti thesari që ta zbu-  
lonit ju!

Në këto e sipër, në oborr kishte zbritur nëna.

— Ç'ka ndodhur? — tha ajo e turbulluar.

Babai ja tregoi të gjitha.

— Po sikur të kishte shpërthyer? — tha ajo e  
mbylli sytë si të donte ta shmangte atë pamje që  
do t'i ngjallte shpërthimi i bombës.

Vërtet, atëhere do të ngjante diçka e madhe, e tmerrshme.

— Aman, ta heqim sa më parë që këndejl! — tha nëna.

— Do ta heqim, — u përgjegj babai. — Nesër do të vijë këtu Kreshniku dhe partizanët e tjerë.

— Po kushedi, ajo gjer nesër mund të shpërthejë!

— Ajo shpërthen vetëm po ta prekësh. Po s'do të lemë njeri të afrohet.

— Po si ka rënë këtu në oborrin tonë?

— E kanë hedhur gjermanët.

— Dhe s'ka shpërthyer?

— Ndodh edhe kështu, — tha babai. — Siç duket nuk ka shpërthyer ngaqë toka ka qenë e butë.

Sakaq lajmi se në oborrin e shtëpisë sonë kishte rënë një bombë, u përhap si rrufe në tërë mëhallën. Të gjithë donin ta shihnin, sidomos kalamajtë. Mirëpo babai nuk i linte.

Ne e ndjenim veten krenarë që bomba kishte rënë në oborrin tonë, thua se kështu shtëpisë sonë i ishte bërë një nder i madh dhe harronim se, po të kishte shpërthyer, kush e di se ç'do të kishte ndodhur. Po e mbanim veten më të madh, se jo vetëm e kishim zbuluar këtë bombë (megjithëse atë do ta kish zbuluar cilido që do t'i ishte afruar manit), po sepse edhe e kishim prekur me dorë.

Kreshniku me disa partizanë të tjerë erdhën në shtëpinë tonë. Ne, nga gëzimi, i harruam qortimet e babait, përqaftuam Kreshnikun, që ish veshur po me ato rroba siç e kishim parë atë natë në bodrum. Tani që po e shihnim ditën, vumë re se ai kish marrë hijen e një burri dhe u habitëm se si kjo mund të ndodhte kaq shpejt. Kreshniku na solli sihariqin, se qyteti ishte çliruar plotësisht.

Erdhi dhe Mirandi. U përçafua dhe ai plot mall me Kreshnikun.

— E dini ç'ju kam sjellë? — na tha pastaj Kreshniku, ndërsa fytyra i shkëlqente nga një gëzim që ne nuk arrinim ta kuptonim.

Po vrisja mendjen të gjeja se çfarë ishte ajo që na kish sjellë Kreshniku, kur im vëlla pa e bërë të gjatë, tha:

— Me siguri ndonjë kobure për të qëlluar! — Ai ishte i bindur se i kish rënë në të.

— Jo, nuk është ashtu! — qeshi Kreshniku. — Është një gjë e bukur, që patjetër do t'ju pëlqejë.

Mirëpo, kur pa që ne po heshtnim, ai nxorri nga një trastë e fryrë që mbante pas shpinë, një top futbollit: ishte një top i lëmuar me lëkurë të verdhë, i bukur sa nuk bëhej.

Sa u gëzuam! Harruam fare përse kish ardhur Kreshniku dhe partizanët e tjerë dhe u thamë që të luanim bashkë. Ata ja plasën të qeshurit.

Edhe babai me nënën që kishin zbritur në oborr, s'po e mbanin veten.

— Ç'ke me ta, — tha babai, — kalamaj janë. E humbën fare nga ky top, që e kanë ëndërruar prej kohësh.

— Kjo është dhurata më e bukur, Kreshnik! — tha nëna. — Unë të falënderoj.

— Është dhurata e çlirimit! — u përgjegj Kreshniku.

Ne ulëm kokën të turpëruar. Na erdhi inat që babai na kish quajtur kalamaj, në një kohë kur na dukej se kjo fjalë nuk na përkiste më neve. Po ja që kishim harruar të bënim gjënë më të thjeshtë: të falnderonim Kreshnikun për dhuratën e tij të rrallë.

Më në fund dhe ne kishim një top lëkure, një

top për të qenë, e të gjithë topat e tjerë m'u dukën se i kishim parë në ëndërr.

Te dera e shtëpisë qenë mbledhur shumë njerëz. Të gjithë qenë kureshtarë të shihnin bombën e plasur, që kish rënë në oborrin e shtëpisë sonë.

Kreshniku dhe partizanët e tjerë u afruan pranë manit, gërmuan me kujdes rreth vendit ku kish rënë bomba, pastaj e ngritën në duar, duke e mbajtur ashtu si do të mbanin trupin e një njeriu të vdekur.

Teksa Kreshniku dhe Partizanët e tjerë po e kaptonin oborrin e shtëpisë sonë me bombën në duar, kalamajtë përplasnin duart, kërcenin, afroheshin dhe e shihnin nga afër bombën, prej së cilës nuk kishin përse të kishin frikë.

## XXVI

### KONTROLLI NË SHTËPINË E AVOKATIT

Qenë ditë të hareshme. Njerëzit hynin e dilnin nëpër shtëpitë e njëri tjetrit dhe uronin ditën e çlirimit.

Shtëpia jonë buçiste si në dasmë. Radioja, që kish fjetur për disa ditë me radhë, tani e ngrinte zërin aq sa më dukej se tërë shtëpia dridhej prej saj. Një zë që fliste shqip, lajmëronte se tërë Shqipëria po çlirohej e gjermanët kishin marrë vrapin dhe po largoheshin nga toka jonë. Mirëpo partizanët s'po i linin rehat dhe po i ndiqnin dhe jashtë tokës sonë. Nga kutia prej dërrase, me atë syrin e gjelbër, shpërthenin këngë, që këndoheshin nga shumë zëra. Si thoshte babai, këto ishin këngë që partizanët i kishin kënduar në male. Tani radioja nuk më dukej më një gjë e çuditshme, po një gjë e afërt, e këndshme dhe e dashur, ndaj, sa herë dëgjoja njeriun që fliste, rrija e kapja çdo fjalë.

Në radio fliste herë një burrë, herë një grua e unë, duke dëgjuar zërat e tyre, mundohesha t'i përfytyroja. Gjykoja se ata duhet të ishin hijerëndë, ndryshe nga njerëzit e tjerë.

Luanim më tepër se çdo herë tjetër. Tani sheshi



gumëzhinte nga tërë kalamajtë e mëhallës. Ata donin të luanin me topin e verdhë, që kërciste aq shumë nga goditjet tona. Porta e shtëpisë së avokatit gjithnjë na vështronte vëngër, kurse avokati e djali i tij s'dukeshin gjëkund. Mos kishin ikur? Mos ishin fshehur?

Thoshin se kishin parë gruan bullafiqe të avokatit, që rrallë hynte e dilte. Të tjerë thoshin se avokati që zhdukur pa lënë gjurmë, duke patur frikë se mos e kapnin partizanët. Kështu thoshte dhe babai. Po asgjë nuk dihej me siguri.

Po gjithçka u zgjidh pas disa ditësh. Kudo në qytetin tonë partizanët po bënin kontroll nëpër shtëpitë e pasanikëve dhe të atyre që kishin bashkëpunuar me armikun.

Dhe ja, një pasdite, kur po luanim në oborr, pamë Kreshnikun dhe partizanë të tjerë. Ata u drejtuan nga porta e shtëpisë së avokatit. Trokitën fort. Porta u drodh nga këto trokitje të forta. Ne lamë lojën dhe u grumbulluam rreth tyre. Kreshniku na bëri shenjë të largoheshim, po ne nuk shkuleshim. Donim të dinim përse kishin ardhur. Mos ndoshta për të kapur avokatin? Po ai thoshin se kishte ikur!

Përsëri trokitën në portë. Në oborr u dëgjuan hapa, pastaj krisma e një llozi dhe e një çelësi, që u vërtit dy herë. Porta u hap dhe ne pamë fytyrën e trembur të gruas së avokatit, që, me të parë partizanët, sadoqë u mundua, nuk mundi të përmbajë një dridhmë, nga frika dhe tmerri.

— Përse kini ardhur? — tha ajo me gjysmë zëri.

— Do të bëjmë kontroll... — tha një partizan.

— E kini kot. Në shtëpinë tonë asgjë nuk do të gjeni!

— Ku është burri juaj?

— Korba unë! Nga ta di! Aq sa dini ju, di dhe unë. Ai ka kaq kohë që nuk është më në shtëpi, prandaj...

— Na lësho udhën! — e ndërpreu Kreshniku dhe u bëri shenjë partizanëve të tjerë.

Njëri nga partizanët u kthye dhe filloi të shpërndajë turmën e kalamajve të vegjël, që dalëngadalë po largoheshin. Unë, im vëllë dhe Mirandi bëmë sikur u larguam, po kureshtja e madhe na shtyu të qërdrojmë mënjanë.

Ata hynë brenda. Porta mbeti e hapur. Ne pritëm derisa ata të futeshin brenda në shtëpi. Pastaj hymë në oborr e, që të mos hynte ndonjë fëmijë tjetër, po aq kureshtar sa ne, e mbyllëm portën. E dinim që nuk vepronim mirë, mirëpo s'na ikej që andej.

Ishte hera e parë që futeshim në shtëpinë e avokatit. Qe një shtëpi e futur thellë, fshehur pas disa pemëve. Ashtu ajo më dukej sikur donte t'i shmangej shikimit të njerëzve. Bëmë disa hapa dhe ju afruam derës së jashtme të shtëpisë, që ngrihej mbi disa shkallë mermeri.

Ç'bënin ata brenda? Me siguri kalonin nga një dhomë në tjetrën, kontrollonin kudo, për të gjetur avokatin sepse, më sa duket, nuk u besonin fjalëve të gruas së tij. M'u kujtua bastisja që kishin bërë ballistët në shtëpinë tonë, avokati me të birin që i shoqëronin, duke u kapardisur, babai, nëna, ballisti që ruantë, e të gjitha ato ngjarje më ngjallën një urrejtje edhe për këtë shtëpi të frikshme, edhe për njerëzit që jetonin në të.

Nga brenda vinte zhurmë. Dëgjoheshin dyert që hapeshin, hapat nëpër koridore. Pastaj ato nisën të dëgjohen më rrallë. Siç duket po kontrollonin në

ndonjë dhomë tjetër, që ndodhej më thellë shtëpisë. Ngjitëm shkallët e mermerta dhe u futëm në një sallon të gjerë. As vetë nuk po e mernim vesh se ku shkonim. Di vetëm se, në ato çaste, qeshë pushtuar nga një dëshirë e madhe të shihja si do ta kapnin avokatin, po të ndodhej i fshehur në shtëpi.

Për të mos bërë zhurmë, ecëm në majë të gishtave; mirëpo, për djall, im vëlla, që ndodhej pas nesh, ndeshi në një karrige e ajo ra, duke marrë me vete dhe një vazo lulesh, që ish vënë në hyrje të sallonit. Karriga dhe vazoja u përplasën me një trokëllimë të shurdhër në dyshe-menë prej dërrase. Ne shtangëm në vend. Atëhere nga dera gjysmë e hapur e një dhome aty pranë pamë të turrej Kreshniku dhe një partizan tjetër me kobure në duar. U munduam të fshiheshim pas një perdeje të trashë. Dhe do të kishim arritur pa u vënë re nga ata, mirëpo përsëri im vëlla, që e kish humbur fare, u ngatërrua me këmbë e duar nëpër perde, sa ajo u shemb në dyshe-me, po këtë radhë me një zhurmë të madhe dhe në mbetëm të tre të mbuluar nga perdja që po na merrte frymën e s'lëvizëm fare.

— Ngreu, — tha Kreshniku, — s'ke nga shkon!

Unë nuk kuptova se përse ai tha «ngrehu» e jo «ngrehuni». Mos ndoshta kish parë vetëm një nga ne, apo mos pandehte se nën perde ishte fshehur avokati.

— Ngrehu! — përsëriti Kreshniku.

Po asnjë nga ne nuk lëvizi. Dëgjuam këmbë të afroheshin e dikush, me siguri Kreshniku, hoqi perden e sakaq ne u zbuluam. Atëhere vumë re Kreshnikun dhe partizanin tjetër që kishin drejtuar koburet nga ne.

Të dy mbetën sikur t'i kish goditur rrufeja.

— Po, ju, ç'doni ju këtu? — pyeti Kreshniku.

Ne ulëm kokën e s'dinim ç't'i thoshim. Dukej se Kreshniku qe inatosur shumë. Në këto e sipër ja behën dhe partizanët e tjerë e pas tyre dhe gruaja e avokatit me fytyrën e zbehtë si të një të vdekuri. Pas saj pamë dhe djalin e avokatit. Edhe ai ishte i zbehtë si e ëma.

— Ç'ndodhi? — pyeti njeri prej partizanëve e vështroi nga ne.

— Kujtuam se e gjetëm! — u përgjegj Kreshniku. — Pa shiko se kë zëmë!..

Partizanët ja plasën gazet. Bashkë me ta dhe Kreshniku. Neve ndjemë të na shkrihej gjaku nëpër rrëmba: Nisëm dhe në të qeshim. Mirëpo papritur Kreshniku u ngrys.

— Shkoni! — na tha. — Dhe mos e përsërisni herë tjetër!

Ne u pezmatuam.

— Leri! Ç'kë me ta! — tha njeri nga partizanët. — Ti e kupton se nga kureshtja kanë ardhur. Fundja, pse të mos rrinë? Këtu nuk ka asgjë të fshehtë.

Kreshniku nuk foli, vetëm vuri buzën në gaz.

Ata u kthyen për të vazhduar bastisjen.

— E ç'do të shikoni, — tha gruaja e avokatit, — jua thashë: ai nuk është këtu...

Po asnjëri nuk ja vuri veshin. Ata bënë përpara. Pas tyre edhe ne. Dhomat qenë të mobiluara hie-shëm. Dukej se të tëra këto avokati i kish bërë me paratë që u grabiste njërezve e, sigurisht, dhe me paratë që merrte nga gjermanët e ballistët për shërbimet që u kishte sjellë.

Partizanët vazhdonin të kontrollonin me kujdes. Nën një minder pamë topin prej lëkure, që e patëm

lakmuar aq shumë. Mirëpo tani ai s'na bëri asnjë përshtypje, sepse ne kishim topin që na kish dhuruar Kreshniku e që ish më i bukur.

Djali i avokatit kish mbetur i shushatur dhe s'e nxirrte një fjalë nga goja.

Kreshniku dhe partizanët e tjerë kaluan në një dhomë tjetër. Kjo ishte dhoma e fjetjes. Nga që dritaret kishin kohë që nuk ishin hapur, dhoma mbante një erë të rëndë. Në dhomë kishte një shtrat të madh, një komodinë, një pasqyrë të lartë e një raft rrobash. Hodhëm sytë ngado. Pastaj pamë sirtarët. Në një prej tyre kish disa libra, letra të zhu-bravitura.

Këtu vetëm rroba ka, asgjë tjetër! — tha gruaja e avokatit kur ju afruan raftit të rrobave.

— Megjithatë, ne do të shikojmë, — u përgjegji Kreshniku.

Gruaja e avokatit s'bëri gëk. Një partizan hapi raftin. Ne pamë rroba të ndryshme, kostume burrash e grash, të vëna sërë nëpër vartëse. Poshtë kishte këpucë, sandale gjithfarësh dhe një palë çizme të gjata gome, që dukeshin si të ngrira.

Jo, ai nuk ishte as edhe në këtë raft.

Partizanët mbyllën raftin dhe u kthyen e filluan të dalin nga dhoma. Me sa duket, avokati kishte ikur pa lënë gjurmë, ashtu si thoshte edhe gruaja e tij, që tani nuk më dukëj më e zbetë si më parë. Ajo na vështronte me një mënyrë të tillë sikur të donte të na thoshte: «Nuk ju thashë? Këtu nuk ka asgjë».

Edhe partizanët e tjerë kishin kërkuar në banjë, në çati, në bodrum. E ku s'kishin kërkuar, po asgjë-kundi nuk kishin gjetur gjë.

Po bëheshim gati të dilnim. Të gjithë dukeshin të pezmatuar. Mua më vinte shumë inat që avokati

kish mundur të ikte. Po zbrisnim shkallët, kur befas im vëlla, që qëndronte në fund, u ndal.

— Ç'bën atje? — i tha Kreshniku.

Im vëlla nuk u përgjegj. Ai diç donte të thoshte, po si duket nuk guxonte. Pastaj papritur u sul drejt Kreshnikut e diç i pëshpëriti në vesh. Kreshniku mbeti një çast me mëdyshje, pastaj tha:

— Ç'thua, nuk është e mundur!

— Vë bast që është kështu siç them unë! — thirri këtë radhë im vëlla. — Eja të shikojmë dhe një herë.

S'po merrja vesh se për çfarë e kish fjalën im vëlla. Me sa duket diç i kish thënë Kreshnikut, po ky nuk e kishte besuar e tani im vëlla, siç e kishte zakon, ngulte këmbë në mendimin e tij.

Pandeha se Kreshniku do të ecte përpara, mirëpo u kthye.

— Ç'ndodhi? — pyeti një nga partizanët.

— Asgjë! — u përgjegj Kreshniku. — Do të bëjmë përsëri një kontroll në dhomën e gjumit.

— Po ju patë, atje nuk ka asgjë! — belbëzoi gruaja e avokatit.

Mirëpo Kreshniku nuk ja vuri fare veshin përsëri. U kthyem dhe ne të tjerët. Në atë çast na u duk se diç lëvizi në dhomën e gjumit. U sulëm të gjithë me një frymë. Po gjithçka qëndronte në vendin e vet, ashtu siç e kishim lënë.

Kreshniku u drejtua nga rafti. Ashtu bëmë dhe ne. E hapi përsëri atë dhe hodhi sytë poshtë. Atje ishin këpucët, sandalet, çizmet e gjata prej llastiku, po... për çudi ato nuk qenë vendosur ashtu siç i kishim parë. Njëra çizme që kthyer pakëz anash. Dukej sikur një dorë i kish lëvizur.

U bë një heshtje e madhe. Kreshniku që mbante

në dorë koburen, lëvizti kostumet që qenë ngjeshur si perde dhe atëhere në pamë përmes tyre një trup njeriu, këmbët me çizme, pastaj kokën tullace të avokatit, që po na vështronte me tmerr.

— Dil! — tha Kreshniku. — Në emër të ligjit të popullit je i arrestuar!

Gruaja e avokatit ja dha kujës. Pas saj dhe djali.

Avokati doli duke u dredhur. Ai që hequr dhe dukej se kish shumë ditë që nuk ishte rruar, sepse mjekra nxinte nga qimet. Ashtu, ai ngjante si kusar i zënë me presh në duar.

Ngriti duart dhe tha më zë të mekur:

— Amani, mos shtini, hiqeni atë armë... Kini mëshirë për mua; unë nuk kam bërë asgjë...

— Ti s'ke bërë asgjë? Ti, që ke marrë në qafë gjithë ata njerëz! — tha Kreshniku. — Duart lart e tani marsh përpara, tradhëtar i ndyrë!

Bastisja kish përfunduar: avokati, që për pak mund të kish shpëtuar, tani kishte rënë në duart e partizanëve. Për këtë ishte bërë shkak im vëlla. Vërtet ai fliste shpesh kuturu e nxitohej të thoshte ç'ti vinte në kokë, po ama, këtë radhë nuk kishte gabuar.

## XXVII

### NË STADIUM

Tërë Shqipëria ishte çliruar. Këmbë armiku nuk kishte mbetur në vendin tonë. Ditët po bëheshin më të harëshme, më të lumtura.

Ne vazhdonim të luanim me top në sheshin e mëhallës, që tani na dukej i vogël. Mendonim të gjenim një shesh më të madh, ta bënim me viza të bardha, të vinim dhe dy porta e të luanim, si atje në fushëm e futbollit.

Kështu kalonin ditët.

Dhe ja, një ditë, në kohë të drekës, ndërsa radioja buçiste nga këngët partizane, babai erdhi tepër i gëzuar e na tha:

— E dini ku do të vemi sot?

Ne me vëllanë u shikuam sy në sy dhe vrisnim mendjen të gjenim se për çfarë e kishte fjalën babai.

— Do të vemi në stadium! — tha paspak ai.

— Në stadium! Po ti, baba, na ke thënë se në qytetin tonë nuk ka stadium? — u hodh im vëlla.

— Ashtu vërtet. Po fashistët, duke menduar se do të rrinin gjithnjë këtu, filluan të ndërtojnë për veten e tyre një stadium me shpenzimet e popullit



tonë. Sigurisht që nuk i kishin bërë mirë hesapet, se punët dollën ndryshe. Tani stadiumi po mbarohet së ndërtuari nga ne. Sot atje do të zhvillohet ndeshja e parë e futbollit pas çlirimit.

Ne përpoqëm duart nga gëzimi.

— Cilët do të luajnë, baba? — pyeta unë.

— Skuadra e qytetit me atë të ushtrisë.

— Po cila është kjo skuadër e ushtrisë?

— Skuadra e partizanëve.

— Pse, edhe futboll ditkan të luajnë partizanët? — u çudit im vëlla.

— Edhe futboll dinë të luajnë.

— Po ku kanë mësuar? Në mal ata vetëm kanë luftuar!

Edhe unë po habitesha nga fjalët e babait dhe mundohesha të merrja me mend se si kishin gjetur kohë partizanët të luanin dhe futboll.

— Ata nuk kanë mësuar të luajnë në mal, — shpjegoi babai. — Kanë luajtur ende më parë. Midis tyre ka dhe nga ata që pamë atë ditë duke luajtur në fushën e futbollit. Në stadium kini për të parë dhe...

Babai diç desh të shtonte, po siç duket u pëndua.

— Më mirë ta shihni vetë, — tha pastaj.

Në dhomë u fut dhe nëna me pjata në duar.

— Grua, do të vish edhe ti me ne në stadium! — i tha babai.

— Ç'thua kështu? Unë në stadium?! — foli nëna duke qeshur me habi. — Ti e di që unë nuk e kam dashur kurrë këtë lojë! Po ç'tu bëj fëmijëve...

— S'ka gjë, do të vish dhe ke për të ndryshuar mendim! — e ndërpreu babai.

— Nënë të lutem, mos na e prish qejfin. Eja dhe ti me ne! — tha vëllai.

— Epo mirë, nuk po jua prish, do të vi dhe unë me ju në stadium.

Ne brohoritëm, përplasëm rishtas duart dhe u sulëm të përqafonim nënën tonë të dashur.

Tani as na hahej, gëlltitim me zor kafshatat e bukës e prisnim çastin kur do të niseshim për stadium.

Ndeshja fillonte shpejt. U bëmë të gjithë gati. Qemë veshur si për ditë feste.

Morëm me vete dhe Mirandin. S'e përmbante fare veten nga gëzimi, megjithëse e hiqte veten si shumë më të madh nga ne.

Stadiumi ndodhej nga ana tjetër e qytetit, pranë disa kodrave të gjelbëruara. Ne kaluam përmes rrugëve të qytetit. Grumbujt e dërrasave, të gurëve, të fuçive e të plaçkurinave të tjera, që kishim parë gjatë ditëve të luftës, qenë zhdukur. Muret e rrëzuara po ngriheshin, çatitë e dëmtuara të shtëpive po rregulloheshin. Çdo gjurmë e luftës po zhdukej.

Nga çdo rrugë vërshonin turma njerëzish. Të gjithë drejtoheshin për në stadium.

Më në fund arritëm. Përreth pamë karroca do-re, rërë, gurë. Stadiumi vazhdonte të ndërtohej. Megjithatë, atje do të zhvillohej ndeshja e parë e futbollit pas çlirimit.

— Shpejt, që të zëmë vende sa më të mira, — tha babai.

Ne ngjitëm shkallët e sakaq u ndodhëm brenda në stadium. Atje kishte mizëri njerëzish. Kaq shumë njerëz, jo vetëm që nuk kisha parë, po as që kisha përftyrtuar. Atëhere solla ndër mend fotografi-

në e çuditshme mbi kapakun e fletores së vizatimit, turma e njerëzve që e kisha pandehur herë si mur e herë si kaçubë, burrin me pantallona të shkurtëra e çorape të gjata që, duke dashur të kapte topin, dukej se do të përplasej e të dërmohej në atë mur a kaçube. Qesha me vete.

Tani kisha ardhur vetë në një stadium si ai. Po kjo nuk m'u duk më as e habitshme dhe as e pabesueshme.

Në fushë u derdhën lojtarët. Turma e njerëzve, që mbushte shkallët, duartrokiti. Të gjithë lojtarët mbanin në duar lule. Ata vrapuan drejt shkallëve dhe filluan t'ua hedhin njerëzve.

— Shikoni mirë kush po vjen drejt nesh — thirri babai.

Ne pamë një nga lojtarët, ndoshta më të voglin nga të gjithë, që po i afrohej turmës së njerëzve dhe mbetëm si të ngurosur.

— Kreshniku, ky është Kreshniku! — thirri Mirandi.

— Po, po, Kreshniku! — thirri im vëlla.

Vërtet ai ishte. Ja çfarë nuk kishte dashur të na tregonte babai: që Kreshniku, të cilin kishim ditë që nuk e kishim parë në mëhallën tonë, do të luante në fushë.

— Kreshnik, Kreshnik! — thërrisnim ne.

Zërat tanë mezi dëgjoheshin. Po Kreshniku na dëgjoi. Ai buzëqeshi, na bëri shenjë me dorë dhe pastaj na hodhi lulet.

Filloi loja. Topi kalonte sa në një rënë, në tjetrën portë. Stadiumi gjithnjë gumëzhinte. Siç duket, turma e njerëzve që ndarë më dysh: disa ishin me skuadrën e qytetit tonë, disa me atë të partizanëve. Ne donim të fitonte skuadra në të cilën luante

Kreshniku, sepse ai ishte shoku ynë, që na kish mësuar si të luanim futboll. Megjithatë nuk shqetësoheshim së, në fund të fundit, cilado skuadër që të fitonte, ishte jona.

— Forca Kreshnik, përpara! — thërrisnim ne, kur e shihnim të merrte topin.

Vija re se edhe nëna thërriste. Siç duket edhe asaj kishte filluar t'i pëlqente loja e futbollit. Tek shikoja Kreshnikun, më kujtohej Kopi që luante aq bukur dhe psherëtiva. Po të ishte gjallë edhe Kopi do të kishte luajtur dhe ne do ta kishim duartrotitur.

Po mua më tërhiqte diçka tjetër: ku ishte ai që po transmetonte me radio ndeshjen e futbollit? Hidhja sytë poshtë fushës, po asgjë nuk vija re. Pyeta babanë:

— Ja, atje tej! — më tha ai, duke më treguar me gisht.

Ngula vështrimin tutje turmës dhe përmes një dritareje prej xhami të një dhome të vogël pashë një burrë që fliste e fliste. E dija që tani zëri i tij përmes telave, duke kaluar fusha e male, përhapej kudo. E dija që njerëzit në shtëpitë e tyre qenë grumbulluar pranë radiove dhe dëgjonin se si zhvillohej ndeshja në stadium.

Me siguri ai fliste po aq shpejt sa ai që pata dëgjuar në radio. Do të kisha dashur në ato çaste të isha pranë tij, të dëgjoja se ç'fjalë përdorte kur topi kalonte nëpër këmbët e lojtarëve. Herën tjetër, kur të zhvillohej ndonjë ndeshje në stadium, do të qendroja në shtëpi pranë radios e do ta kapja çdo fjalë të tij.

Unë isha futur në botën e bukur të futbollit. Kisha ëndërruar të bëhesha portier si ai në fotogra-

finë e çuditshme, pastaj lojtar si Kopi, që dredhonte e çante aq shpejt me top përpara. Tani dalëngadalë po pushtohesha nga një ëndërr tjetër: të bëhesha si ai burri që po fliste, ndërsa zëri i tij shkrihej në jehonën e zërave të njerëzve në stadium, ku po zhvillohej ndeshja e parë pas çlirimit të qytetit tonë.

Tetor-Nëndor 1967



## PËRMBAJTJA

I.	Një kujtim në kohë të vështira .....	3
II.	Oborri me dy porta .....	7
III.	Loja e futbollit .....	9
IV.	Në kërkim të topit .....	14
V.	Topi prej lëkure .....	16
VI.	Fshikza .....	21
VII.	Një goditje në shenjë .....	23
VIII.	Të fshehtat e radios .....	28
IX.	Në fushë .....	35
X.	Dy goditje të sakta .....	41
XI.	Ditë të zymta .....	50
XII.	Një bisedë në mesnatë .....	57
XIII.	Bastisja .....	61
XIV.	Diçka do të ngjiste .....	70
XV.	Pushkatimi .....	74
XVI.	E papritura në shtëpinë e pambaruar .....	81
XVII.	Ditë të vrullshme .....	88
XVIII.	Lufta .....	91
XIX.	Bodrumet .....	100
XX.	Në pritje të partizanëve .....	107
XXI.	Mitralozi gjerman .....	111
XXII.	Kanali .....	115
XXIII.	Kreshniku .....	123
XXIV.	Përsëri në mëhallën e vjetër .....	128
XXV.	Kontrolli në shtëpinë e avokatit .....	136
XXVI.	Në stadium .....	144